DR. DENIS ÇELÇIMA

LIBËR PËR MËSUESIN
QYTETARIA 10

BOTIME

pegi

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Hyrje

2. Programi i qytetarisë dhe kompetencat kyçe
2.1. Rekomandime mbi metodologjinë

3. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së Qytetarisë për shkallën e 5-të (Klasa e X)
3.1. Kompetencat kyçe qytetare
3.2. Diagrami 2: Disa rezultate të të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë

4. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare
4.1.Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit
4.2. Historia dhe qytetaria.
4.3. Gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria

5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

6. Lëndës së Qytetarisë për shkallën e pestë (klasa 10)
6.1. Kompetencat e fushës
6.2. Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave

7. Udhëzime metodologjike
7.1. Diagram nr. 2: Metoda alternative në Lëndën e Qytetarisë
7.2. Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së qytetarisë?

8. Mjedisi i të nxënit të qytetarisë demokratike
9. Udhëzime për vlerësimin
10. Materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Të dashur kolegë!

Në kohët e sotme, lënda e Qytetarisë po merr përparësi në programet mësimore të arsimit fillor dhe të mesëm, duke marrë parasysh nevojën e ndryshimit të një psikologjie individuale dhe kolektive drejt elementeve qytetare të sjelljes, nxitjes së elementëve të formimit të personalitetit në masën e adoleshentëve drejt formimit të tyre akademik dhe qytetar.
Kjo lëndë specifike, e cila lidhet në mënyrë shumëdimensionale me shkencat shoqërore, në misionin dhe objektivat e saj bëhët një udhërrëfyes modest për mësimdhënësit, duke vënë plotësisht në funksion të formimit akademik elementët e veçantë të motivimit drejt vetëdijes humane, e cila në mënyrë racionale, hap pas hapi e vit pas viti i bën adoleshentët të vetëdijshëm në rrugën e tyre drejt dijes dhe qytetarisë.
Aftësia pedagogjike për të rritur ndjenjën e motivimit dhe të kompetencave tek adoleshentët, hap rrugën drejt vetëvlerësimit të tyre, si një nxitje e motivim për marrjen gradualisht të certifikatës së qytetarisë, duke i kthyer ata në qenie të vetëdijshme në marrëdhëniet sociale në shoqëri.
Nisur nga ky konstatim, mësimdhënësit bëhen të vetëdijshëm për misionin e tyre të vështirë por human, për të përgatitur njerëz të aftë në shërbim të shoqërisë.
Marrja e dijeve të sjelljes dhe qytetarisë nga adoleshentët merr përparësi në punën pedagogjike përballë komponentëve të tjerë akademik. Kjo ka të bëjë me marrjen e dijeve të mjaftueshme teoriko-praktike, të cilat funksionojnë në mënyrë efikase brenda trinomit mësues - nxënës - prind.
Ndërtimi i marrëdhënieve harmonike në këtë veprimtari do të mbështetet në ndërtimin e programeve efikase, brenda të cilit elementët përbërës shkojnë nga më e thjeshta drejt komponentëve kompleks, duke rritur gradualisht kompetencat individuale tek adoleshentët.
Formimi bazë me elementët e qytetarisë shkon paralelisht me ëndrrën mbi përgatitjen e tyre për nivelin universitar, e shoqëruar me dilemat që ata përjetojnë në këtë fazë formimi.
Dilemat dhe pasiguria në motivimin e tyre mbetet objekt zbulimi dhe trajtimi i mësuesit dhe prindit.
Jetojmë në një kohë të vështirë me fenomene sociale shqetësuese. Në këtë kohë zhvillimi, fëmijët në shtëpi, fëmijët me çelës në qafë, fëmijët përballë informacionit, rrezikut televiziv dhe rrjeteve sociale, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët në shkollë dhe në shoqërizimin e tyre social, janë dhe do të mbeten objekti cilësor i shqetësimeve tona dhe i studimeve psikologjike, kundër dekurajimit në mbështetje të të drejtës për arsimim, kundër arsimit diskriminues për një arsim të përshtatshëm, brenda një sistemi shkollor pa kufizime dogmatike por me proces të përshtatshëm procedurial, të gjitha këto në shërbim të edukimit profesional dhe psikomoral të nxënësve dhe studentëve në shkollë.
Të përfshirë në moshën dixhitale, të ekspozuar ndaj efekteve të një informacioni universal me pozitivitetet dhe negativitetet e tij, adoleshentët mbeten përherë të ekspozuar ndaj ndikimeve negative, të cilat japin efektet e tyre në edukim dhe marrëdhëniet sociale, duke rritur problematikën e shkollës dhe familjes.
Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit që japin mësim në klasën e dhjetë, për të përmbushur synimet e drejt rritjes së kompetencave personale tek adoleshentët

në plotësimin e kurrikulës së tyre psikosociale dhe akademike. Meqenëse në procesin arsimor janë përfshirë metoda të reja të mësimdhënies të bazuar mbi kompetencat, elementët programor të përfshirë në këtë libër synojnë kryesisht elementët psiko social, të cilët ndikojnë mjaftueshëm në rritjen e motivimit të brendshëm dhe të jashtëm, vetëefikacitetit mësuesor dhe prindëror, të vetëdijes publike dhe vetëdijes private, element këto të shtjelluar në programin shoqërues si pjesë e këtij libri.
Mbështetja në programin orientues të edukimit me elementët thelbësorë të qytetarisë, do të ndihmojë trupin pedagogjik në ndërtimin e punës së tyre të përditshme, duke u bazuar në elementët studimor që arrijnë të krijojnë atë lidhje sociopedagogjike për të shkuar nga më e thjeshta drejt elementëve kompleks edukativ në inrteres të formimit qytetar dhe akademik të adoleshentëve.
Programi mësimor orientues në këtë libër në mënyrë të përshkallëzuar, duke u mbështetur në kurrikulën bazë të formuar dhe përfituar nga programet paraardhëse, jep mundësinë e respektimit të një dokumentacioni të ri drejt kornizave të reja kurrikulare të lidhura ngushtë me kërkesat e programit mësimor.

Çfarë synon ky libër?
Duke respektuar disa ligjësi të shkencave sociale në formatin edukativ të sjelljes, gjykoj se objekti në këtë libër del i qartë:

- **Së pari:** Rëndësia që merr nxitja e motivimit tek adoleshentët për rritjen e kompetencave individuale në formimin e elementëve të qytetarisë dhe arritjet akademike;
- **Së dyti:** Trajtimi në mënyrë programore dhe psikopedagogjike i ndikimeve të reflektuara prej nxitjes së motivimit të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët sjellin pritshmërinë ndaj vetvetes dhe nxisin shpresën për sukses tek adoleshentët.
- **Së treti:** Ky libër do tu shërbejë mesuesve në Lëndën e Qytetarisë për zhvillimin interaktiv të orës së mësimit, si dhe do të synojë zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Çfarë përmban ky libër?
Në vështrimi analitik të çështjeve sociale në kohën tonë të lidhura me faktorët psikologjik brenda dhe jashtë shkollës, shikohet se ato ndikojnë mbi fëmijët dhe vet misionin e shkollës, shtrojnë nevojën e formave të reja më të avancuara, pse jo dhe për nevoja të posaçme në shërbim të ndryshimit cilësor të shoqërisë shqiptare.

Në vëmendjen e mësimdhënësve: Origjinaliteti i librit krahasuar me programet e mëparshme të Qytetarisë, qëndron në ndërthurjen e motivimit të nxënësve me disa faktorë të brendshëm e të jashtëm, po të kemi parasysh faktin që në këtë vit akademik ata fillojnë shkollën e mesme, për të parë lidhjen e tij me arritjet akademike, dëshirën për sukses, duke marrë në konsideratë ndryshimin e statusit dhe nivelin e kontradiktave që burojnë brenda periudhës delikate të moshës, në përpjekje të përcaktimit të identitetit dhe personalitetit të tyre në formim.
Shtrimi i problemit në këtë libër ka natyrë sasiore - cilësore dhe qasje konkrete. Ato të çojnë në përfundime programore të pranueshme, që e mbështesin statusin e ri të nxënësve

pozitivisht. Pavarësisht nga ndryshimet teorike sipas viteve dhe niveleve të Librit të Qyetetarisë, ku autorë të ndryshëm kanë dhënë vlerësimet e tyre, kërkimi dhe ndërtimi programor thekson se ka një realitet të përbashkët, mbi të cilin trupi pedagogjik bie dakort mbi përparësinë dhe pranimin, zbatimin e rekomandimeve në fushën e psikologjisë së adoleshentëve. Në përcaktimin e tematikës programore, metoda sasiore është përdorur për të rritur forcën e argumentit, në krahasueshmërinë e rezultateve të tyre mbi konsolidimin e kompetencave kyçe.

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së nëntë (shkalla katër) të lëndës së Qytetarisë, miratuar nga MAS-i në dhjetor 2014, duke synuar rritjen drejt "nivelit 5" me objektiva dhe synime programore më të avancuara. Meqenëse jemi në një situatë të zhvilluar të programeve në lëndën e Qytetarisë me lidhje të shkallës cilësore sipas rritjes së niveleve, edhe në këtë botim objektivat synojnë rritjen cilësore të elementëve programor psikopedagogjik në rritjen e kompetencave tek adoleshentët, duke rekomanduar:

- Tema të avancuara sociale, të cilat synojnë trajtimin më të detajuar të dukurive sociale në këtë grupmoshë;
- Element cilësor programor të planifikuar mbi bazën e përvojës pedagogjike, të cilët rrisin shkallën e trajtimit me objektiva ambiciozë;
- Rritjen e elementëve të metodës dhe metodologjisë pedagogjike të lëndës mësimore, të ndërthurur me elementët psikologjik të formimit të sjelljes;
- Të udhëzojë mësuesin në format e reja të ndërtimit të planit vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, formatet e vlerësimit etj. me të cilat do të punohet gjatë vitit mësimor;
- Të ofrojë një model orientues (alternative) mbi mënyrën e programimit dhe të zhvillimit të orës mësimore, duke lënë të hapur alternativën e ndryshimit dhe të përsosjes me element psikopedagogjik që burojnë nga praktika mësimore, grupmosha, niveli i arritjeve të adoleshentëve, shkalla e motivimit të tyre në interes të progresit të formimit të elementëve të qytetarisë. Kjo mënyrë veprimi e mësuesit do të ndikojë në rritjen e kompetencave personale të nxënësve.

Përballimi i ngarkesave profesionale, frymëzimi dhe mbështetja për punë këmbëngulëse për plotësimin e librit, janë shprehja e falënderimeve dhe mirënjohjes për të gjithë njerëzit e mirë që na rrethojnë, familjarët dhe bashkëpunëtorët, prej të cilëve ne mësojmë çdo ditë dhe arrijmë të kuptojmë se, e kemi të nevojshme në çdo rast të vendosim logjikën në analizën e shkaqeve për të kuptuar pasojat, për të vlerësuar atë çfarë humbasim nga jeta jonë e bukur, duke u bërë pjesë e angazhimit dhe kontributit për hapësira më të gjera solide humane bazuar tek e vërteta, te puna, dinjiteti dhe personaliteti në rrugën e ligjësive të jetës.

Detyra jonë është e shenjtë për t'u bërë arkitektët e denjë të shpirtit njerëzor. Fal punës sistematike, mbështetjes dhe bashkëpunimit të sinqertë me kolegë, prindër e nxënës, shpresojmë të përcjellim një model dhe mesazhet e nevojshme, të cilat marrin karakter rekomandues në përmirësimin e formave të edukimit qytetar, akademik e familjar për motivimin e fëmijëve tanë në këtë periudhë të vështirë të jetës së tyre. Jeta e tyre është vet jeta jonë, pasuria më e madhe shpirtërore, të cilën e kemi detyrim ta ruajmë dhe garantojmë me çdo çmim.

Dr. Denis Çelçima
Mësuese në shkollën e Mesme "Gjergj Kastrioti", Durrës.

2. Programi i Qytetarisë dhe kompetencat kyçe.

Në procesin e studimit dhe fushën aplikative të Programit të Qytetarisë, mbështetemi në trajtimin e elementit më thelbësor në rrugën e formimit të personalitetit psikosocial e profesional tek nxënësit, mbështetur në etikën e qytetarisë dhe formimit të tyre akademik. Kompetencat në vetëdijen dhe veprimtarinë e tyre, shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive të fituara në procesin edukativ, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit, rritjen e motivimit të tyre të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me kushtet shkollore, sociale dhe familjare.
Sipas përcaktimit psikologjik: *Kompetencë. (Authority) Gjendje, kur një individ bashkëvepron suksesshëm me mjedisin, për të përmirësuar jetën dhe arritur qëllimet e veta.*
Në vijueshmëri me synimin dhe qëllimet e arsimit parauniversitar, kompetencat kyçe të arsimit bazë janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.
- Kompetenca e të menduarit.
- Kompetenca e të mësuarit, aftësia për të nxënë.
- Kompetenca për jetën, veprimtaria sociale mbi sipërmarrjen dhe mjedisin.
- Kompetenca personale mbi bazën e motivimit të brendshëm.
- Kompetenca qytetare mbi motivimin e jashtëm.
- Kompetenca digjitale, aftësia e përshtatjes në kohën e kibernetikës.

Hartimi i programit lëndor të Qyetetarisë rrjedh: Nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë, të cilat janë të rekomanduara mga MASH:
Programi i Qytetarisë mbart në thelbin të tij krijimin e kushteve për nxitjen e ***kompetencave të fushës/ lëndës në edukimin qytetar të nxënësve,*** si dhe të certifikimit të kompetencave kyçe që lidhen me lëndën bazë. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet fushës së edukimit qytetar, është komponenti më i rëndësishëm bazë i programit mësimor të formimit qytetar dhe akademik, për të rritur kontributin e nxënësve në shoqëri, në fushat në jetën e përditshme.
Realizimi efektiv i këtij qëllimi paramendon harmoninë midis aspektit pedagogjik dhe motivimit të adoleshentëve drejt kompetencave kuçe. Ndërtimi dhe zbatimi i tyre nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon nga mësimdhënësit mbajtjen parasysh të lidhjes së qenësishme të kompetencave kyçe me kompetencat e fushës apo lëndës për secilën shkallë të nivelit akademik të tyre.
Për realizimin në praktikë të kësaj lidhje mësimdhënësi duhet të jetë i vëmendshëm në përzgjedhjen e situatave socialpsikologjike dhe mësimore që krijohen, veprimtaritë brenda dhe jashtëshkollore, metodat e ndërtimit të punës, të cilat edhe pse jepen jepen në mënyrë të detajuar në programin e librit, mbeten alternative për shkak të situatave me ngjashmëritë dhe veçoritë e tyre.
Kompetenca kyçe me vlera vetjake, përcaktohet mbi bazën e arritjes së integrimit të njohurive psikosociale dhe akademike, aftësive dhe motivimit të adoleshentëve, veprimtarisë

së tyre praktike, qëndrimeve ndaj shkollës, shoqërisë dhe familjes, të cilat ata duhet t'i përfitojnë dhe konsolidojnë gjatë procesit të të nxënit dhe asimilimit të programit të Qytetarisë.
Kompetenca demonstrohet në veprimtarinë praktike nga nxënësi/ja, bazuar në njohuritë që ata kanë dhe paraqitja me aftësi të plota qytetarie e tyre në mjedisin shkollor dhe social. Kjo mënyrë e sjelljes me kompetencë garanton në vijueshmëri perspektivën e sjelljes së adoleshentëve, qëndrimin e tyre ndaj vetes, shoqërisë dhe familjes.
Reflektimi i plotë pedagogjik mbi programin e Qytetarisë, orientimi programor dhe përvoja e trupit pedagogjik, mundëson trajtimin e elementëve psikosocial të organizuar dhe mbështetur mbi konceptin bazë të kompetencave kyçe, të cilat në kompleks arrijnë të krijojnë vetëdijen mbi përqendrimin e nxënësve në atë që ata duhet të mësojnë, të dinë si të veprojnë, të bindur për atë që bëjnë dhe duhet të bëjnë në marrëdhëniet e tyre sociale. Arritja e përvetësimit të kompetencave mbi kuptimin dhe zbatimin e programit të Qytetarisë mundëson tek nxënësit zhvillimin dhe konsolidimin e kompetencave kyçe edhe në fushat e tjera.
P.sh. një sjellje qytetarie e konsoliduar, e shprehur brenda mjediseve të shkollës, nuk ka se si të mos ndikojë në përmirësimin e marrëdhënieve tek adoleshentët në familje, apo rritjen e motivimit të për një nivel të lartë të njohurive akademike në procesin mësimor. Duke respektuar dhe përdorur elementët qytetarë në sjellje dhe veprim, ndikon mjaftueshëm në përzgjedhjen e strategjive në fushat e tjera, veçanërisht në veprimtarinë e tyre brenda trinomit shkollë, shoqëri, familje.
Metodologjia analitike drejt përzgjedhjes e orienton mësuesin në arritjen e mënyrës me efikase të lidhjes së kompetencave kyçe me kompetencat e fushës së Qytetarisë. Brenda 7 elementëve bazë të formimit, pranisë dhe veprimit të kompetencave kyçe, thelbit të përmbajtjes së tyre, ndryshe nga lëndët e tjera të një fushe të caktuar, (shekncat ekzakte apo dixhitale) karakteri i thellë socialpsikologjik i tematikës së programit të Qytetarisë, mund të ndryshojë në mënyrë alternative metodën pedagogjike, duke u dhënë përparësi studimit të elementëve formues të personalitetit në rritje të adoleshentëve.
Në metodën e ndërtimit të programeve apo dhe të mësimdhënies nga mësuesit mund të përdoren të dy teknikat psikologjike, të cilat kanë të bëjnë me aftësinë psikopedagogjike për të studiuar cilësinë e nxënësve në klasë.
Teknika "e mbajtjes së derës të mbyllur" do t'i detyrojë nxënësit të veprojnë sipas kërkesës së mësuesit, duke i përballur ata fillimisht me kërkesa të larta mbi programin e qytetarisë dhe më pas me kërkesa më të ulëta. Dhënia e ngarkesës në fillim të procesit mësimor është një alternativë në dorën e mësuesit.
Mësuesit mund të aplikojnë teknikën tjetër psikologjike, "teknika e mbajtjes së derës hapur", për të arritur mirëkuptimin e plotë me nxënësit, duke kaluar nga kërkesa më të thjeshta drejt kërkesave më të larta. Edhe kjo teknikë mbetet alternative në vlerësimin apo përzgjedhjen e mësuesit në raport me cilësinë mbi aftësitë e nxënësve.

2.1. Rekomandime mbi metodologjinë.

- Kategorizimin e mundshëm tipologjik dhe psikologjik të nxënësve për të lehtësuar punën në përzgjedhjen e tematikave dhe mënyrën e trajtimit të tyre;
- Përzgjedhjen e rezultateve të të nxënit për kompetencat kyçë në kompleks dhe shkallën përkatëse, duke përcaktuar mungesat dhe përparësitë;
- Mbajtjen parasysh të rezultateve të të nxënit për kategoritë e kompetencave kyçe për çdo vit mësimor (veçanërisht vitin paraardhës), të cilat do të shërbejnë për rritjen e shkallës së njohurive në lëndën e Qytetarisë dhe rritjen e kompetencave kyçe;
- Përzgjedhja e rezultateve të të nxënit për çdo element të kompetencave kyçe në fushën e lëndës së Qytetarisë dhe paracaktimi i synimeve në asimilimin dhe arritjet psikosociale dhe akademike të nxënësve;
- Përzgjedhja e programit dhe përmbajtjes së mësimit, mjeteve të konkretizimit të tij, metodologjisë së mësimdhënies, krahasimit dhe ballafaqimit me situatat brenda dhe jashtë shkollës, ku përmes këtyre elementëve mësuesi arrin të realizojë rezultatet e parashikuara të të nxënit të kompetencave të qytetarisë në vitin akademik, krahasuar dhe ballafaquar me kompetencat kyçë në formimin e nxënësve.
- Shtrirja e programit mësimore në një periudhë kohore të mirplanifikuar, mbi mësimdhënien efikase në lidhjen e brendshme shkakësore të tematikës, duke hedhur baza të shëndosha në rezultatet e të nxënit tek nxënësit;
- Realizimi i analizës së arritjeve tek nxënësit mbi bazën e metodës analitike pas realizimit të orëve të mjaftueshme të programit, detyrave plotësuese, testeve dhe intervistave gjysmë të strukturuara, duke bërë verifikimin e përafërt të arritjes së rezultateve të të nxënit në ecurinë e zbatimit të programit vjetor të lëndës së Qytetarisë;

Programi përmban 72 orë, 5 tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi/ja të arrijë të ndërtojë dije të qëndrueshme dhe të zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Bazuar në 5 tematikat e programit është hartuar libri i nxënësit, si dhe ky libër mësuesi, që jep në mënyrë programore të organizuar hap pas hapi, trajtimin e situatës mësimore sipas tematikave në rritjen e vlerave të tyre.
Në këtë libër mësuesi do të gjeni të gjithë elementët përbërës të cilët pasqyrojnë strategjinë e librit në funksion të lëndës së Qytetarisë:

- Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe dhe kompetencës së qytetarisë;
- Planin mësimor vjetor të organizuar sipas tematikave;
- Planin mësimor tremujor;
- Tabelën e organizimit të orës mësimore për çdo temë mësimi;

Libri është i shoqëruar me CD-në, në të cilën do të gjeni fletë pune dhe ushtrime që mund t'i realizoni në klasë me nxënësit, si dhe informacion për të trajtuar orën mësimore. Mbi këto dokumentacione bazë krijohet mundësia për evidencimin e rezultateve kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe, që realizohen nëpërmjet këtij programi.

3. Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Ndërtimi, pranimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e ndërsjelltë me këto kompetenca. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi në mënyrë metodologjike duhet të veçojë dhe përzgjedhë situatat socialpsikologjike dhe mësimore, veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës, metodat dhe mjetet më të përshtatshme në aplikimin e procesit të të nxënit.
Ndërvarësia midis dy kategorive të përcaktimit të kompetencave, imponon analizën mbi lidhjen shkakësore të tyre dhe efektet respektive në formimin e dijeve të qëndrueshme në fushat përkatëse. Lidhjen dhe ndërvarësinë e kompetencave kyçe të fushave dhe përparësitë e kompetencës qytetare do ti mbështesim në analizën sociopsikologjike që vepron në moshën e adoleshencës, ku elementët psikosocial veprojnë në kompleksin e tyre. Koncepti bazë që shpreh përmirësimin e cilësisë së punës të individit në fushën e qytetarisë nuk veçohet nga siguria sociale, familjare, financiare, besimi në vlerat dhe zotësinë personale dhe kushtet aktuale të jetës dhe aktivitetit të tij.
Në këtë periudhë adoleshentët janë nën efektin e procesit kognitiv në përcaktimin e sjelljes së tij dhe sjelljes në grup (klasë) me ndikime të jashtme apo të brendshme. Nëse këto raporte janë të kërcënuara nga mjedisi shkollor, social apo familjar, atëherë adoleshenti i nënshtrohet procesit të tjetërsimit gjatë të cilit ai fillon t'i largohet personalitetit të vet, duke menduar se ai nuk ekziston, ose mjedisi i tij nuk është real. Pamundësia për të përballuar stresin e çastit apo të ditës, prishjen e madhe të gjendjes shpirtërore apo të ekuilibrit emocional, çojnë në prishjen e strukturës bazë të personalitetit.
Kjo situatë shpesh e bën mësuesin të përballet me nxënës që karakterizohen nga kriza e alarmit dhe ankthi i fortë. Mjaftë prej nxënësve në kushte të tilla shfaqin mungesën e dëshirës dhe të motivimit, të cilat ndikojnë edhe në fushat e tjera të kompetencave kyçe.

3.1. Kompetencat kyçe qytetare.

Jo rastësisht kjo kategori trajtohet si parësore në procesin e formimit qytetar dhe akademik tek adoleshentët. *Programi i qytetarisë, si pjesë e fushës së aplikuar "Shoqëria dhe mjedisi", përmes kërkimit tematik dhe praktik, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare*. Në këtë proces sociopsikologjik, synojmë të arrijmë ndryshimin e drejtimit të vëmendjes tek adoleshentët mbi aspektet që ata i preokupojnë duke zgjuar dhe nxitur gjendjen normale të vetëdijes së tyre. Kjo mund të bëhet si pikënisje e gjenerimit të ideve prej tyre dhe arritjes së zgjidhjeve të shumta krijuese për problemet e fushave të tjera pa ju kundërvënë çështjeve programore të qytetarisë.
Mbi këtë arsyetim logjik, ky program parësor kontribuon në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së qytetarisë, nxisin në shkallë të ndryshme zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe, pasi kjo lëndë hedh bazat e formimit të vetëdijes, edukimit, motivimit dhe luan rol të veçantë në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

A) Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.

Kundër obediencës sipas të cilës mbi nxënësin mund të ushtrohet ndikimi social apo pedagogjik gjatë të cilit atij i kërkohet vetëm të bëjë atë që i thonë, Programi i Q*ytetarisë* krijon mundësi për zhvillimin e nismës dhe të shkathtësive komunikuese për të shprehur atë që në fakt ai është. Nxënësi përdor materiale të botimeve shkollore, botimeve artistike e kulturore, printime vizuale dhe digjitale, për të njohur në thellësi dhe eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Nëpërmjet kësaj kompetence, ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe të kuptojë se si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Të mos harrojmë se jemi në periudhën e fillesave të vlerësimit të ***gjuhës trupore***, të komunikimit edhe përmes pozicioneve të lëvizjeve të trupit. Komunikimi përmes simboleve dhe gjuhës trupore për të transmetuar kuptime ose mesazhe, përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj. nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.

B) Kompetenca e të menduarit.

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet, sipas aftësisë për të mësuar e për t'u sjellë në mënyre adaptive.
Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.
Programi i *qytetarisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave. Ushtrimi i disa koncepteve të matematikës logjike në mënyrën e të menduarit, jep mundësi edhe për zgjidhje të tjera në fusha të ndryshme të kompetencave kyçe.

C) Kompetenca e të nxënit

Kjo kompetencë e orienton nxënësin drejt një kursi veprimi të pavarur, pasi arrin të vlerësoj pozitën e tij në raport me shkollën, familjen dhe shoqërinë. Strategjia që ai zgjedh ka të bëjë me kompetencën e dijeve për atë që duhet bërë në një dimension më të gjerë se sa klasa, për të mundësuar përdorimin e kompetencës së të nxënit në përmirësimin e kushteve në mjedisin që e rrethon. Kjo mundësi e veçon atë nga të tjerët dhe e kthen në shembull për të tjerët.
Sot mundësitë në fushën e të nxënit janë të pamata. Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.
Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstron respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.
Ekzistojnë edhe dukuri të tjera pozitive që shtojnë vlerat e kompetencës së të nxënit, duke e kthyer atë si pikënisje e rritjes së vlerave për kompetencat e tjera kyçe.

D) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.

Ngjarjet që ndodhin jashtë trupit dhe vetëdijes së nxënësit ndaj të cilave ata reagojnë në mënyra të ndryshme, mund të përfshihen në ngjarje të brendshme me ndikime fiziologjike, emocionale dhe shpirtërore, duke shfaqur ndikimin mbi kompetencat e tyre për jetën dhe veprimtarinë në mjedisin shkollor e shoqëror. Procesimi i informacionit të niveleve të ndryshme të vetëdijes, gjendja në të cilën nxënësit janë të vetëdijshëm për ndijimet, mendimet dhe ndjenjat që kanë, i bën ata më aktiv në këtë kompetencë kyçe. Ata nuk janë të shkëputur nga ky mjedis, përkundrazi.
Nëpërmjet kësaj kompetence kyçe, nxënësit arrijnë të zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.
Në këtë sipërmarrje shpirtërore dhe konkrete, ata karakterizohen nga ndijimi, si stadi i parë i vetëdijësimit për mjedisin që i rrethon. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

E) Kompetenca personale.

Dëshira për t'i kryer gjërat me cilësi të lartë nxit kompetencën kyçe personale.
Karakterizohet nga përpunimi i informacionit (Information processing), duke e përfshirë në një veprimtari mendore aktive, që synon në ruajtjen dhe ristrukturimin e informacionit, gjithashtu në formatimin e një modeli njohës, që bazohet në analogjinë e mendjes njerëzore me atë të kompjuterit etj.
Programi i qytetarisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tij në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohet të jetë i pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve.
Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit. Në kushtet e veprimit të kësaj kompetence, nxënësi priret nga akti i mbështetjes së një nxënësi tjetër, i ndikuar nga sjellja prosociale. Nevoja për atashim e orienton drejt dëshirës për të qënë në veprimtarinë e tij së bashku me të tjerët.

F) Kompetenca digjitale.

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme, kur është i interesuar të kërkojë, krijojë, të përpunojë, nëpëmjet komunikimit me idetë, dukuritë dhe fenomenet e fushave të ndryshme që merren nëpëmjet informacionit kompjuterik mbi dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj. në funksion të edukimit të tij qytetar. Aftësia për të shfrytëzuar informacionin e pafund në mënyrë përzgjedhëse, dikton ndikimin e mësuesit në këtë ndërveprim. Kjo mënyrë trajtimi rrit kompetencën dixhitale dhe aftësinë intelektuale në rritjen e nivelit edukativ dhe akademik.

3.2. Diagrami 1 : Disa rezultate të të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë



Fig. nr. 1

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

(*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)*

Nxënësi:

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, kërkuar sqarime dhe dhënë propozime;
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj. duke e komentuar drejt dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit
(*Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese)*

Nxënësi:

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;
- Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror);
- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë;
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore;
- Përdor krahasimin dhe kundërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënit
(Nxënësi mëson për të nxënë)

Nxënësi:

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;

- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitje logjike;
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur;
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve e mjeteve gjatë kryerjes së një detyre /aktiviteti (në klasë / shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
(*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)*

Nxënësi:

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre;
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca personale.
(*Nxënësi bën jetë të shëndetshme)*

Nxënësi:

- Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare
(Nxënësi i përkushtohet të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit;
- Merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale
(*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)*

Nxënësi:

- Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

4. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato kanë natyrën teoriko praktike, me efekte formuese dhe vepruese. Këto tema i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar, tradita dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Vlerësimi i elementëve të sigurisë.
- Bashkëjetesa paqësore.

Këto tema mbështeten në zhvillimin e nxënësve, kur ata arrijnë të përvetësojnë dhe zbatojnë standardet e shoqërisë ku jetojnë, qoftë për fenomenet pozitive dhe ato negative që shfaqen brenda shoqërisë. Zhvillimi i vetëdijes mbi sjelljen morale bazohet në trajtimin e temave ndërkurrikulare, duke forcuar kompetencat qytetare tek nxënësit. Ky zhvillim kognitiv (Cognitive development) përfshin ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës tek nxënësit në mënyrën e të menduarit, në formimin dhe konsolidimin e kujtesës së tyre, në komunikimin social dhe arritjen e zgjidhjes së problemeve personale brenda kuadrit të veprimit shoqëror. Në trajtimin e temave ndërkurrikulare ndryshimet graduale dhe të rregullta që reflektohen në kompletimin e dijeve tek nxënësit, arrijnë të formojnë procese mendore më komplekse dhe më të sofistikuara, zhvillimin e shprehive të të menduarit dhe zgjidhjes së problemeve. Ky aspekt mbetet misioni dhe qëllimi kryesor i Lëndës së Qytetarisë.
Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësisë qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai arrin të kuptojë në nivelin e ndërgjegjësimit aspektet e shumta shoqërore të konsumit, përparësitë dhe pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe mekanizmat m b i shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të tij në raport me mjedisin dhe veprimtarinë njerëzore. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet sociale, politike dhe ekonomike me karakter ndërkombëtar dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh dhe përcakton qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi

kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

4.1. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Lënda e qytetarisë (Njohuri për shoqërinë klasa X) duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën në zgjerimin dhe plotësimin e njohurive të nxënësit në interes të formimit dhe sjelljes qytetare. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Shembuj:

4.2. Historia dhe qytetaria

Lënda e historisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët:

- **Konceptet**: për shembull pushteti dhe shteti, raportet midis tyre, autoriteti institucional dhe pavarësia dhe ndërveprimi, sundimi i ligjit drejt shtetit demokratik ligjor, mënyrat e qeverisjes dhe ana sociale e tyre, përfaqësimi në nivelet e pushtetit, liria dhe te drejtat njerëzore etj.
- **Aftësitë dhe shprehitë**: për shembull përshkrimi i këtyre dukurive dhe fenomeneve sociale e institucionale mbi bazën e interpretimit ligjor dhe kushtetues, analiza e situatave në aspektin social politik dhe ekonomik, shpjegimi i tyre mbi baza juridike dhe shkencave të tjera, aftësia për tu përfshirë në diskutimin e tyre me kompetencë, aftësia për të bërë kërkime në kuadrin e vlerësimit dhe plotësimit të interesave vetjake dhe shoqërore, mënyra e interpretimit të dukurive dhe fenomeneve etj.

Qytetaria: U jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe qytetarisë?

- **Së pari,** kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, fakteve, ngjarjeve etj. të trajtuara në lëndën e historisë në kurrikulën e qytetarisë, me kusht

që përmasa e qytetarisë duhet të jetë çështja thelbësore e mësimit dhe të lidhet me kurrikulën e qytetarisë.

- **Së dyti,** objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm:

Konceptet: Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
Tema: Në disa mësime mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
Fusha kurrikulare: Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia, ligji, të drejtat njerëzore etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
Përmasa vendore: historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen shtresa të ndryshme shoqërore.

- **Së treti,** historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme, me deduksione në shërbim të së ardhmes. Mbështetja në analizën e ngjarjeve historike ofron zgjidhjen e problemeve (Problem solving), ofron zgjidhje të reja kundrejt problemeve të panjohura që shfaqen, duke ofruar ndryshime në zbatimin e thjeshtë të rregullave dhe normave të qytetarisë të mësuara më parë.

4.3. Gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria

Çfarë kanë të përbashkët gjeografia (dituria e natyrës) dhe qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet**: të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen**: bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj.
- **Temat**: strehimi, komunikimi etj.

Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së qytetarisë?

- Ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë.
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

Në ç'mënyrë lënda e qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë?

Qytetaria:

- zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme;

- nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën "Shoqëria dhe mjedisi", në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe, në sasinë dhe cilësinë e mundshme të kompetencave të tjera.
Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore. Në mënyrë të veçantë, në shoqërinë demokratike me larmi alternativash mbi aftësitë dhe mundësitë ofron zgjidhjen e konflikteve në të gjithë situatat kur kjo është e nevojshme.
Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë e tyre bazë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive në jetën demokratike.

Në mënyrë të detajuar parashtrojmë:

- Nxënësi njeh dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë mbi përgatitjen e tij për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.
- Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.
- Nxënësi argumenton që, kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të funksionimit të demokracisë, drejtësisë, barazisë, qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut,.
- Nxënësi argumenton që, kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.
- Nxënësi përdor konceptin filozofik mbi kohën dhe hapësirën në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.
- Nxënësi nëpërmjet koncepteve gjeopolitike zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, zgjeron rrethin e tij të dijeve, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.
- Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisi.
- Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për

reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian.

- Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë.
- Nxënësi njeh konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë.
- Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve.
- Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.
- Nxënësit vlerësojnë diversitetin, respektojnë të tjerët dhe përgatiten për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.
- Nxënësit zhvillojnë vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe Evropian, si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënit të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Këto tematika janë:

- Individët, grupet, shoqëria.
- Kultura.
- Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi.
- Pushteti, autoriteti, qeverisja.
- Koha mësimore dhe rezultatet e pritshme të të mësuarit për tematikë

Programi i lëndës së qytetarisë për klasën X zhvillohet në 70 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për

secilën tematikë.

6. Lëndës së Qytetarisë për shkallën e pestë (klasa 10)

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin në lëndën e Qytetarisë

- Rrit nivelin qytetar nëpërmjet përdorimit dhe shfrytëzimit të mediave digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Prezanton shkallën e njohurive qytetare dhe qëndrimin e tij nëpërmjet përdorimit dixhital të imazheve për të krijuar mundësi praktike në prezantimin e tij.
- Përvetëson informacionin nëpërmjet përdorimit të avantazheve dhe disavantazheve të teknologjive të ndryshme duke arritur një komunikim të gjerë nëpërmjet videove dhe mjeteve të komunikimit masiv; e-mail, CD-messenger etj.
- Rrit aftësitë në analizën, vlerësimin dhe menaxhimin e informacionit të marrë në mënyrë elektronike, duke administruar atë në mënyrë statistikore e tabelore.
- Përcakton mjetet e duhura teknologjike për qasjen në informacione dhe burime elektronike.
- Zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre. Në tërësinë e informacionit dixhital është në gjendje të përcaktojë burimet dhe vërtetësinë e tij.
- Ndërton sisteme të teknologjisë së informacionit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe daljes së informacionit, si dhe të feedback-ut të marrë nga mësuesit ose nxënësit e tjerë.
- Debaton mbi ndikimin, avantazhet dhe disavantazhet e teknologjive ekzistuese dhe të reja në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.

- Veçon informacionin kryesor nga një burim digjital (internet, radio, TV etj.) e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë studimit të një punimi ose detyre me shkrim.
- Përdor programet kompjuterike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

Nxënësi/ja:

- Bën jetë të shëndetshme nëpërmjet njohjes dhe vlerësimit të shenjave, simboleve që paralajmërojnë rrezikshmëri në përdorimin e produkteve apo objekteve konkrete rë rrezikëshme për jetën.

Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët;

- Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe jashtë saj dhe propozon masa konkrete për parandalimin e tyre duke përdorur mjetet digjitale;
- Merr pjesë në rrjetet sociale që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor,

etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese;

- Zgjidh një problem dhe arsyeton për zgjedhjen e procedurave përkatëse;
- Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë.

Nxënësi/ja mëson për të nxënë;

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme digjitale (internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes.

Për të ndihmuar në organizimin e mësimit me bazë kompetencat, në paragrafin në vijim jepen kompetencat e lëndës së Qytetarisë dhe shpjegimi i tyre. Këto kompetenca duhet të jenë në fokus të organizimit të tematikës mësimore.

6.1. Kompetencat e fushës.

Rritja e aftësisë për të arritur një gjykim dhe arsyetim të shëndetshëm tek nxënësit në rritjen e shkallës së inteligjencies së tyre, është një prej detyrimeve cilësore të ndërtimit të programit të Qytetarisë. Në aspektin psikosocial, nxënësi duhet të ketë të qartë konceptim mbi vendin e kontrollit (Locus of control), për të perceptuar në çdo kohë se "ku" shtrihet për dikë përgjegjësia për dështimin apo suksesin, nëse kjo ndodh brenda ose jashtë tij. Kjo analizë lidhet drejtpërdrejtë me atribuimin dhe motivimin e nxënësit, nëpërmjet vetanalizës dhe vetëkritikës dhe krijon aftësinë për nxitjen e ballafaqimit me elementët thelbësore të kompetencave kyçë dhe përmirësimin gradual të qëndrimit ndaj etikës dhe normave qytetare. Kjo mënyrë të menduari nxit:

- Etikën qytetare në mbështetje të kreativitetit dhe inovacionit;
- Etikën qytetare në bazën e komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Etika qytetare mbi rrugët dhe mundësitë e kërkimit dhe gjetjes së informacionit;
- Etikën qytetare mbi mendimin kritik që ofron vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve;
- Etikën qytetare në mbështetjen e operacioneve bazë të veprimtarisë sociale e mbështetur në përparësitë dhe konceptet teknologjike.

Është kjo mënyrë të menduari që vijëzon ne vetëdijen qytetare tek nxënësit vizionin (Vision), ku gjen terren mental dhe hedh rrënjë aftësia mbi parashikimin e mendimeve të qarta për perspektivën, që pasohen prej tyre nga qëndrimet e vlerësimet të drejta në praktikë.

6.2. Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave

Etika qytetare në mbështetje të kreativitetit dhe inovacionit;

- Përdorimi i teknologjisë për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin në produktet që realizon gjatë proceseve të punës.
- Zhvillon përmbajtjen me krijimin e formateve të ndryshme duke përfshirë multimedian, për të rregulluar dhe përmirësuar përmbajtjen që ai ose të tjerët kanë krijuar, të shprehë kreativitetin nëpërmjet mediave dhe teknologjive digjitale.
- Nëpërmjet integrimit dhe ripërpunimit arrin të modifikojë, pastrojë dhe përpunojë burimet ekzistuese të informacionit për të krijuar përmbajtje dhe njohuri të reja, origjinale dhe të përshtatshme.
- Mbi bazën e kompetencave kyçe të zhvillojë aftësitë programuese dhe të arrijë të aplikojë parametra të rinj, modifikime në interes të përbashkët.
- Të bashkëveprojë nëpërmjet llojeve te ndryshme pajisjesh dhe aplikacioneve digjitale, të kuptojë se si komunikimi digjital është shpërndarë, paraqitur dhe drejtuar, të kuptojë rrugët e përshtatshme të komunikimit nëpërmjet mjeteve digjitale, t'u referohet formateve të ndryshme të komunikimit, të përshtatë modelet dhe strategjitë e komunikimit për një audiencë specifike, në shërbim të qëllimeve të tij.
- Të ndajë me të tjerët vendndodhjen dhe përmbajtjen e informacionit të gjetur, të jetë i gatshëm dhe në gjendje për të ndarë njohuritë, përmbajtjen dhe të veprojë si ndërmjetës, të jetë aktiv në shpërndarjen e të rejave, përmbajtjeve dhe burimeve, të dijë rreth praktikave dhe të integrojë informacion të ri në trupin e njohurive ekzistuese.
- Të realizojë angazhimin e qytetarisë online duke marrë pjesë në shoqëri nëpërmjet angazhimeve online, të kërkojë mundësi për vetëzhvillimin dhe fuqizimin duke përdorur teknologjitë dhe mjediset digjitale, të jetë i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive për pjesëmarrjen e qytetarëve.
- Të jetë bashkëpunues nëpërmjet kanaleve digjitale: të përdorë teknologjitë dhe median për punën në grup, të bashkëpunojë në proceset e bashkëndërtimit dhe bashkëkrijimit të burimeve, njohurive dhe përmbajtjes.

Etika qytetare në bazën e komunikimit dhe bashkëpunimit

- Në bazë të kërkesave të etikës qytetare të komunikimit dhe basjhkëpunimit të veproje teoria psikologjike e kontaktit, e cila arrin të bind nxënësit se respektimi i këtyre dy elementëve arrin të pakësojë paragjykimet në marrëdhëniet midis individëve në mjedisin social.
- Etika e komunikimit të respektojë vlerat e jashtme me qëllim që rezultatet e arritura të kenë efekte edhe për kushte e subjekte të tjera.
- Etika e komunikimit online: të dijë dhe të njohë si janë rregullat e sjelljes online/ ndërveprimet virtuale, të jetë i vetëdijshëm për aspektet e diversitetit kulturor, të jetë i aftë të mbrojë veten dhe të tjerët nga rreziqet e mundshme online, të zhvillojë

strategjitë aktive për të zbuluar sjelljet e papranueshme.

- Administrimi i identitetit digjital: të krijojë, adaptojë dhe drejtojë një ose më shumë identitete digjitale, të jetë i aftë të mbrojë reputacionin e dikujt, të merret me të dhënat që ai prodhon përmes disa llogarive të aplikimeve.

Etika qytetare mbi rrugët dhe mundësitë e kërkimit dhe gjetjes së informacionit;

- Shfletosja, kërkimi dhe filtrimi i informacionit: të hyjë dhe të kërkojë informacion online, të artikulojë nevojat informative, të gjejë informacionin e përshtatshëm, të zgjedhë burimet efektive, të lundrojë ndërmjet burimeve online, të krijojë strategji personale informacioni.
- Vlerësimi i informacionit: të mbledhë, të përpunojë, të kuptojë dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin.
- Ruajtja dhe rigjetja e informacionit: të ndryshojë dhe të ruajë informacionin dhe përmbajtjen për korrigjim më të lehtë, të organizojë informacione dhe të dhëna.

Etika qytetare mbi mendimin kritik që ofron vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve;

- Zgjidhja e problemeve teknike: të gjejë problemet e mundshme dhe t'i zgjidhë ato (nga *trouble-shooting* në zgjidhjen e problemeve më komplekse) me ndihmën e mjeteve digjitale.
- Gjetja e nevojave dhe përgjigjeve teknologjike: të vlerësojë nevojat e veta në termat e burimeve, mjeteve dhe zhvillimit të kompetencave, të përshtatë nevojat me zgjidhjen e mundur, të për- shtatë mjetet me nevojat personale, të vlerësojë në mënyrë kritike zgjidhjet e mundshme dhe mjetet digjitale.
- Gjetja e boshllëqeve të kompetencave digjitale: të kuptojë kur kompetencat e veta nevojiten të përmirësohen ose të përditësohen, të mbështesë të tjerët në zhvillimin e kompetencave të tyre digji- tale, të mbajë dhe të japë zhvillimet e reja.

Etika qytetare në mbështetjen e operacioneve bazë të veprimtarisë sociale e mbështetur në përparësitë dhe konceptet teknologjike.

- Mbrojtja e dinjitetit dhe personalitetit të tij nëpërmjet mbështetjes së operacioneve në bazën e veprimtarisë sociale, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron hapësira e gjerë e komunikimit masiv dixhital.
- Mbrojtja e të dhënave personale: të kuptojë termat e zakonshme të shërbimit, të aktivizojë mbrojtjen e të dhënave personale, të kuptojë privatësinë e njerëzve të tjerë, të mbrojë veten nga mash- trimet dhe kërcënimet në internet.
- Mbrojtja e shëndetit: të shmangë, në të mirën e shëndetit fizik dhe psikologjik, rrezikun që lidhet me përdorimin e teknologjisë në termat e kërcënimeve.
- Mbrojtja e pajisjeve: të mbrojë pajisjet e veta dhe të kuptojë rreziqet online dhe kërcënimet, të marrë njohuri rreth mbrojtjes dhe masave të sigurisë.
- Mbrojtja e mjedisit: të jetë në proces përqendrimi të vazhdueshëm ndaj ngacmuesve të veçantë të mjedisit. Të jetë i vetëdijshëm për ndikimin e programit të Qytetarisë në mbrojtjen e mjedisit, duke u bërë pjesë integrale e zbatimit të tij.

7. Udhëzime metodologjike

Nëse ka diçka të përbashkët në profesionin fisnik tek mësuesit, ato janë metoda dhe metodologjia, të cilat po aq sa përfaqësojnë vlerat e tyre përgjithësuese, po aq shfaqin individualitetin profesional në interes të rritjes cilësore të mësimdhënies.
Ky këndvështrim në mënyrë logjike dhe studimore, arrin në vija të përgjithshme dhe të detajuara të përcaktojë saktë linjat kryesore të metodës së mësimdhënies, bazuar në renditjen dhe cilësinë e temave të përzgjedhura, duke mundësuar përvoja të reja. Metoda studimore shkencore e aplikuar me sukses në tërë procesin e dhënies dhe asimilimit të temave të programit dhe rezultateve konkrete, ndërtohet mbi bazën e bashkëpunimit dhe ndërveprimit, duke u bazuar në një punë sistematike të evidencimit të rezultateve.
Metoda studimore shkencore e evidencimit dhe kërkimit në fushën interesante të edukimit qytetar të nxënësve, si një prej angazhimeve më të vështira dhe më serioze në misionin e mësuesit, nëpërmjet analizës dhe kritikës, mundëson arritjen e njohurive dhe përvojave të reja në mësimdhënie, të cilat marrin karakterin e tyre përgjithësues.
Mbi këto rekomandime metodologjike, lënda e Qytetarisë në mënyrë studimore merr rëndësinë e saj teorike, praktike dhe aplikuese, e ndërthurur me të rejat që burojnë nga respektimi i standardeve të kohës, të cilat krijojnë hapësira për variante alternative në gjykimin dhe vendimmarrjen e mësuesit. Metoda bazë është analiza kritike, ndaj asaj që kemi bërë mirë në edukimin qytetar të nxënësve dhe ana tjetër, ndaj mosarritjeve në përmbushjen e objektivave të programit të qytetarisë.
Rëndësia teorike qëndron në aftësinë për të parashikuar element cilësorë të trajtimit teorik të qytetarisë, të tërheqjes së nxënësit në procesin e edukimit qytetar jo vetëm brenda korrnizave të programit, por me mundësi për zgjerimin e njohurive mbi Etikën Qytetare dhe Sjelljen.
Rëndësia praktike, qëndron në pritshmërinë e përfundimeve që arrihen nga viti në vit, të cilat ndihmojnë me përvoja të reja në përsosjen e metodologjisë së realizimit të lëndës së Qytetarisë, duke sjellë kënaqësinë e arritjeve maksimale në vlerësimin e nxënësit.
Duke u mbështetur në planin praktik të realizimit të programit, në mënyrë të detajuar do të japim disa element ndihmues të cilët duhen respektuar:
Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në:

- Ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- Shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- Nxitja e nxënësve në përzgjedhjen e strategjive të tyre vetjake, mbështetur në aftësitë individuale;
- Pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- Pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- Përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Qëllimi për edukimin e nxënësve arrihet nëpërmjet zbërthimit të elementëve të programit mbështetur në përdorimin e metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë bashkëpunimin harmonik midis mësimdhënies dhe të nxënit. Në këtë proces kompleks,

ndërthuren realizimi i objektivave të përgjithshme dhe specifike të edukimit, të cilat mbështeten kryesisht në fushën e edukimit me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, elementët edukativ kulturor, humanitar e paqësor, edukimin e përgjithshëm me koncepte globale, duke respektuar dhe përcjellë vlerat edukative të mediave, mjedisit, kodit penal e rrugor, mënyrës së trajtimit ekonomik, normave të sigurisë etj.
Programi i lëndës së Qytetarisë është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënit, ku roli i mësuesit shfaqet thjesht transmetues i dijeve, kurse nxënësi mund të jetë një dëgjues pasiv.

7.1. Diagram nr. 2: Metoda alternative në Lëndën e Qytetarisë



Fig. nr. 2

Program i Qytetarisë motivon ndërveprimin e efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe më të mëdha, midis punës së pavarur dhe ndërveprimit individual. Në këtë kuadër, përparësi merr respektimi i standardeve programore dhe orientimi alternative për stimulimin e ideve të ndryshme, të cilat burojnë nga pjesëmarrja aktive e nxënësve në orën mësimore, reflektimi i tyre kritik i ballafaquar me realitetin dhe

cilësinë e koncepteve referuese teoriko praktike të lëndës. Rëndësi në këtë proces kompleks merr produkti i veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme të edukimit. Produktiviteti i nxënësve është treguesi më cilësor i zbatimit të programit të Qytetarisë.
Objektivat dhe synimet e Lëndës së Qytetarisë vlerësohen në shkallën sipërore krahasuar me lëndët e tjera. Përmbajtja e tyre del jashtë kufizimeve të orës mësimore dhe pranisë e ndikimit të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo në mënyrë të kënaqshme thyen "disiplinën" mësimore në klasat tona. Ajo kërkon dhe pranon debatin, gjallërinë, mbajtjen e qëndrimeve, shfaqjen e opinioneve, këndvështrimet e shumëllojshme prej nxënësve. Arritja e kësaj metode nuk është diçka e lehtë, pasi ajo kërkon mbështetjen e shumë elementëve të tjerë si atribute personale të mësuesve që kanë të bëjnë me formimin gjuhësor, termat studimore shkencore, dijet e formimit të përgjithshëm mbi bazën e informacioneve të reja, mënyrën e komunikimit, atdhedashurinë, formimin mbi vlerat kombëtare e historike, njohjen e traditës etj. të gjitha këto përballë aftësive personale të të nxënit të nxënësve Brenda një hapësire komplekse që krijohet nga nevoja e ndërtimit të kurrikulës në të gjithë ciklin vjetor të formimit akademik.
Parë në këtë kontekst, lënda e Qytetarisë ndërthuret dhe arrin të integrojë natyrshëm të gjithë njohuritë e marra në lëndët e tjera të programit shkollor.
Aspekt tjetër i metodologjisë në shtjellimin e lëndës së Qytetarisë është hapësira për prurje në orën mësimore të përvojave personale të nxënësve, ngjarjeve të ndryshme që ata kanë përjetuar në komunitetin ku bëjnë pjesë, si raste konkrete të studimit nga mësuesit për tema të reja mësimore me interes, të cilat plotësojnë më së miri vetaktualizimin e lëndës dhe objektiva që synon të përmbushë ajo. Hapësira studimore si prurje dhe produkt i angazhimit të nxënësve në orën mësimore, i kërkesave dhe përvojave të tyre shërbejnë si ura lidhëse midis teorisë dhe praktikës, bazë për formimin e nxënësve në shkollë të lidhur fortë me jetën reale. Kjo mënyrë ndërveprimi dhe pasurimi në programin e qytetarisë do të reflektojë natyrshëm në qëndrimin e tyre pozitiv ndaj shkollës dhe jetës, sepse ata ndihen të respektuar brenda grupit shoqëror në mendimet dhe tendencat në rritje të sjelljes së tyre qytetare.
Mësuesit mund të përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhënien e tyre metoda të ndryshme, por program i qytetarisë në këtë libër mësuesi kërkon planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues - nxënës, mjedis fizik, materiale didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

7.2. Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së qytetarisë?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga këto ndryshime lidhen me:

Dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të

veçanta në:

- Lëndët mësimore;
- Teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor;
- Përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative si në fushën e sjelljes, njohurive dhe humanizmit;
- Parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënit; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;

Procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj, në të gjitha përmasat e tij:

- Në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm;
- Në administrimin elastik të orëve të mësimit dhe të grupeve;
- Në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim;
- Në vlerësimin e ndërsjellë;

Synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për elementët e rinj të qytetarisë demokratike, përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- Aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tijat;
- Aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- Aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- Aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- Aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- Gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësime prej tyre;
- Aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.

8. Mjedisi i të nxënit të qytetarisë demokratike

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedis të nxëni demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë elementët kompleks të saj, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimeve, sa më shumë të jetë e mundur në plotësimin e kurrikulës së arsimit formal dhe joformal.
Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.
Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe komunitetit, duke nënkuptuar bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë, ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare pë zhvillime autonome në të gjitha nivelet.
Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës dhe të sjelljes demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen e aspiratave të nxënësve dhe të rinjve për t'u dëgjuar;

- Duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike;
- Duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave;
- Duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit;
- Duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës për të shfrytëzuar ICT në fushën e edukimit për qytetari demokratike;
- Duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjësisë shoqërore.

8.1. Nxënësit me nevoja të veçanta

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, strategji dhe interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënit të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë.
Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.
Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënit, mund të zhvillohen programe të veçanta përzgjedhëse, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve, që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që trupi pedagogjik i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vet nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar.
Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.
Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

9. Udhëzime për vlerësimin.

Kompetencat e lëndës së qytetarisë përfshijnë tre elemente të ndërlidhura me njëri - tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale, aftësitë e pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare.
Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve, të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.
Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Ku sanksionohen këto të drejta qytetare në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Cilat janë vlerat demokratike dhe raportet midis pushtetit dhe shtetit?
- Çdo të thotë pavarësi e pushteteve?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuara gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Si ndikon ndjenja e atdhedashurisë në edukimin qytetar të nxënësve?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

Aftësitë intelektuale e **pjesëmarrëse** të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.
Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të të qënit qytetar i vendit. Këto aftësi i ndihmojnë nxënësit - qytetarë të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të jetës publike.
Aftësitë pjesëmarrëse i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike

dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.
Një pjesë e rëndësishme në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi të aftësive pjesëmarrëse, në atë shkallë që është e mundshme. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë *edhe matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse.* Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.
Elementi i tretë janë ***prirjet qytetare*** që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.
Në këtë udhëzim vlerësimi përfshihen:

- Prirjet për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë;
- Prirjet për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor;
- Prirjet për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit;
- Prirjet për t'iu bindur "rregullave të lojës", si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave;
- Prirjet për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë***. Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar***.
Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare, të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohet të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinioneve të të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, institucione shtetërore, rajone banimi e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

10. Materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën ***"Shoqëria dhe mjedisi",*** ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të

jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.
Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi dhe histori është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.
Në shfrytëzimin e materialeve burimore mbi edukimin qytetar mund të mbahen parasysh edhe këto sugjerime:

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet ëeb për njohuri për shoqërinë.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit për temat që studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm softëare.
- Përdorimi i simulimeve software.
- Përdorimi i grafikëve software.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

* * *

Lënda e Qytetarisë në specifikën e saj detyron mësimdhënësin dhe nxënësin të shikojnë me vizion të qartë strategjik, të shtrirë në kohë dher hapësirë. Sjellja e këtij fenomeni shoqëror me përfundime dhe rekomandime alternative më pranë realitetit të sotëm të shkollës, familjes dhe të shoqërisë shqiptare, do të synojë zgjerimin e hapësirave të ndikimit pozitiv të të saj në mjedisin shkollor shqiptar dhe ngushtimin e hapësirave të tradicionalizmit. Në lidhjen filozofike shkak - pasojë, nuk mund të pranohet më që në kohët moderne të qytetarisë demokratike, tabutë, steriotipet, shabllonizmat, autoritarizmi pedagogjik dhe negativitete të tjera të trashëguara të shkaktojnë tronditje të rënda psikologjike në qytetarët e ardhsëm të Shqipërisë. Ne mendjet, zëmrën dhe duart tona kalon e ardhmja e vendit dhe e shoqërisë, ekzistenca dhe zhvillimi perspektiv i saj në shërbim të Qytetarisë dhe vlerave të Identitetit Kombëtar.

PLANI MËSIMOR VJETOR

LËNDA: Qytetari

KLASA X

GJIMNAZI“ ”

36 javë x 2 orë = 72 orë

	Kompetencat e fushës		**Shkathtësitë që do të realizohen në komunikim përmes:**	**Orë**
1.	• *Analiza dhe interpretimi i koncepteve dhe kryesore* • *Vlerësimi i situatave të caktuara duke i krahasuar me realitetin*	70%	**Njohuri të reja**	**50**
2.	**Përpunim njohurish**	23%	**Përsëritje**	**5 orë**
		41%	**Veprimtari praktike**	**9 orë**
		18%	**Testime**	**4 orë**
		18%	**Projekt**	**4 orë**
				22 orë
	Gjithsej	100%		**72 orë**

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator – Dhjetor **24 orë**	**Janar - Mars** **24 orë**	**Prill - Qershor** **24 orë**
Ligji dhe Shoqëria	**Ligji** (*kuptimet, qëllimet natyra dhe funksionet e tij.* *Rëndësia e ligjit në shoqëri,vlerat e tij* *Zbatimi i ligjit dhe rëndësia e zbatimit të tij në shoqëri)* **(6 orë)**	**Arsimimi** (*konventa për të drejtat e fëmijëve,ligjet shqiptare për arsimin,çfarë duhet të studiojmë në shkollë dhe pse,cilësia dhe barazia në arsim,si sigurohen shanse të barabarta në arsim)* **(6 orë)**	**Puna** (*kushtetuta për të drejtat e punës, kodi i punës dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, roli i legjislacionit të punës në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, kushtet e punës)* **(6 orë)**
Kushtetuta	**Kushtetuta** (*ligji themeltar i shtetit,mjeti kryesor i qeverisjes ,raporti ndërmjet lirisë dhe barazisë,organizimi i organeve të shtetit)* **(5 orë)**	**Shëndeti** (*shëndeti si një e drejtë themelore e njeriut,parandalimi i sëmundjeve,mbrojtja e shëndetit në vendin tonë,armiqtë kryesor të shëndeti*) **(6 orë)**	**Siguria rrugore** (*kodi rrugor, sinjalet rrugore dhe kuptimi I tyre,këmbësorët,qarkullimi I këmbësorëve,kalimi I rrugës,kalimi I këmbësorëve në kryqëzime*) **(8 orë)**
Të drejtat e njeriut	**Të drejtat e njeriut** (*kategoritë e të drejtave të drejtat civile politike, ekonomike të drejtat në konflikt kufizimi i të drejtave.*) **(10 orë)**	**Mjedisi** (*ekologjia,rreziqet për mjedisin,mjedisi i shëndetshëm si një e drejtë themelore,energjia,kontradiktat e zhvillimit*) **(6 orë)**	**E drejta për informim dhe ligji për mediat** (*informimi dhe rëndësia e tij,informimi dhe mjetet e tij,mjetet e reja të informimit,media dhe mitet e saj,Tv dhe i ligji për fëmijët rreziqet*) **(6 orë)**

Arsimimi	**Arsimimi (***shkolla dhe funksionet,arsimimi si e drejtë themelore,konventa për të drejtat e fëmijëve,ligjet shqiptare për arsimin***)** **(6 orë)**	**Konsumatori** *(e drejta e konsumatorit dhe përmbajtja e saj cdo të thotë të jesh konsumator,faktorët që ndikojnë në sjelljet tona si konsumator* **)** **(8 orë)**	**Bashkëjetesa në komunitet (***bashkëpronësia dhe bashkëpronarët,asambleja e bashkëpronarëve,rregullorja e asamblesë,marrja e vendimeve për bashkëpronësi***)** **(3 orë)**

Lënda: QYTETARI

Fusha : Qytetari

Shkalla: 5

Klasa: X

Viti shkollor: 2017-2018

PËR TREMUJORIN E PARË
(Shtator - Dhjetor)

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: • shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; • dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme,duke bërë pyetje, komente,sqarime dhe propozime; • shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; • veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj.,e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi/ja: • parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie; • zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse; • përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror); • shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë; • krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore; • përdor krahasimin dhe kondërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.
Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja: • përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; • shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; • zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim(tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë,veprim,aktivitet ose detyrë që i kërkohet; • ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike;

• parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur; • menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi/ja: • zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin; • diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre; • bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
Kompetenca personale Nxënësi/ja: • vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.
Kompetenca qytetare Nxënësi/ja: • tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit; • merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik,fetar,gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.
Kompetenca digjitale Nxënësi/ja: • përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive; • analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash; •zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

Nr.	Java	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	*Java I*	Kapitulli I Ligji dhe shoqëria (6 orë)	Ligji dhe funksionet e tij	Ftesë për diskutim mbi domosdoshmërinë e ligjeve në shoqëri	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	Vlerësim diagnostikues Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, historia filozofia
2.			Rëndësia e ligjit në shoqëri	Diskutim mbi një situatë konflikti për një vendim të padrejtë të gjykatës	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor,filozofia, interneti
3.	*Java II*		Ligji dhe vlerat	Diskutim mbi një situatë mbi organizimin e një mbrëmje të rëndësishme ku marrin pjesë ambasadorë nga vende të ndryshme	Hetimi dhe zbulimi;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor,sociologjia, interneti
4.			Llojet e ligjeve	Ftesë për diskutim mbi një situatë në administratën shtetërore	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor,kodi i etikës,interneti
5.	*Java III*		Pasojat e moszbatimit të ligjit në shoqëri	**Diskutim mbi një situatë aksidenti ku personi përgjegjës largohet**	Metoda integruese	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, sociologjia
6.			**Përsëritje – Kap. I**		Projekte	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	

7.	*Java IV*	Kapitulli II Kushtetuta (5 orë)	Kushtetuta – ligji themeltar i shtetit	Diskutim mbi një situatë ndeshje futbolli ,në të cilën njëra skuadër dëshiron ndryshimin e rregullave të lojës	kurrikulare Bashkëbisedim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor,kushtetuta filozofia, interneti
8.			Kushtetuta dhe organet e shtetit	Diskutim mbi neni 1 dhe 7 të kushtetutës	Konkurse Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta
9.	*Java V*		Parimet kryesore të Kushtetutës	Diskutim mbi të drejtat themelore		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Kushtetuta, teksti mësimor, historia
10			Liria, barazia dhe Kushtetuta	Diskutim mbi të drejtën e ndihmës ekonomike		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Kushtetuta, sociologjia, interneti
11	*Java VI*		**Veprimtari praktike**				Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
12		Kapitulli III Të Drejtat Themelore Të Njeriut (10orë)	Ç'janë të drejtat e njeriut?	Diskutim mbi ekzistencën e të drejtave të njeriut		Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
13	*Java VII*		Kategoritë e të drejtave të njeriut dhe	Diskutim mbi të drejtat në demokraci		Vlerësimi për të nxënë	Teksti mësimor,

			rëndësia e tyre		(i vazhdueshëm)	historia ,kushtetuta e Shqipërisë
14			Të drejtat themelore të njeriut dhe institucionet ndërkombëtare	Diskutim mbi domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	DDNJ, teksti mësimor, historia, interneti
15	*Java VIII*		Kufizimi i të drejtave	Diskutim mbi kufizimin e të drejtave	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor,DDNJ
16			Ndërlidhja e të drejtave dhe të drejta në konflikt	Diskutim mbi konfliktin që mund të burojë nga një grup të drejtash	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, historia, interneti
17	*Java IX*	;	Disa të drejta themelore të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Shqipërisë	Diskutim mbi Kushtetutën Shqiptare	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta
18			**Veprimtari praktike: Të drejta të tjera**		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
19	*Java X*		**Veprimtari praktike**		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
20			**Test I**	Testim për kontrrollin e njohurive të marra.	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
21	*Java*		**Projekt – ora I**	Diskutim rreth ecurisë së	Vlerësimi për	Interneti,hi

	XI			projektit.		të nxënë (i vazhdueshëm)	storia, filozofia sociologjia
22		Kapitulli IV Arsimimi (6 orë)	Arsimimi, si një e drejtë themelore	Diskutim mbi arsimin si e drejtë themelore		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta
23	*Java XII*		Legjislacioni mbi arsimimin	Diskutim mbi ligjet mbi arsimin si garantuese të së drejtës		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta
24			Institucionet shkollore dhe roli i tyre	Diskutim mbi shkollën si institucion		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor,ligji për arsim, kurrikula

Lënda: QYTETARI

Shkalla: 5

Klasa: X

Viti shkollor: 2017-2018

PËR TREMUJORIN E DYTË
(Janar - Mars)

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: • shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; • dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme,duke bërë pyetje, komente,sqarime dhe propozime; • shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; • veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj.,e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi/ja: • parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie; • zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse; • përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror); • shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë; • krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore;

• përdor krahasimin dhe kondërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.
Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja: • përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; • shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; • zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë,veprim,aktivitet ose detyrë që i kërkohet; • ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike; • parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur; • menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Nxënësi/ja: • zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin; • diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre; • bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
Kompetenca personale Nxënësi/ja: • vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.
Kompetenca qytetare Nxënësi/ja: • tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit;

• merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale
Nxënësi/ja:
• përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
• analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
•zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

Nr.	Java	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
25.	*Java XIII*	Kapitulli IV (vazhdim)	Problemet e shkollës sot	Diskutim mbi problemet e shkollës	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kurrikula e arsimit
26.			Reforma arsimore dhe shkolla si qendër multikulturore	Diskutim mbi reformën arsimore	Puna në grup dhe puna individuale; Hetimi dhe zbulimi;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta, ligji për arsim, historia, interneti
27.	*Java XIV*		**Përsëritje**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
28		Kapitulli V	Shëndeti si një e drejtë	Diskutim mbi shëndetin		Vlerësimi për të	Portofoli i

.		Shëndeti (6orë)	themelore.	si e drejtë themelore	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase Metoda integruese Bashkëbisedim Konkurse Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues Prezantime në forma të ndryshme,	nxënë (i vazhdueshëm)	nxënësit, teksti mësimor, kushtetuta
29.	*Java XV*		Legjislacioni mbi shëndetin	Diskutim mbi legjislacionin për shëndetin		Vlerësim diagnostikues	Portofoli i nxënësit, teksti mësimor
30.			Parandalimi dhe informacioni			Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	
31.	*Java XVI*		Disa nga armiqtë kryesorë të shëndetit	Diskutim mbi armiqtë kryesorë të shëndetit		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Bilogjia, teksti mësimor, interneti
32.			Disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin	Diskutim mbi çështjet bashkëkohore të shëndetit		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, biologjia
33.	*Java XVII*		**Veprimtari praktike**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
34.		Kapitulli VI Mjedisi (6 orë)	Ekologjia	Diskutim mbi mjedisin		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, biologjia, gjeografia
35.	*Java XVIII*		Rreziqet për planetin. Roli i shkencës dhe i teknologjisë në ruajtjen e planetit	Diskutim mbi rolin e teknologjisë		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, internet
36.			Zhvillimi i qëndrueshëm	Diskutim mbi zhvillimin e qëndrueshëm		Vlerësimi për të nxënë	Teksti mësimor,

					përfshirë TIK	(i vazhdueshëm)	gjeografia, ekonomia
37.	*Java XIX*		Legjislacioni shqiptar për ruajtjen e mjedisit	Diskutim mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, legjislacioni në mbrojtje të mjedisit
38.			**Veprimtari praktike**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
39.	*Java XX*		**Test II**	Testim për kontrollin e njohurive të marra.		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
40.		Kapitulli VII Konsumatori (8 orë)	Konsumatori – të drejtat dhe detyrimet	Diskutim mbi konsumatorin	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Tekst mësimor ,kushtetutë
41.	*Java XXI*		Faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit	Diskutim mbi faktorët që ndikojnë në sjelljen tonë si konsumator		Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit,tekst i mësimor
42.			Kontrata e shitblerjes dhe elementet e saj	Diskutim mbi elementët e kontratës			Portofoli i nxënësit, teksti mësimor, interneti
43.	*Java XXII*		Garancia	Diskutim mbi garancineë dhe kushtet e saj		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, interneti
44.		përshkruan funksionet e	Reklama dhe konsumatori	Diskutim mbi reklamën dhe efektin që ka tek konsumatori	Metoda interaktive, bashkëvepruese,	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, ekonomia,

		reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj si shkelje e të interesave dhe të drejtave konsumatorit; identifikon organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit.			gjithëpërfshirëse; Puna në grup dhe puna individuale; Hetimi dhe zbulimi; Metoda integruese Bashkëbisedim Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues		sociologjia
45.	*Java XXIII*		**Përsëritje**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
46.			**Veprimtari praktike**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
47.	*Java XXIV*		**Projekt – ora II**	Diskutim rreth ecurisë së projektit.		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
48.		Kapitulli VIII Puna dhe e drejta e punës (6 orë)	Puna dhe legjislacioni i punës (pjesa 1)	Ftesë për diskutim mbi punën			Portofoli i nxënësit, kodi i punës, teksti mësimor, interneti

Lënda: QYTETARI

Fusha : Qytetari

Shkalla: 5

Klasa: X

Viti shkollor: 2017-2018

PËR TREMUJORIN E TRETË
(Prill - Qershor)

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: • shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; • dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme,duke bërë pyetje, komente,sqarime dhe propozime; • shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; • veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj.,e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.
Kompetenca e të menduarit. Nxënësi/ja: • parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie; • zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse; • përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror);

• shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë; • krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore; • përdor krahasimin dhe kondërvënien për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore ndërmjet dy ose më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.
Kompetenca e të nxënit. Nxënësi/ja: • përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; • shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit; • zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim(tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë,veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; • ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike; • parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur; • menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Nxënësi/ja: • zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin; • diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre; • bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.)për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
Kompetenca personale Nxënësi/ja:

• vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.
Kompetenca qytetare Nxënësi/ja: • tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit; • merr pjesë në aktivitetet që nxisin dhe mbështesin tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik,fetar,gjinor etj, në shkollë ose në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.
Kompetenca digjitale Nxënësi/ja: • përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive; • analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash; •zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

Nr.	Java	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
49.	*Java XXV*	Kapitulli VIII Puna dhe e drejta e punës (vazhdim)	Puna dhe legjislacioni i punës (pjesa 2)	Diskutim mbi ndryshimet në legjislacionin e punës	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	Fletore e punëve me shkrim,portofoli i nxënësit	Teksti mësimor
50.			Kontrata e punës dhe elementet e saj	Diskutim mbi kontratën e punës		Vlerësimi i të nxënit	Fletore të punëve me

						(përmbledhës)	shkrim, Portofoli i nxënësit
51.	*Java XXVI*		Kushtet e punës	Diskutim mbi kushtet e punës		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta
52.			Sigurimet shoqërore	Diskutim mbi rëndësinë e sigurimeve shoqërore	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Tekst mësimor
53.	*Java XXVII*		**Test III**	Testim për kontrollin e njohurive të marra.		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
54.		Kapitulli IX Kodi Rrugor (8 orë)	Kodi rrugor dhe funksionet e tij	Diskutim mbi kodin rrugor	Hetimi dhe zbulimi;	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kushtetuta, kodi rrugor
55.	*Java XXVII I*		Sinjalet rrugore dhe kuptimi i tyre	Diskutim mbi sinjalet e domosdoshme			Teksti, mësimor
56.			Sinjalet rrugore dhe këmbësorët	Diskutim mbi respektimin e sinjaleve jugore		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kodi rrugor
57.	*Java XXIX*		Sinjalet rrugore për biçikletat dhe motoçikletat	Diskutim mbi sinjalet rrugore	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, kodi rrugor, interneti
58.			**Veprimtari praktike: Pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
59	*Java*		**Veprimtari praktike**			Vlerësimi për të	interneti

.	*XXX*					nxënë (i vazhdueshëm)	
60.			**Projekt – ora III**	Diskutim rreth ecurisë së projektit.		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
61.	*Java XXXI*		**Projekt – ora IV**	Dhënia e rezultateve rreth ecurisë së projektit.		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Portofoli i nxënësit,teksti mësimor
62.		Kapitulli X E drejta për informim dhe ligji për median (6 orë)	Informimi dhe rëndësia e tij	Diskutim mbi rëndësinë e informimit	Metoda integruese	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit, teksti mësimor
63.	*Java XXXII*		Mjetet tradicionale dhe të reja të informimit	Diskutim mbi ndikimin e teknologjisë tek informacioni		Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit, teksti mësimor, historia
64.			Legjislacioni shqiptar për median e shkruar dhe elektronike	Diskutim mbi median e shkruar	Bashkëbisedim	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit, teksti mësimor
65.	*Java*		Disa probleme bashkëkohore të informimit	Diskutim mbi problemet e informimit		Vlerësimi i të nxënit	Portofoli i nxënësit,

	XXXII I					(përmbledhës)	teksti mësimor, interneti
66.			**Veprimtari praktike**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
67.	*Java XXX IV*		**Përsëritje**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
68.		Kapitulli XI Bashkëjetesa në komunitet (Bashkëpronësia) (3 orë)	Bashkëpronësia dhe bashkëpronarët	Diskutim mbi kuptimin e bashkëpronësisë		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Tekst mësimor, kushtetutë
69.	*Java XXXV*		Komuniteti dhe detyrimet e tij	Diskuti m mbi jetën në komunit et		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor, historia
70.			Komuniteti dhe problemet e tij sot	Diskutim mbi problemet e komunitetit		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor historia
71.			**Përsëritje**			Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
72.	*Java XXXV*		**Test - IV**	Testim për kontrollin e njohurive të marra.		Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Ligji dhe funksionet e tij		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim, marrëdhënie pyetje –përgjigje. Nxënësit japin përgjigje rreth çështjes që shtrohet për diskutim duke përdorur njohuritë që mund të kenë mbi ligjin dhe domosdoshmërinë e tij në shoqëri	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - përshkruan rolin e ligjeve në shoqëri, mënyrën si ndryshojnë dhe ruhen marrëdhëniet shoqërore. - shpjegon rolin e institucioneve në një shoqëri, - krahason forma të caktuara institucionesh brenda një shoqërie.		**Fjalët kyçe:** *ligje të shkruara, ligje të pashkruara, e drejtë zakonore, abrogim, anarki, filozofë liberalë*	
Burimet: Njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, filozofia, historia		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Komunikimi dhe bashkëveprimi, Historia, Filozofia	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutim i njohurive paraprake

Imagjinoni një shoqëri pa ligje. Si do të ishte jeta brenda saj?

Ku do të ndjeheni më të lumtur e më të sigurt, në një shoqëri me rregulla dhe ligje apo në një shoqëri pa ligje dhe norma?

Nxënësit/et do t'i japin përgjigjet e tyre, duke i listuar ato në tabelë dhe në të njëjtën kohë do të vihet në dukje roli i normave dhe ligjeve në një shoqëri.

Hapi i dytë: Vëzhgo-Analizo-Diskuto

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Ligji nënkupton një parim të shkruar ose një rregull të mirëpërcaktuar, i cili duhet zbatuar nga të gjithë anëtarë t e një shoqërie. Ai është një mekanizëm vetërregullues i jetës në gjirin e një shoqërie të caktuar".

Ligjet ndahen në 1- të shkruara

2- të pashkruara.

Mësuesi thekson se format e pashkruara përbëjnë traditat dhe zakonet e një shoqërie që do të emërtoheshin "**e drejtë zakonore**".

Që një normë të kthehet në ligj, ajo duhet të plotësojë tri kushte:

1- Të jetë e përsëritur në kohë e të ketë marrë pëlqimin e plotë të anëtarëve të shoqërisë.

2- Të jetë miratuar nga organet kompetente të kohës.

3- Të përmbajë sanksione të niveleve të ndryshme, të zbatueshme nga organet kompetente.

Mësuesi thekson që ligjet, duke pasur mekanizma të ndryshëm vetërregullues, shoqëri të

ndryshme hartojnë dhe zbatojnë ligje të ndryshme në kohë dhe në hapësirë. Pra ligji ndryshon në kohë dhe në hapësirë .
Mësuesi/ja nxit nxënësit të mendojnë për ligjet që domosdoshmërish kanë ndryshuar në shoqëri, duke marrë shembull ligjet mbi skllavërinë, duke theksuar në të njëjtën kohë konceptin e "**abrogimit"**
Mësuesi/ja paraqet figurat kryesore të filozofëve liberalë si: Monteskje, Russo, Kant, duke theksuar dhe qëllimin e tyre për: "hartimin e ligjeve të drejta e të pranuara nga të gjithë anëtarët e shoqërisë".
Hapi i tretë: Diskutim i ideve
Duke u bazuar në konceptin e ligjit dhe në fjalët kyçe, nxënësit argumentojnë rëndësinë e ekzistencës së ligjeve në një shoqëri dhe analizojnë evoluimin e ligjeve në kohë e hapësirë duke u bazuar në principet e filozofëve liberalë.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia dhe ndërtimin e njohurive të reja, argumentimi dhe prezantimi i argumenteve në bazë të njohurive të përftuara etj.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi ligjin, qëllimin, si edhe funksionet dhe natyrën e tij në shoqëri

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi ligjet, domosdoshmërinë e tyre, historikun dhe evoluimin e tyre, si edhe rëndësinë e filozofëve liberalë në zhvillimin e shoqërisë dhe ligjeve brenda saj.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:
a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në dy grupe studiuesish imagjinarë: Njëri grup përfaqëson historianë t para 1990 dhe grupi i dytë pas 1990.
Diskutoni mbi ligjet e të dyja periudhave. Cilat janë të pakonceptueshme sot?

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Rëndësia e ligjit në shoqëri		**Situata e të nxënit:** Mësuesja nxit diskutimin dhe bashkëbisedimin mbi rëndësinë e ligjit në shoqëri. Nxënësit japin përgjigje rreth çështjes që shtrohet për diskutim duke përdorur njohuritë mbi	

	ligjin dhe duke sjellë situata reale nga jeta e përditshme.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - identifikon pasojat e veprimit dhe mosveprimit të ligjit në shoqëri. - vlerëson pasojat e veprimit dhe mosveprimit të ligjit në shoqëri, - argumenton me shembuj nga jeta e përditshme mbi domosdoshmërinë e ligjeve për shoqërinë.	**Fjalët kyçe:** *shtet ligjor, shtet i së drejtës, diktaturë, shtet demokratik, detyra, qytetar, akt prapaveprues i një ligji, përgjegjësi penale, përgjegjësi civile, përgjegjësi administrative.*
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia dhe Sociologjia

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

Diskutohet situata e dhënë në libër. Qytetari A përmes njohjeve apo pushtetit që gëzon përfiton padrejtësisht pronën e qytetarit B.

Cilat mund të jenë pasojat e këtij vendimi në jetën e qytetarit B dhe qytetarëve të tjerë si ai në qytet?

Nxënësit/et do t'i japin përgjigjet e tyre, duke cituar rëndësinë jo vetë të ekzistencës së ligjeve(nga tema e mëparshme) por edhe rëndësinë e zbatimit të ligjeve në një shoqëri.

Hapi i dytë: Vëzhgo-Analizo-Diskuto

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Shteti i së drejtës nënkupton parimin e barazisë para ligjit. Shteti i së drejtës është shumë më i rëndësishëm se shteti ligjor"

Në këtë moment theksohet se çfarë përfshin shteti ligjor. Shteti ligjor përfshin:1- sistemet demokratike;

2-sistemet totalitare.

Shteti i së drejtës përfshin vetëm sisteme demokratike të cilat respektojnë si liritë dhe të drejtat individuale dhe ato kolektive

Rasti i situatës së mësipërme ku më i forti sundon është produkt i regjimeve totalitare.

Në shtetet demokratike të gjithë individët jane **Qytetarë** të atij shteti. Funksionet e demokracisë liberale janë: 1- Mbrojtës 3-Parandalues

2- Rregullues 4-Përmirësues

Mësuesi thekson rëndësinë si te veprimeve dhe të mosveprimeve në përputhje me ligjet. Në këtë aspekt citohen qartë koneptet: Përgjegjësi penale, përgjegjësi civile dhe përgjegjësi

administrative.
Me rëndësi është dhe sqarimi i mungesës së "**efektit prapaveprues**" të ligjit dhe të ndalimit të **vetëgjygjësisë** dhe në rastet kur drejtësia nuk zbatohet. Në këtë situatë theksohet rëndësia e informimit të qytetarit
Klasa ndahet në dy grupe.
Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit zgjedhin një situate konflikti ndërmjet dy shtetasve dhe ndahen në dy grupe. Ata improvizojnë një proces gjyqësor dhe secili grup sillet si gjyqtarë që favorizojnë secilën palë.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia dhe ndërtimin e njohurive të reja, prezantimi i argumenteve dhe demonstrimi konkret i tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e zbatimit të ligjit, pasojat e veprimit dhe të mosveprimit të ligjit në shoqëri

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e zbatimit të ligjit, shtetit të së drejtës në dallim nga shteti ligjor. Të ketë koncepte të sakta mbi regjimet totalitare , regjimet demokratike, pasojat e veprimeve apo mosveprimeve si dhe përgjegjësitë penale, civile dhe administrative në lidhje me këto të fundit.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në dy grupe dhe në formën e një debati , do të diskutojnë mbi thënien e filozofit anglez Xhon Stjuart Mill. "Një njeri mund t'u shkaktojë dëm të tjerëve jo vetëm me veprimet por edhe me mosveprimet e tij, dhe në të dyja rastet ai është përgjegjës për dëmin ndaj tyre"

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Ligji dhe vlerat		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të diskutojnë mbi veprimet që ata do të ndërmerrnin nëse do të ishin organizatorët e një darke ambasadorësh nga vende të ndryshme. Nxënësit japin	

	përgjigje rreth çështjes që shtrohet për diskutim. E rëndësishme është që në diskutim të pasqyrohet rëndësia e vlerësimit objektiv të kulturave të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - identifikon vlerat të cilat qëndrojnë në themel të ligjeve. - diskuton mbi vlerat të cilat qëndrojnë në themel të ligjeve të një shoqërie - argumenton rëndësinë e tyre në ligjet ekzistente të një shoqërie dhe në ato që do te hartohen në të ardhmen.	**Fjalët kyçe:** *Kulturë, kulturë politike, burime të së drejtës, vlera morale, vlera politike, vlera sociale, vlera ekonomike, vlera kombëtare, vlera ndërkombëtare.*
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia, ekonomia	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Sociologjia dhe Ekonomia

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutim i ideve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për kulturën, elementët e saj dhe duke listuar tiparet dalluese kryesore të kulturës së secilit vend.

Në këtë rast mësuesja ndihmon me konceptin e kulturës nga sociologjia.

Cilat janë rrethanat specifike që duhet të mbajmë parasysh në organizimin e këtij eventi?

Nxënësit/et do t'i japin përgjigjet e tyre, duke cituar rëndësinë jo vetëm rëndësinë e njohjes dhe respektimit të kulturave të ndryshme por edhe rëndësinë e vlerave të cilat qëndrojnë në themel të hartimit, miratimit dhe zbatimit të ligjeve aq të domosdoshme për shoqërinë njerëzore.

Hapi i dytë: Përvijimi i mendimit

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Kultura e një vendi është shumë e rëndësishme si për ligjet që ka ky vend, dhe për ligjet që ai do të hartojë në të ardhmen" Kultura lidhet me zakonet traditat dhe vlerat e një vendi dhe në bazë të këtyre formohet ajo që quhet **Kultura politike**.

Kultura politike ka të bëjë me institucionet dhe sistemet politike të një shteti, të cilat do ta karakterizojnë vendin në fjalë gjatë gjithë historisë së tij. Kultura e një shoqërie shërben si

kornizë për hartimin e ligjeve të reja, pra është një nga burimet e së drejtës
Në këtë moment sillen shembuj nga shtete të ndryshme dhe regjime të ndryshme politike .Këtu mund të përdoret video projektori .
Pas përcaktimit të rëndësisë së kulturës dhe kulturës politike mësuesja thekson dhe rëndësinë e etikës ose e quajtur ndryshe filozofia e moralit
Etika përmban vlerat, normat, traditat dhe vjen në ndihmë kur mungojnë ligjet specifikë nga institucionet përkatëse
E rëndësishme është dhe ndarja e vlerave ne:1-kombëtare
2-ndërkombëtare
Nën prizmin e kësaj ndarje, mësuesja shpjegon rëndësinë e vlerave politike, ekonomike, sociale dhe administrative.
Ndarja e vlerave dhe rëndësia e tyre ilustrohet me shembuj konkretë nga vendi dhe bota
Rasti i situatës së mësipërme ku më i forti sundon është produkt i regjimeve totalitare.

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup prezanton mënyrat e organizimit të mbrëmjes me ambasadorët e vendeve te ndryshme.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia dhe ndërtimin e njohurive të reja, prezantimi i argumenteve dhe demonstrimi konkret i tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e kulturës dhe kulturës politike si dhe rëndësinë e vlerave politike, ekonomike, sociale në ligjet aktuale të shteteve si dhe në ligjet që këto shtete do të mund të hartojnë në të ardhmen.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e kulturës, kulturës politike, vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare gjithashtu dhe në rëndësinë e vlerave politike, sociale, ekonomike dhe administrative në ligjet ekzistuese të një shteti dhe në ato ligje të cilat ky shtet do te hartoje në të ardhmen.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në grupe dhe në formën e një debati, do të diskutojnë dhe do të listojnë zgjidhjet për situatën e dhënë në fillim te mësimit.
Nxënësit do të kërkojnë informacione mbi vlerat ekonomike, ekonominë e tregut. Në libër jepet e qartë adresa e emailit ku mund të marrin informacionin dhe të formulojnë një mendim vetjak mbi këtë ndryshim radikal të shoqërisë shqiptare

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore:Llojet e ligjeve		**Situata e të nxënit:** Mësuesja nxit diskutimin dhe bashkëbisedimin mbi rëndësinë e llojeve të ligjeve në shoqëri. Nxënësit japin përgjigje rreth çështjes që shtrohet për diskutim duke përdorur njohuritë mbi ligjin, mbi të drejtat civile dhe duke sjellë situata reale nga jeta e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - shpjegon domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjeve në shoqëri. - demonstron aftësinë të vlerësojë vlerat në qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara. - argumenton me shembuj nga jeta e përditshme mbi domosdoshmërinë e llojeve te ndryshme të ligjeve në shoqëri.		**Fjalët kyçe:** *kod, kod penal, kod civil, kod administrativ, ligj i zakonshëm, ligj i përforcuar, ligj organik ligj kornizë.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia .	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutim i ideve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Një nëpunës i administratës shtetërore pushohet padrejtësisht nga drejtori i tij, i cili në këtë rast ka shkelur të gjitha procedurat të parashikuara nga ligji.

Kujt do ti drejtohet punonjësi në këtë rast? Nëse nuk ka të ardhura të mjaftueshme për një avokat, a ka të drejtë të marrë një avokat të paguar nga shteti?

Nxënësit/et do t'i japin përgjigjet e tyre, duke cituar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjeve në një shoqëri.

Hapi i dytë: Përvijimi i mendimit

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Ligjet në një shoqëri rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve, ndërmjet njerëzve dhe ndërmjet njerëzve dhe institucioneve."

Gjithashtu mësuesja thekson dhe konceptin e Kod-it si grupim ligjesh dhe rregullash juridike të cilat rregullojnë marrëdhëniet në një sferë të caktuar shoqërore .

Kodet ndahen në: Civil; Penal; Administrativ.
Në Shqipëri dhe në vende të tjera të gjitha llojet e ligjeve janë të varura nga kushtetuta dhe ligjet kushtetuese që e përbëjnë atë.
Mësuesja thekson se ligjet mund të grupohen dhe nga rëndësia dhe ndërvarësia e tyre. Kjo quhet **Hierarki**
Hierarkia ligjore vijon:1- Kushtetuta dhe ligjet kushtetuese
2- Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara
3- Ligjet organike (brenda të cilave sqarohet koncepti ligj i përforcuar dhe ligj i zakonshëm)
4-Ligjet kornizë
Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në grupe dhe shkëmbejnë ide pse është e rëndësishme njohja e ligjeve dhe përditësimi me ligjet e reja dhe pas diskutimit dalin në secilin grup me përfundimet përkatëse.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia dhe ndërtimin e njohurive të reja, prezantimi i argumenteve dhe demonstrimi konkret i tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë dhe argumentojnë rëndësinë e llojeve të ndryshme të ligjeve dhe hierarkinë ligjore sipas ndërvarësisë së ligjeve ndërmjet njëri tjetrit.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e ekzistencës së llojeve të ndryshme të ligjeve dhe radhitjes së argumentuar të hierarkisë ligjore.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në grupe ku do të shkëmbejnë idetë mbi rëndësinë e njohjes së ligjeve dhe përditësimin me ligje të reja. Në fund ata do te japin konkluzionet përfundimtare sipas argumenteve të përdorura prej tyre.
2-Nxënësve u ofrohet një adresë interneti në të cilën ata do të mund të gjejnë ligjet e përditësuara dhe sërish të ndarë në grupe do të zgjedhin një ligj të caktuar dhe do të diskutojnë rreth tij.

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Pasojat e moszbatimit të ligjit në shoqëri		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim, marrëdhënie pyetje –përgjigje. Nxënësit japin përgjigje rreth çështjes që shtrohet për diskutim duke përdorur njohuritë që kanë mbi ligjin, llojet e tij, domosdoshmërinë e tij dhe pasojat e moszbatimit të tij në shoqëri.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - identifikon raste të ndryshme të shkeljeve ligjore dhe diskuton për pasojat që këto shkelje kane për veten, familjen dhe mjedisin ku jeton. - evidenton faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit. - analizon faktorët që ndikojnë në qëndrimet e tij ndaj ligjit.		**Fjalët kyçe:** *detyra të qytetarit, detyra të qeverisë, shtet, barazi formale, barazi reale, ndarje pushtetesh, besim në institucione.*	
Burimet: Njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, filozofia, historia		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Komunikimi dhe bashkëveprimi, Historia, Filozofia	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutim i njohurive paraprake

Studiojmë situatën e aksidentit në tekst. Çfarë e shtyu shoferin të largohej nga vendi i ngjarjes? çfarë pasojash mund të sjelle moszbatimi i ligjit?

Nxënësit/et do t'i japin përgjigjet e tyre, duke i listuar ato në tabelë dhe në të njëjtën kohë do të vihet në dukje se zbatimi i ligjit është thelbësor për funksionimin e shtetit. Nxënësit nxiten të përmendin disa detyra të qytetarëve dhe të qeverisë të cilat lidhen me aspektin ekonomik të jetës.

Hapi i dytë: Diskutim i ideve.

Nxënësit nxiten të përmendin disa detyra të qytetarëve dhe të qeverisë të cilat lidhen me aspektin ekonomik, social dhe politik të jetës.

Pas diskutimeve të nxënësve mbi skemat e paraqitura në libër, mësuesi thekson: "Që shteti demokratik të funksionoj , qytetarët duhet të kuptojnë rëndësinë e zbatimit të ligjit në shoqëri, por e rëndësishme gjithashtu është që dhe qeveria të zbatojë detyrat e saj kundrejt shtetit dhe qytetarëve."

Faktorët që ndikojnë në cilësinë e zbatimit të ligjit i ndajmë në :1- individual

2- institucional

Mësuesi thekson se faktorët individualë konsistojnë në :mungesën e edukimit, nën ndikimin e kulturës ku individi bën pjesë, të moskuptuarit e përparësive që sjell zbatimi i ligjit, por

veçanërisht mungesa e besimit tek institucionet është një faktor shumë i fortë individual.
Faktorët institucionalë konsistojnë në :a-barazi formale (kur ligjet ekzistojnë dhe parashikojë barazi)
b-barazi reale (kur ligjet funksionojnë dhe zbatohen)
Për të pasur kohezion ndërmjet dy barazive parimet që duhet të garantojë shteti ligjor janë:
1-Informimi në lidhje me hartimin e ligjeve
2-Ndarja e pushteteve
3- Të gjitha aktet nënligjore duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën
Mësuesi thekson që nëse këto tri parime do të respektohen, atëherë qytetarët do të kenë besim në institucionet e tyre.
Hapi i tretë: Diskutim i ideve
Duke u bazuar në rëndësinë e zbatimit të ligjeve, në detyrimet e qytetarëve dhe qeverisë përkundrejt zbatimit të ligjit, nxënësit argumentojnë rëndësinë e zbatimit të ligjeve në një shoqëri dhe analizojnë faktorët individualë dhe institucionalë.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia dhe filozofia në ndërtimin e njohurive të reja, argumentimi dhe prezantimi i argumenteve në bazë të njohurive të përftuara etj.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e zbatimit të ligjit në shoqëri si dhe rëndësinë e njohjes së faktorëve të cilat ndikojnë në cilësinë e zbatimit të ligjit.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi ligjet, domosdoshmërinë e zbatimit të tyre, rëndësinë e faktorëve të cilët ndikojnë në zbatimin e ligjeve.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Ata i përgjigjen pyetjeve në libër dhe japin konkluzionet mbi çështjet që ngrihen tek rubrika e mendimit kritik.
Detyrë:Identifikoni raste të shkeljeve të ndryshme ligjore dhe diskutoni për pasojat e tyre.

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Përsëritje Kapitulli I		**Situata e të nxënit:** Mësuesja nxit nxënësit të punojnë ushtrimet e përsëritjes dhe gjithashtu nxit diskutimin dhe bashkëbisedimin mbi rëndësinë e ligjit në shoqëri.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - identifikon konceptet kryesore të kapitullit. - vlerëson rëndësinë e ligjeve, kulturës , vlerave etj si edhe pasojat e veprimit dhe mosveprimit të ligjit në shoqëri, - argumenton me shembuj nga jeta e përditshme mbi domosdoshmërinë e ligjeve për shoqërinë.		**Fjalët kyçe:**	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia filozofia, ekonomia.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Sociologjia, Filozofia dhe ekonomia	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**:diskutimi mbi konceptet kryesore të kapitullit Mësuesja nxit nxenësit të diskutojnë mbi konceptet kryesore **Hapi i dytë**: Vëzhgo-Analizo-Diskuto Pas diskutimeve të nxënësve, punohen ushtrimet e librit. **Hapi i tretë**: Punë në grup. Praktikë e pavarur Nxënësit zgjedhin një situate konflikti ndërmjet dy shtetasve dhe ndahen në dy grupe. **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: përsëritjes dhe lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia dhe ndërtimin e njohurive të reja, prezantimi i argumenteve dhe demonstrimi konkret i tyre në bazë të njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e ligjeve në shoqëri.			

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e ligjeve, zbatimit të tyre, rëndësinë e kulturës, kulturës politike traditave etj. Të ketë koncepte të sakta mbi regjimet totalitare, regjimet demokratike, pasojat e veprimeve apo mosveprimeve, përgjegjësitë penale, civile dhe administrative, faktorët individualë dhe institucionalë që ndikonin në zbatimin e ligjit etj. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi c- vlerësim me anë të portofolit
Detyra:

Test për Tematikën 1: Ligji dhe Shoqëria

1) Ligji është:
a-një rregull i përcaktuar shumë qartë
b-një mekanizëm vetërregullues në shoqëri
c-i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë qytetarët
d-të gjitha më sipër
2) Cilat janë 3(tri) kushtet kryesore që një normë /vlerë/rregull të kthehet në ligj

3) Ideja e kontratës sociale u dha nga:
a-Kant
b-Rousseau
c-Locke
d-Montesque
4) Vlerat që një shoqëri duhet domosdoshmërisht të ruajë janë:

5) Kodet janë:
a-grumbull ligjesh që rregullojnë marrëdhëniet juridike në një fushë të caktuar
b-vlera pozitive që meritojnë të ruhen
c-rregulla të përcaktuara shumë qartë
d-marrëdhënie që ekzistojnë ndërmjet qeverisë dhe anëtarëve të shoqërisë

6) Listoni parimet që një shtet demokrati duhet të garantojë disa parime për të siguruar barazinë formale dhe reale të qytetarëve të tij

Dt.___/____/__

Fusha: Kushtetuta e Shqipërisë	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Kushtetuta ligji themeltar i shtetit.		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë në libër dhe të argumentojnë pse rregullat e lojës nuk mund të ndryshojnë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - përshkruan rolin e Kushtetutës si ligji themeltar i shtetit. - diskuton mbi kushtetutën si burim të legjislacionit. - argumenton rëndësinë e kushtetutës dhe formës së shtetit.		**Fjalët kyçe:** *Kushtetutë, formë shteti, kontratë sociale, sistem politik, organizim shtetëror, republikë parlamentare, republikë presidenciale, republikë gjysmëpresidenciale, burim ligjor.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, libri i Kushtetutës		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia dhe libri i Kushtetutës	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutim i ideve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për kushtetutën, rëndësinë e saj nga kapitulli i mëparshëm, duke nxjerrë në pah që është pikërisht kushtetuta që përcakton rregullat e lojës.

Në këtë rast mësuesja ndihmon me konceptin e kushtetutës si: Përmbledhja themelore e ligjeve të një shteti të cilat garantojnë formën e këtij shteti dhe të drejtat e liritë themelore të qytetarëve që banojnë në territoret e tij.

Nxënësit rikujtojnë dhe konceptin e kontratës sociale si marrëveshje ndërmjet qeverisësve dhe të qytetarëve e cila përmban të drejtat dhe detyrat që duhen respektuar nga të dy palët.

Hapi i dytë: Përvijimi i mendimit

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi rithekson: "Kushtetuta ligji themeltar i shtetit dhe garantuese e formës së qeverisjes".

Kushtetuta përcakton:

1-Formën e shtetit

2-Sistemin politik (republike parlamentare, presidenciale dhe gjysmëpresidenciale)
3-Të drejtat themelore të individëve
4-Format organizimit të qeverisjes
5-Sistemin gjyqësor, llojet e gjykatave, hierarkinë e tyre
6-Detyrat e shtetit ndaj qytetarëve të tij.
Kushtetuta shërbejnë si burim ligjor kryesor për të furnizuar jetën politike dhe sociale të një shteti.

Në këtë rast mund të sillen shembuj të ligjeve të ndryshme dhe shihet që këto ligje janë në përputhje me kushtetutën. Rikujtojmë hierarkinë ligjore ku kushtetuta dhe ligjet kushtetuese janë kryesoret apo kulmi i hierarkisë.
Gjithashtu detyrë e mësueses është të theksohet që: Sa më e shkurtër të jetë një kushtetutë aq më shumë mundësi me ndryshimet e ligjeve në kohë.
Merren shembuj nga kushtetuta e ShBA-së e cila ka ndryshuar shume pak në të gjithë historikun e zhvillimit të saj
Sqarohet koncepti -Amendament
Kushtetuta e Shqipërisë është miratuar me referendum në 1998 dhe Shqipëria është përcaktuar Republikë parlamentare (por kjo nuk është kushtetuta e parë shqiptare)
Sqarohet koncepti - Referendum

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup argumenton dhe prezanton idetë përse kushtetuta është e rëndësishme për qeveritarët e një shteti dhe për qytetarët e tij.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, libri i kushtetutës, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit dhe rëndësinë që ajo ka në jetën politike sociale të tij si përcaktuese e sistemit të qeverisjes, si mbrojtëse dhe garantuese e të drejtave dhe lirive themelorë.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e kushtetutës si ligji më i lartë i vendit, si themeli i shtetit dhe mjeti kryesor qeverisës.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë: Nxënësit do të ndahen në grupe dhe do të diskutojnë dhe do të listojnë arsyet pse Kushtetuta është e rëndësishme për qeverinë dhe për qytetarët e një vendi. -Nxënësit do të kërkojnë informacione mbi kushtetutën e parë shqiptare dhe kushtetutën e miratuar ne 1998 me anë të referendumit, në ëeb-in e paraqitur në libër. -Nxënësve iu janë dhënë adresa të tjera online në të cilat ata mund të shohin kushtetuta të vendeve te ndryshme si Italia, Gjermania, ShBA dhe të bëjnë krahasimin ndërmjet tyre.

Dt.___/____/__

Fusha: Kushtetuta e Shqipërisë	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Kushtetuta dhe organet e shtetit.		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të lexojnë parimet themelore të Kushtetutës së Shqipërisë dhe veçanërisht të përqendrohen në nenet 1 dhe 7. Çfarë kuptojnë nxënësit me këto dy nene, dhe sa të rëndësishme janë ato për jetën politike të vendit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - përshkruan strukturën e organeve të shtetit dhe kompetencat e tyre. - diskuton mbi tiparet specifike te sistemeve të qeverisjes. - argumenton rëndësinë e ndarjes dhe balancimin e pushteteve.		**Fjalët kyçe:***Republikë parlamentare, monarki parlamentare, republikë presidenciale, republikë gjysmëpresidenciale, pushtet ligjvënës, pushtet ekzekutiv, pushtet gjyqësor.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, libri i Kushtetutës		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia dhe libri i Kushtetutës	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për kushtetutën, rëndësinë e saj nga kapitulli i ligjit dhe mësimi mëparshëm, duke nxjerrë në pah që është pikërisht kushtetuta që përcakton sistemet e qeverisjes. Mësuesja thekson se çdo Kushtetutë nis me përcaktimin e formës së qeverisjes politike të vendit. **Hapi i dytë**: Vëzhgo-analizo-diskuto Nxënësit, rikujtojnë: "Kushtetuta ligji themeltar i shtetit dhe garantuese e formës së qeverisjes". Kushtetuta përcakton: 1-Formën e shtetit 2-Sistemin politik (republike parlamentare, presidenciale dhe gjysmëpresidenciale) 3-Të drejtat themelore të individëve 4-Format organizimit të qeverisjes 5-Sistemin gjyqësor, llojet e gjykatave, hierarkinë e tyre 6-Detyrat e shtetit ndaj qytetarëve të tij. Mësuesja i fokuson nxënësit tek format e sistemit politik dhe shpjegon veçoritë e secilit sistem. Për ti bërë më të qarta sistemet politike merren shembuj konkretë si Italia, Spanja, Franca, Anglia, SHBA etj. Nga mësimi i mëparshëm rikujtojmë ndarjen e pushteteve si : 1-Legjislativ 2-Gjyqësor 3-Ekzekutiv Mësuesja shpjegon tiparet e secilit pushtet dhe thekson që: "Kushtetuta duhet të plotësojë disa kushte që të sigurojë funksionim sa më të mirë politik" Këto kushte janë: a-Pavarësia e tre pushteteve b-Ekuilibrimi i tre pushteteve c-Kontrolli që këto tri pushtete ushtrojnë mbi njëri tjetrin plotësimi i kushteve të mësipërme garanton demokracinë e një vendi **Hapi i tretë**: Punë në grup. Praktikë e pavarur Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili grup argumenton format e ndryshme të qeverisjes. Secili grup prezanton dhe argumenton ndryshimet ndërmjet Republikës Parlamentare, Republikës Presidenciale dhe gysmëpresidenciale. **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, libri i kushtetutës, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të

njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit dhe rëndësinë e ndarjes së pushteteve, rëndësinë e njohjes së saktë të formave të qeverisjes, rëndësinë qe ka funksionimi sa më i drejtë i demokracisë në një shoqëri.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi sistemin politik të Shqipërisë, mbi rëndësinë e ndarjes së pushteteve, mbi format e ndryshme të sistemeve të qeverisjes. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi c- vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër dhe rubrikën e mendimit kritik. Detyrë: Nxënësit do të ndahen në tre grupe që do të përfaqësojnë tre pushtetet. Ata do të diskutojnë mbi një ligj të ri në kuvendin shqiptar i cili do të ndryshoje nr e deputetëve nga 140 në 160. Secili grup do të argumentojë qëndrimin pro dhe kundër. A prek ky ligj ndonjë nen të Kushtetutës? Çfarë rruge mendoni se duhet ndjekur për të bërë ndryshimin?

Dt.___/____/__

Fusha: Kushtetuta e Shqipërisë	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Parimet kryesore të kushtetutës.		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të lexojnë parimet themelore të Kushtetutës së Shqipërisë dhe veçanërisht të përqendrohen në nenet 1 dhe 7. Çfarë kuptojnë nxënësit me këto dy nene, dhe sa të rëndësishme janë ato për jetën politike të vendit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - përshkruan parimet kryesore të mishëruara në kushtetutën shqiptare.		**Fjalët kyçe:** *Parime Kushtetuese, qëndrueshmëri të Kushtetutës, liri dhe të drejta themelore, barazi para ligjit.*	

- diskuton mbi parimet kryesore të kushtetutës. - argumenton në rëndësinë e mbështetjes në parimet e Kushtetutës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, libri i Kushtetutës	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon fjalorin e duhur përsa i përket temave dhe koncepteve të reja. Fryma e debatit e bën atë më aktiv me shprehi argumentuese dhe në dhënien e konkluzioneve apo vlerësimin e situatave specifike. Këtu nuk ndikojnë vetëm njohuritë e marra në tekst por edhe koncepte të marra nga lëndë si Historia, Filozofia dhe libri i Kushtetutës

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutim i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nëse një qytetari shqiptar i mohohet e drejta për të themeluar një parti politike me ane të një vendimi gjyqësor, cili parim i Kushtetutës shkelet në këtë rast?

A mund të ketë lidhje shkelja e këtij parimi me llojin e partisë që ky qytetar do të themelojë?

Nxënësit i përgjigjen pyetjeve si:Cilat janë funksionet e Kushtetutës? Çfarë përmban Kushtetuta?

Hapi i dytë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Nxënësit, rikujtojnë: "Kushtetuta ligji themeltar i shtetit dhe garantuese e formës së qeverisjes"dhe këtij koncepti i shtohet dhe "Mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve.

Kushtetuta përcakton parimet themelore të qeverisjes në bazë të të cilave zhvillohet një shoqëri demokratike. Ajo është ligji më i lartë i shtetit dhe çdo ligj që nuk është në përputhje me kushtetutën është një ligj i pavlefshëm.

Parimet e Kushtetutës janë:

1-Sovraniteti i popullit shqiptar

2-Paqja dhe interesi kombëtar

3-Dinjiteti i njeriut dhe liritë themelore të tij

4-Barazia para ligjit

5-Pluralizmi

6-Ndarja dhe ekuilibrimi i pushteteve

7-Bashkëjetesa fetare

Mësuesja i fokuson nxënësit tek tri veçori të rëndësishme të Kushtetutës si:

1-Pozicioni i Kushtetutës si ligji më i lartë i shtetit
2-Epërsia e saj ndaj ligjeve dhe akteve të tjera
3- Qëndrueshmëria e Kushtetutës
Mësuesja shpjegon se veçoria e tretë e Kushtetutës; qëndrueshmëria, është njësoj kryesore si dy të tjerat, pasi thekson që kushtetuta qëndron më lartë se çdo parti politike.
Mësuesja citon:Kushtetuta ka një kapitull të posaçëm për garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit. Të gjithë janë të barabartë para ligjit.
Vetëm duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kushtetuta arrin të mbrojë shtetasit nga abuzimi i ndërsjellë dhe institucional. Parimi i barazisë e përforcon akoma më shumë garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit.

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit do të ndahen në shtatë grupe dhe secili prej tyre do të analizojë parimet e kushtetutës dhe do të argumentojnë lidhjen dhe domosdoshmërinë që kanë këto parime për funksionimin e shtetit ligjor dhe demokratik.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, libri i kushtetutës, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e parimeve të kushtetutës si ligji themeltar i shtetit dhe rëndësinë e qëndrueshmërisë dhe parimit të barazisë në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi parimet e Kushtetutës, garantimin e të drejtave dhe lirive të individit, epërsinë që ka ajo mbi ligjet dhe aktet nënligjore. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër dhe rubrikën e mendimit kritik.
Detyrë: Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili grup simulon një situatë ku qytetarët janë të lirë të bëjnë diçka, por jo të barabartë gjatë kryerjes së veprimtarive të ndryshme. Situatat do te simulohen në vende të ndryshme si:Shkollë;Administratë publike;Gjykatë.
-Për të shkarkuar Kushtetutën e Shqipërisë, nxënësve iu ofrohet linku në libër dhe gjithashtu të studiojnë leksionin mbi parimet e Kushtetutës

Dt.___/____/__

Fusha: Kushtetuta e Shqipërisë	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Liria, barazia dhe Kushtetuta		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit në diskutim për situatën e dhënë në libër. Nxënësit duhet të japin mendimin e tyre nëse shkelet e drejta për edukim e vajzës në situatë? A duhet ndërhyrja e shtetit? Nga se mund të marrë ndihmesë ekonomike familja e Elirës?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - përshkruan raportin ndërmjet lirisë dhe barazisë. - diskuton mbi ndryshimin ndërmjet barazisë formale dhe reale - argumenton rëndësinë dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të kushtetutës, në përputhje me dinamizmin dhe veçoritë e jetës ekonomike, sociale dhe politike.		**Fjalët kyçe:** *Barazi reale, barazi formale, dinjitet njerëzor, minimum jetik, kushtetutë e ngurtë , kushtetutë elastike..*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia, libri i Kushtetutës		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Sociologjia dhe libri i Kushtetutës	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për të drejtat dhe liritë themelore të individit, garantimin e tyre nga kushtetuta, konceptit të barazisë para ligjit nga kapitulli i mëparshëm, duke nxjerrë në pah që është pikërisht kushtetuta që përcakton rregullat e lojës. **Hapi i dytë**: Vëzhgo –Analizo-Diskuto Kategorizimi i problemit Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi rithekson: “Kushtetuta ligji themeltar dhe garantuese e të			

drejtave dhe lirive themelore të individit."Por liria absolute nuk ekziston dhe të drejtat kanë kufizime të parashikuara prej ligjit.
Mësuesja sqaron konceptin e Barazisë Formale (barazia para ligjit) dhe konceptin e Barazisë Reale (realizimi i barazisë konkrete para ligjit). Koncepti i barazisë reale ka lidhje të ngushtë me parimin e mbrojtjes e dinjitetit njerëzor i garantuar ne nenin 3 të Kushtetutës së Shqipërisë.
Në Kushtetutë është shtuar dhe koncepti i Shtetit Social-si garantues i dinjitetit njerëzor, i barazisë formale krahas asaj reale. Në bazë të këtij parimi duhet tu garantohet qytetarëve minimumi jetik (ndihma e dhënë nga shteti për të jetuar në rast se qytetari nuk mund ta sigurojë vetë)
Mësuesja thekson se minimumi jetik është i ndryshëm në vende të ndryshme.
Kushtetutat i ndajmë në:
1-Elastike (parashikojnë procedura relativisht të thjeshta për modifikimin e dispozitave të tyre)
2-Të ngurta (parashikojnë procedura të ngurta për modifikime)
Të dyja format e Kushtetutës kanë dispozita që i klasifikojnë të pa modifikueshme dhe të paprekshme , si psh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sjellim shembuj të kushtetutave të vendeve te Europës dhe kushtetutën shqiptare.
Hapi i tretë: Punë në dyshe. Praktikë e pavarur
Nxënësit nga dy u japin përgjigje me shkrim pyetjeve ne libër. Mësuesja ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon në raste paqartësish. Klasa ndahet në dy grupe. Grupi i parë merr çështjen e parë të rubrikës veprimtari në grup. Grupi i dytë merr çështjen e dytë dhe secili grup argumenton dhe prezanton idetë e tij në lidhje me çështjen përkatëse.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, sociologjia, libri i kushtetutës, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit dhe rëndësinë që ajo ka në jetën politike sociale të tij si garantuese e të drejtave dhe lirive themelore, të barazisë formale dhe reale, si garantuese e pacënueshmërisë dhe paprekshmërisë së tyre. Gjithashtu nxënësit diskutojnë mbi dy tipet e Kushtetutës: Kushtetutë e ngurtë dhe Kushtetutë elastike.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e kushtetutës si ligji më i lartë i vendit, si themeli i shtetit dhe garantuesja e paprekshmërisë dhe pacënueshmërisë së të drejtave dhe lirive themelore të individit
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë: Nxënësit do të ndahen në grupe dhe do të diskutojnë dhe do të listojnë argumentet se cdo të thotë të mos sigurosh jetesën tënde dhe të familjes. Jepni shembuj nga jeta reale. Gjithashtu ata do të prezantojnë zgjidhjet e mundshme në plan individual, në plan pushteti lokal në plan shtetëror

Dt.___/____/__

Fusha: Kushtetuta e Shqipërisë	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr1		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtaritë si vijojnë në libër	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe:**.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, socologjia, libri i Kushtetutës		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia Sociologjia dhe libri i Kushtetutës	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit 1-Bisedë me një jurist, avokat apo gjykatës 2-Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili zhvillojnë veprimtarinë përkatëse **Hapi i dytë**: Seanca gjyqësore Nxënësit përforcojnë një seancë gjyqësore. **Hapi i tretë**: Punë në grup. Dhënia e konkluzioneve **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes			

së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, libri i kushtetutës, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit dhe rëndësinë e ndarjes së pushteteve, rëndësinë e njohjes së saktë të formave të qeverisjes, rëndësinë qe ka funksionimi sa më i drejtë i demokracisë në një shoqëri rëndësia e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore etj
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi kupton funksionimin e ndarjes së pushteteve, parimeve të kushtetutës, rëndësinë e saj në organizimin shtetëror. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi c- vlerësim me anë të portofolit

Test për tematikën 2: Kushtetuta

1) Kushtetuta:
a-është ligji themeltar i shtetit
b-garanton formën e shtetit
c-garanton të drejtat dhe liritë themelore të individit
d-të gjitha më sipër

2) Referendumi
a-formë e shprehjes së mendimit të popullit për një çështje të veçantë
b-burim ligjor
c-ligj që ndryshon me kalimin e kohës
d-shtojcë që përmban një ndryshim ligjor

3) Pushteti ligjvënës ka të bëjë me:
a-qeverinë
b-parlamentin
c-gjykatën kushtetuese
d-partitë politike

4) Listoni disa nga parimet e kushtetutës
5) Përshkruani dallimin ndërmjet kushtetutave elastike dhe kushtetutave të ngurta
6) Çfarë përfaqëson gjykata Kushtetuese

Dt.___/____/__

Fusha: Të drejtat e Njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Çfarë janë të drejtat e njeriut		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë në libër dhe të argumentojnë pse ka ndryshuar koncepti për të drejtat e njeriut dhe pse është e domosdoshme të reflektojmë mbi to.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Jep përkufizimin e të drejtave të njeriut. - dallon lidhjen e të drejtave të njeriut me nevojat bazë të njeriut. - shpjegon lidhjen e të drejtave të njeriut me vlerat dhe interesat e tyre jetësore aktuale dhe të perspektivës.		**Fjalët kyçe:** *Të drejtat e njeriut, të drejtat themelore të njeriut, liri negative, liri pozitive, të drejtat natyrore.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia Deklarata e të drejtave të njeriut.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia dhe Deklarata e të drejtave të njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Diskutim i ideve Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për historikun e të drejtave të njeriut, rëndësinë e tyre, duke u bazuar dhe në kapitullin e Kushtetutës. Në këtë rast mësuesja ndihmon me konceptin e të drejtave themelore të njeriut. Të drejtat e njeriut garantohen në Kushtetutë. Ato janë universale , themelore dhe të patjetërsueshme . Mësuesja shpjegon historikun e të drejtave dhe përpjekjen njerëzore për t'i përfituar ato në formën që ato janë aktualisht. **Hapi i dytë**: Përvijimi i mendimit Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi rithekson: "Të drejtat e njeriut janë të drejta që i gëzon çdo individ në shoqërinë ku ai bën pjesë. Ato bazohen në dy kategori të mëdha lirish: 1-liri negative 2-liri pozitive			

Liria negative hyn në atë sferë lirish të cilat mbrojnë lirinë individuale prej ndërhyrjes së shtetit. Si psh:e drejta e fjalës, e drejta e besimit fetar etj...
Liria pozitive ka të bëjë me atë grup lirish e cila krahas barazisë formale , krijon dhe barazinë reale. Këtu është detyra e shtetit të sigurojë kushtet për garantimin e të drejtave, të cilat lidhen me shtetin social.
Të drejtat të cilat garantohen dhe mbrohen në kushtetutë janë të **drejtat themelore të njeriut**.
Këto të fundit bëjnë pjesë tek grupi **i të drejtave natyrore.**
Të drejtat natyrore mendohet se kanë lindur me njeriun. Ato jnë të patjetërsueshme dhe të pamohueshme si e drejta e jetës e pronës etj. Të drejtat që rrjedhin prej tyre janë në funksion të nevojave individuale , të vlerave dhe kulturës së një vendi. Ndaj këtu mësuesja thekson se të drejtat janë në ndryshim të vazhdueshëm.
Mësuesja sqaron konceptet tabu ;arbitraritet

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në tri grupe dhe secili grup argumenton dhe prezanton idetë si :
a-kane evoluar të drejtat e njeriut
b-lidhen të drejtat me liritë negative dhe pozitive
c-çfarë janë të drejtat themelore të njeriut.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, deklarata e të drejtave të njeriut, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe garantimin dhe mbrojtjen e tyre në kushtetutë. Gjithashtu diskutohet mbi evoluimin e të drejtave si dhe lidhja e tyre me liritë negative dhe pozitive.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e të drejtave themelore të njeriut, evoluimin e tyre dhe domosdoshmërinë e në shoqëri. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në dy grupe dhe do të diskutojnë mbi:
- liritë negative që kanë të bëjnë me barazinë formale dhe liritë pozitive me barazinë reale.
Në ndarjen në grupe nxënësit do të argumentojnë se çfarë përfaqësojnë këto sfera të lirisë dhe të drejtat që përfshihen në to.
-Çështje për diskutim:

Pse Zvicra një shtet demokratik ka aprovuar votimin e grave në 1971? -Nxënësit do të kërkojnë informacione mbi deklaratën e të drejtave të njeriut në internet.

Dt.___/____/__

Fusha: Të drejtat e Njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Kategoritë e të drejtave të njeriut dhe rëndësia e tyre		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë në libër dhe të argumentojnë pse nuk mund të quhesh demokraci e vërtete në regjimin totalitar, dhe pse mbaheshin zgjedhjet periodike dhe çdo shtetas i moshës 18 vjeç mund të votonte?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Interpreton konceptime të ndryshme të të drejtave të njeriut. - Shpreh qëndrimin vetjak në lidhje me të drejtat e njeriut. - përshkruan tiparet kryesore të të drejtave të njeriut dhe shpjegon rëndësinë e tyre.		**Fjalët kyçe:** *E drejta civile, e drejta politike, e drejta ekonomike, e drejta kulturore e drejta për zhvillim, elektorat aktiv, elektorat pasiv.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia Deklarata e të drejtave të njeriut.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë , koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia dhe Deklarata e të drejtave të njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Situata e të vepruarit
Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit
Identifikimi i problemit
Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë për historinë e Shqipërisë në kohën e monizmit, në kushtetutën e 1976-ës, dhe historinë e vendeve të Europës Lindore në përgjithësi.
Në këtë rast mësuesja ndihmon me konceptin e të drejtave themelore të njeriut dhe evoluimin e tyre gjatë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Garantimi real i të drejtave në shoqëri bëhet atëherë kur bashkëjetesa garantohet me anë të ligjit, kur shteti ekziston dhe institucionet funksionojnë realisht.

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto
Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi rithekson: "Të drejtat e njeriut janë të drejta që i gëzon cdo individ në shoqërinë ku ai bën pjesë. Ato bazohen në një emërues të përbashkët:
1-e drejta e jetës
2-e drejta për të jetuar me dinjitet
3-e drejta për të gëzuar barazi të plotë
Nëpërmjet ratifikimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut vetë shtetet bëhen garantuese për zbatimin dhe respektimin e kësaj deklarate.
Mësuesja sqaron dhe procesin e ratifikimit.
Kategoritë e të drejtave:
-të drejta civile
-të drejta politike-"elektorat aktiv" /votuesit dhe elektorat pasiv/postet politike
-të drejta ekonomike
-të drejta sociale
-të drejta kulturore
-të drejta për mjedisin
-të drejta për zhvillim
Mësuesja sqaron secilën nga këto kategori të drejtash. Të drejtat civile e politike konsiderohen të drejta të brezit të parë. Të drejtat ekonomike dhe sociale quhen të drejta të brezit të dytë, dhe të drejtat kulturore, për mjedisin dhe për zhvillim, janë të drejta të brezit të tretë.
Nxënësit sjellin shembuj nga Deklarata e të drejtave të njeriut.

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në tri grupe dhe secili grup argumenton dhe prezanton idetë si:
a-parimet themelore të të drejtave -të drejtat politike dhe civile
b-të drejtat ekonomike dhe sociale
c-Të drejtat kulturore dhe për zhvillim
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së

temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, deklarata e të drejtave të njeriut, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut, parimet dhe kategoritë e tyre. Gjithashtu diskutohet mbi rëndësinë e lidhjes dhe qëndrueshmërisë së tri kategorive të të drejtave.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e të drejtave themelore të njeriut, parimet në themel të tyre, kategoritë e të drejtave dhe ndërthurjen e këtyre kategorive. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi c- vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë: Nxënësit do të ndahen në grupe dhe do të diskutojnë mbi: - Nenin 1 të deklaratës së të drejtave të Njeriut. Grupet në fillim do ta shqyrtojnë nenin 1 pa e diskutuar me njeri-tjetrin. Secili grup do të dalë më konkluzionet e veta dhe më pas do ti listojnë të gjitha dhe së bashku do të nxjerrin konkluzionin përfundimtar. -Nxënësit do të kërkojnë informacione mbi deklaratën e të drejtave për zhvillim në internet në linkun e dhënë në libër.

Dt.___/____/__

Fusha: Të drejtat e Njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Të drejtat themelore të njeriut dhe institucionet ndërkombëtare		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi shembullin e dhënë në libër dhe të argumentojnë përgjigjet e tyre nëse është e mundur të përsëriten ngjarje të tilla. Çfarë është bërë në këtë drejtim në nivel ndërkombëtar pas Luftës së Dytë botërore? Si janë zhvilluar ngjarjet para dhe pas 1945?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe:** *Deklaratë, Kartë, Konventë, Traktat Ndërkombëtar.*	

- Përshkruan përmbajtjen e disa prej dokumenteve themelorë të të drejtave të njeriut. - Përshkruan institucionet europiane në mbrojtje të të drejtave të njeriut. - analizon të drejtat që përfshihen në dokumentet themelorë të të drejtave të njeriut.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia dhe deklarata e të drejtave të njeriut.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë , koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia dhe Deklarata e të drejtave të njeriut.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

Identifikimi i problemit

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi Luftën e Dytë Botërore, para dhe pas 1945. Të drejtat e njeriut do të ishin të cunguara nëse do të zbatoheshin nga një numër i kufizuar shtetesh.

Kështu më 1945 ShBA me shtetet e tjera perëndimore themeluan OKB-në. Një organizatë që u konceptua si qeveri e shteteve të sapo-dala nga lufta, e cila do të mbronte vetëvendosjen e popujve dhe të drejtat e njeriut.

Në këtë rast mësuesja ndihmon nxënësit me informacione mbi OKB-në. Ajo sot ka 193 vende anëtare. Mësuesja thekson datën e anëtarësimit të vendit tonë në OKB.

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi rithekson rëndësinë e OKB-së për mbrojtjen e sovranitetit të popujve dhe dinjitetit njerëzor. Kjo organizatë ka në themel një sërë Kartash. Më e rëndësishmja është **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)**. Bazuar në parimet themelore të kësaj deklarate janë hartuar shumë **Karta, Institucione dhe Organizata në nivel ndërkombëtar**.

Më 1966 Karta e OKB-së u pasua nga:

1-Karta e të drejtave civile dhe politike

2-Karta ndërkombëtare e të drejtave ekonomike

Kartat janë forma traktatesh ndërkombëtare të cilat duhet të respektohen nga të gjitha vendet nënshkruese.

Mësuesja thekson faktin se të dyja këto karta janë ratifikuar më 1991 nga Kuvendi shqiptar.

Listojmë Konventat e miratuara nga OKB

-Konventa mbi parandalimin dhe ndëshkimin e genocidit

-Konventa mbi eliminimin e çdo forme të dhunës
-Konventa kundër torturës... etj.
Mësuesja shpjegon ekzistencën e sistemeve rajonale të mbrojtjes si KE apo Këshilli i Europës (1949).
Risia e kësaj organizate është krijimi i Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut.
Kjo Gjykatë ndodhet në Strasburg, ose ndryshe quhet Gjykata e Strasburgut dhe çdo qytetar i vendeve që e kanë ratifikuar Konventën Europiane të të drejtave të njeriut ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Strasburgut.
Hapi i tretë: Praktikë e pavarur
Kontroll njohurish duke përdorur rubrikën e "Të menduarit kritik"
Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili grup argumenton dhe prezanton çështjet si:
a-si shpjegohet anëtarësimi i Shqipërisë në OKB në 1947?
Nxënësit paraqesin situatën politike të asaj kohe dhe japin konkluzionin.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, deklarata e të drejtave të njeriut, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut, OKB-së në garantimin e tyre, KE-së dhe Gjykatës së Strasburgut.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe qëllimit të themelimit të saj, parimet në themel të OKB-së dhe KE-së dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në dy grupe dhe do të diskutojnë mbi argumentet pro dhe kundër parimit të KE-së mbi ndalimin me ligj të vendimit me vdekje në vendet e anëtarësuara në KE.
-Nxënësit do të kërkojnë informacione mbi OKB-në dhe KE-në në internet në linkun e dhënë në libër.

Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Të drejtat e Njeriut</td><td>Lënda: Qytetari</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Kufizimi i të drejtave</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë në libër dhe të argumentojnë pse nuk mund të kemi një liri të pakufi dhe në sistemet demokratike të cilat mbrojnë e garantojnë liritë dhe të drejtat themelore.
A mund të zhvillohet jeta normalisht në një vend ku secili bën si të dojë?
A duhet të kufizohen liritë në një shoqëri demokratike?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:
- Përshkruan kufizimin ligjor të të drejtave të njeriut. konceptime të ndryshme të të drejtave të njeriut.
- Përshkruan sferën dhe kushtet e kufizimit të të drejtave të njeriut.
-Argumenton kufizimin ligjor, sferën dhe kushtet e kufizimit të të drejtave të njeriut.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: kufizimi i lirisë, Rend publik, Liri për të manifestuar, liri për te lëvizur.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia Deklarata e të drejtave të njeriut.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia dhe Deklarata e të drejtave të njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Situata e të vepruarit
Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit
Identifikimi i problemit
Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në jetën reale.
Në këtë rast mësuesja citon:”Liria ime mbaron aty ku fillon liria e tjetrit”-John Stuart Mill
Cfarë kuptoni me këtë thënie? A e gjykoni si të drejtë apo si të padrejtë?

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto</td></tr>
</table>

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Thënia e Mill do të quhet kufizimi i parë i lirisë. "Njeriu është i lirë për të vepruar kur nuk cenon lirinë e tjetrit për të vepruar gjithashtu. Kufizimi i dytë ka të bëjë me rendin publik. Liria e qytetarëve për të lëvizur kufizohet nga rregullat që duhet të zbatojë secili qytetar. Kur liria është tërësisht e kufizuar-aq sa bëhet e pazbatueshme, atëherë kemi rast të abuzimit të autoritetit publik si në sistemet diktatoriale. Qytetarët kanë liri ekonomike (hapja e sipërmarrjeve private) dhe liri politike (e drejta për të manifestuar). E drejta e manifestimit është e drejtë kushtetuese, por duhet të zbatohen disa rregulla për ruajtjen dhe qetësinë e rendit publik. Në raste manifestimesh, organizuesit duhet të marrin leje në polici dhe kjo e fundit të garantojë mbarëvajtjen e protestës.
Gjykata është organi që vlerëson ekuilibrin ndërmjet lirisë dhe rendi publik. Si pushtet i tretë dhe i pavarur ajo vlerëson nëse liria dhe të drejtat e qytetarëve janë shkelur nga dy pushtetet e tjera. Ndarja e pushteteve dallon një regjim demokratik nga një regjim totalitar. Kur të tria pushtetet kontrollohen nga partia në pushtet atëherë kemi të bëjmë më një regjim totalitar
Mësuesja shpjegon dhe jep informacione mbi iluminizmin dhe filozofët iluministë.
Më pas citon dhe fjalët kyce.
Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në tri grupe dhe secili grup argumenton dhe prezanton liritë dhe detyrat që secili nga të tri pushtetet duhet të përmbushë kundrejt pushtetit tjetër.

Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e ekzistencës së lirive por nga ana tjetër rëndësinë e ekzistencës së kufizimeve të lirisë po në emër të së drejtës dhe të paqes.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e lirive dhe kufizimin e tyre për ruajtjen e rendit publik.
Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:
a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Nxënësit do të ndahen në grupe dhe do të diskutojnë mbi:
Dallimet ndërmjet shoqërive demokratike dhe shoqërive totalitare. Ata do të mbështeten në shembuj nga historia e Shqipërisë dhe e vendeve të Europës Lindore.
Ata mund të sjellin dhe shembuj konkretë për secilin regjim e më pas të japin konkluzionet.

Dt.___/____/__

Fusha: Të drejtat e Njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Ndërlidhja e të drejtave dhe të drejtat në konflikt		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi rëndësinë e të drejtave dhe kategorizimin e tyre. Nxënësit i përgjigjen pyetjeve si: A ka një hierarki të të drejtave? A ekzistojnë disa të drejta më të rëndësishme se të tjerat? Citoni disa të drejta që i mendoni themelore.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Përshkruan me shembuj nga jeta e përditshme lidhjen e të drejtave të njeriut dhe rëndësinë e saj për realizimin e tyre tërësor. - Identifikon dhe shpjegon raste të të drejtave në konflikt. -Shprehen për zgjidhjen e konfliktit mes të drejtave.		**Fjalët kyçe:** *konflikt i të drejtave, Gjykatë Europiane e të drejtave të njeriut, Konventë Europiane e të drejtave të njeriut, baraspeshë e së drejtave, liri e ndërgjegjes dhe e fesë, liri e shprehjes.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia Deklarata e të drejtave të njeriut.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia dhe Deklarata e të drejtave të njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në jetën reale. Në këtë rast mësuesja citon dhe një herë:”Liria ime mbaron aty ku fillon liria e tjetrit”-John Stuart Mill Ajo shtron pyetje nga situata reale sot. A duhet të ndalohet botimi i karikaturave me karakter blasfemik apo duhen lejuar për hir të lirisë së shprehjes? Ka një sërë të drejtash që bien ndesh me njëra tjetrën. Konflikti ndërmjet të drejtave vjen dhe nga			

përplasja e kulturave të ndryshme brenda një shoqërie Shteti nëpërmjet gjykatave dhe autoriteteve të ndryshme përcakton të drejtat që kane më shumë rëndësi në krahasim me të tjerat. Këtë rol e ka dhe Gjykata Europiane e të drejtave të njeriut **Hapi i dytë**: Vëzhgo-analizo-diskuto Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Vënia në baraspeshë e të drejtave është shumë e rëndësishme." Shtetet në kushtetutën e tyre dhe në Konventën Europiane të të drejtave të njeriut përcaktojnë rastet kur një e drejtë sakrifikohet për hir të një të drejte tjetër më të rëndësishme. Për shembull, liria e shprehjes sakrifikohet në raste mashtrimi ose shpifjeje. Liria e ndërgjegjes dhe e besimit fetar është çështje më delikate sepse varet nga vlerësimi që bën çdo shtet në mënyrë të pavarur. Mësuesja shpjegon rëndësinë e ndërlidhjes së të drejtave që ato të jenë të zbatueshme më së miri. Më pas citon dhe fjalët kyçe. **Hapi i tretë**: Punë në grup. Praktikë e pavarur Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili grup zgjedh të jetë pro ose kundër (në formën e një debati)mbi çështjen: A përbën përgjimi i personave publikë , cenim të jetës së tyre private? Po nëse këto përgjime nxjerrin info për akte të dënueshme nga shteti, cili organ i gjykon? **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara . **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së konfliktit ndërmjet të drejtave dhe mënyrën e zgjidhjes së këtij konflikti. Gjithashtu ata theksojnë rëndësinë e ndërlidhjes së të drejtave për një funksionim më të mirë të tyre.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e njohjes dhe zgjidhjes së konfliktit ndërmjet të drejtave, dhe rëndësinë e ndërlidhjes për një funksionim më të plotë të tyre.
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë:Nxënësit do të gjejnë në internet Konventën Europiane të të drejtave të njeriut dhe do të ndërtojnë një lidhje hierarkike ndërmjet të drejtave. Më pas do të argumentojnë zgjedhjen e tyre .

Dt.___/____/__

Fusha: Të drejtat e Njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Disa të drejta themelore në kushtetutën e Shqipërisë		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi rëndësinë e të drejtave dhe kategorizimin e tyre. Nxënësit i përgjigjen pyetjeve si: A mendoni se është e mjaftueshme parashikimi i t drejtave në kushtetute që ato te jenë te zbatueshme? Cili nga te tre pushtetet mund t'i shkelë më shume të drejtat?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Përshkruan kategoritë e ndarjes së të drejtave të njeriut . - Dallon kategoritë kryesore të se drejtave dhe shpjegon raste të të drejtave në konflikt. -Argumenton kategoritë kryesorë të së drejtave .		**Fjalët kyçe:** *Të drejta themelore, e drejtë për të jetuar, e drejta e shprehjes , liri e ndërgjegjes, proces i rregullt ligjor.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia Deklarata e të drejtave të njeriut Kushtetuta e Shqipërisë.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Deklarata e të drejtave të njeriut dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në jetën reale. Në këtë rast mësuesja shpjegon historikun e hartimit të të drejtave të njeriut të cilat paraqiten dhe në kushtetutën shqiptare. Brezi i parë i të drejtave i takon periudhës së Revolucionit Francez, Deklaratës Amerikane të Pavarësisë, Kushtetutës Amerikane. Këto të drejta janë të drejtat politike dhe civile. Brezi i dytë i të drejtave ka karakter ekonomik dhe social dhe i takon shekullit të XIX. Të drejtat			

e brezit të tretë janë të shekullit të XX dhe janë krijuar në shërbim të grupeve të rrezikuara të popullsisë si e drejta për vetvendosje, për mjedis të shëndetshëm etj

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto

Së bashku me nxënësit, mësuesja liston dhe diskuton mbi disa të drejta themelore të Kushtetutës së Shqipërisë.

1-E drejta për jetën dhe ruajtjen e integritetit fizik dhe moral të individit

2-E drejta e shprehjes. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë.

3-E drejta për tu martuar e për të krijuar familje.

4-E drejta për tu organizuar

5-E drejta për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët

6-E drejta për një proces të rregullt ligjor.

Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Vënia në baraspeshë e të drejtave është shumë e rëndësishme dhe gjithashtu është i rëndësishëm mbrojtja respektimi dhe zbatimi i tyre."

Më pas citon dhe fjalët kyçe.

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur

Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili grup zgjedh të jetë pro ose kundër (në formën e një debati)mbi çështjen:

1-Përse shtetet ngurrojnë ti njohin si të barasvlershme të drejtat e brezit të parë me ato të brezit të dytë dhe të trëtë?

2-Nëse feja konsiderohet si ideologji, a janë të barasvlershme identiteti i njeriut dhe ideologjia kur dikush i prek ato me anë të opinionit të tij?

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së konfliktit ndërmjet të drejtave dhe mënyrën e zgjidhjes së këtij konflikti. Gjithashtu ata theksojnë rëndësinë e ndërlidhjes së të drejtave për një funksionim më të mirë të tyre.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi të tri brezat e të drejtave, të diskutojë dhe analizojë disa nga të drejtat themelore të Kushtetutës së Shqipërisë.

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Detyrë:Nxënësit do të ndahen në dy grupe dhe do të gjejnë në internet Kushtetutën e Shqipërisë të 1976 dhe Kushtetutën aktuale. Më pas nxënësit do të shohin përmbajtjen e këtyre dy kushtetutave dhe do të bëjnë krahasimin ndërmjet tyre.

Dt.___/____/__

Fusha:Të drejtat e njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr2		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtaritë si vijojnë në libër	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe:**.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia, libri i Kushtetutës, Deklarata e të Drejtave të Njeriut, Konventa e të drejtave të fëmijëve		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia Sociologjia, libri i Kushtetutës, Konventa e të drejtave të fëmijëve.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

1-Diskutim mbi të drejtat themelore të individit

2-Organizimi i një takimi me punonjës socialë

Hapi i dytë: Shkolla dhe puna

1-Mendoni alternativa të mundshme për ta kthyer shkollën në një mjedis ku të përfitohet më shumë

2-Organizoni një takim me punonjës të shërbimeve sociale apo nëpunës dhe diskutoni për masat që duhen ndërmarrë për të ndaluar shfrytëzimin e fëmijëve.

Hapi i tretë: Punë në grup.

Dhënia e konkluzioneve

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, libri i kushtetutës, interneti deklarata e të drejtave të njeriut; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së të drejtave, respektimit dhe zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e shoqërisë dhe sidomos

të drejtave qe kanë të bëjnë me fëmijët, si Konventa e të Drejtave të Fëmijëve etj.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi kupton rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sidomos të fëmijëve. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi

Dt.___/____/__

Fusha: Të drejtat e njeriut	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr 3		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtaritë si vijojnë në libër	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe:**	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia, libri i Kushtetutës, Deklarata e të Drejtave të Njeriut, Konventa e të drejtave të fëmijëve		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia Sociologjia, libri i Kushtetutës, Konventa e të drejtave të fëmijëve.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

1-Diskutim mbi situatat e dhëna në libër

Hapi i dytë: Organizimi i takimeve

1--Organizoni një takime me individë, grupe shoqërore që kanë organizuar protesta apo protestojnë kundër shkeljes së ligjit

Hapi i tretë: Punë në grup.

Dhënia e konkluzioneve pas diskutimeve

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, libri i kushtetutës, interneti deklarata e të drejtave të njeriut; për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së të drejtave, respektimit dhe zbatimit të tyre për mbarëvajtjen e shoqërisë, lirisë së shprehjes dhe të drejtës për të protestuar.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi kupton rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirinë për tu mbledhur në protesta. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: a- vlerësim formues b- vetëvlerësimi

Test për Tematikën 3: Të drejtat e njeriut

1) Të drejtat e njeriut janë:
a-të drejta që njeriu I gëzon në shoqëri
b-të drejta që mbrohen me ligj
c-të drejta që garantojnë lirinë e individëve për të jetuar
d-të gjitha më sipër

2) Liritë pozitive garantojnë:
a-barazinë reale
b-barazinë formale
c-të drejtat e njeriut
d-mbrojnë individin nga shteti

3) Të drejtat e njeriut grupohen në:
-të drejta civile…….

4) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u miratua nga:
a-Këshilli I Europës
b-Asambleja e Përgjithshme e OKB-së
c-Gjykata e Strasburgut
d-Parlamenti Europian

5) Konflikti në lidhje me të drejtat e njeriut ndodh për shkak të:
a-përplasja e kulturave të ndryshme
b-ruajtje të rendit publik
c-lëvizja e popullsisë
d-ekonomia e tregut

Dt.___/____/__

Fusha: Arsimimi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Arsimimi si një e drejtë themelore.		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi rëndësinë e shkollës dhe raportin e saj me zhvillimin teknologjik. Për situatën e dhënë mësuesja shtron pyetjet: A mund të zëvendësohet metoda e mësimit të drejtpërdrejtë me mësimin virtual? Cilat janë rreziqet që mbart ky zëvendësim?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Argumenton rëndësinë e arsimimit për jetën e secilit. -Analizon shkollën dhe funksionet e saj. -Argumenton të drejtën për arsim si e drejtë themelore.		**Fjalët kyçe:** *Shkollë, funksionet e shkollës, drejta themelore për arsimim.*	
Burimet: Teksti mësimor,njohuritë e nxënësve,interneti,enciklopeditë,historia,filozofia sociologjia,Konventa e të drejtave të fëmijëve,DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë ,koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia,Sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në jetën reale. Në këtë rast mësuesja shpjegon rëndësinë e arsimimit dhe shkollës,sjell historikun e evoluimit të saj. Mësuesja citon kuptimin etimologjik të fjalës shkollë: “Kalimi i kohës së lirë.” Gjithashtu mësuesja shtron pyetjen se si qëndron arsimi përballë zhvillimit teknologjik. **Hapi i dytë**: Vëzhgo-analizo-diskuto Së bashku me nxënësit, mësuesja liston dhe diskuton mbi funksionet e shkollës:			

1-Mësimi ose arsimimi
2-Shoqërizimi
3-Formimi i shprehive
4-Kriteri për pozitën e mëvonshme sociale
5-Certifikimi
Në planin shoqëror shkolla ka rëndësi sepse siguron:
-Integrimi shoqëror
-Vazhdimësinë kulturore
-Ndryshimin e zhvillimin shoqëror
Nxënësit diskutojnë mbi pikat e mësipërme.
Pas diskutimeve të nxënësve, mësuesi thekson: "Arsimimi është një e drejtë themelore e individit"
Nxënësit lexojnë nenet përkatëse të arsimit sipas Deklaratës së të Drejtave të Njeriut.
Një sfidë e përhershme është edhe zgjedhja e arsimimit. Sipas DDNJ-së prindërit kanë të drejtë parësore për zgjedhjen e fëmijës. Por sipas Konventës së të drejtave të fëmijëve ,duhet pasur parasysh dhe interesi i fëmijës.
Mësuesja shpjegon konceptet bazë dhe kuptimin e Kurrikulës.
Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit ndahen në dy grupe dhe secili grup zgjedh të jetë pro ose kundër (në formën e një debati) mbi çështjen e parashtruar në rubrikën e mendimit kritik.
-Si e mendojnë nxënësit çështjen e një shoqërie të deshkolluar?
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare,interneti DDNJ ,Konventa të ndryshme në lidhje me të drejtat e njeriut për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e shkollës,funksioneve të saj në aspekt individual dhe shoqëror dhe gjithashtu rëndësinë e arsimit si e drejtë themelore .

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi arsimin, funksionet e tij, rëndësinë e arsimit si e drejtë themelore dhe zgjedhjen sa më racionale të fushës së arsimit.

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë: Ese:Nxënësit do të analizojnë me shkrim temën: "Pse është primar interesi i fëmijës në edukim"?
.

Dt.___/____/__

Fusha: Arsimimi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Legjislacioni mbi arsimimin.		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi rëndësinë e garantimit të së drejtës për arsimim. Nxënësit lexojnë situatën dhe u japin përgjigje pyetjeve si: -Pse është i rëndësishëm garantimi i të drejtës për arsimim? -Çfarë rreziqesh mund të sjellë mohimi i kësaj të drejte?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Argumenton rëndësinë e mbrojtjes me ligj të së drejtës për arsimim. -Përshkruan disa nga realizimet e ligjit shqiptar për arsimin parauniversitar. -Analizon rëndësinë e këtyre realizimeve.		**Fjalët kyçe:** *E drejtë për arsimim, legjislacion shqiptar, arsim parauniversitar.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e ti, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë ,koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në njohuritë mbi historinë . Në këtë rast mësuesja shpjegon rëndësinë e arsimimit dhe shkollës,sjell historikun e evoluimit të saj. Mësuesja citon kuptimin e fjalës **educare** nga latinishtja "udhëheq" E drejta për arsimim si është përcaktuar në Kartën e OKB-së për të drejtat e njeriut i referohet arsimit pa pagesë në shkollën fillore dhe të domosdoshme. Megjithatë shtete të ndryshme e interpretojnë këtë kërkesë në mënyra të ndryshme.			

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto
Arsimi i garantuar nëpërmjet ligjit është i rëndësishëm sepse:
1-Arsimi zgjeron mundësitë e individit për të kontrolluar jetën e tij
2-E drejta për arsimim dhe aftësim ndihmon gjithashtu për ushtrimin e të drejtave civile,politike ekonomike
3-Arsimimi mund të nxitë mirëkuptimin,tolerancën paqen ndërmjet popujve
4-Mohimi i arsimimit dëmton demokracinë
E drejta për arsim është e drejtë themelore. Ajo hyn në grupin e të drejtave pozitive dhe kërkon ndërhyrjen e shtetit.
E drejta për arsim garantohet me Kushtetutë.
Në nenin 57 të Kushtetutës së Shqipërisë shkruhet se:
-Arsimi i detyrueshëm përcaktohet me ligj
-Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë etj etj
Sistemi arsimor shqiptar parauniversitar mbështetet në traditën shqiptare dhe në Kushtetutën shqiptare
Mbrojtja me ligj e së drejtës për arsim në sistemin parauniversitar përcaktohet në nenin5 dhe 6
Hapi i tretë: Punë ne grup. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi nenin 5 dhe 6. Në nenin 6 ata ndahen në dy grupe dhe secili grup zgjedh të analizojë katër parime të përgjithshme mbi arsimin.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me të drejtat e njeriut për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e mbrojtjes me ligj të arsimit,realizimeve të legjislacionit shqiptar për arsimin, shkollën, funksionet të saj në aspekt individual dhe shoqëror dhe gjithashtu rëndësinë e arsimit si e drejtë themelore.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi arsimin, rëndësinë e mbrojtjes ligjore të tij, realizimet konkrete në ligjin shqiptar për arsimin parauniversitar, rëndësinë e arsimit si e drejtë themelore dhe zgjedhjen sa më racionale të fushës së arsimit.
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues
2-vetëvlerësim

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë:Nxënësit do të analizojnë çështjen në rubrikën e mendimit kritik. Ata do të ndahen në dy grupe. Grupi i parë do të projektojë masat që mund të ndërmerren për fëmijët e varfër dhe grupi tjetër do të aprovojë masat që do të gjykohen më të nevojshme.

Dt.___/____/__

Fusha: Arsimimi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Institucionet shkollore dhe roli i tyre.		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi rëndësinë e mundësive të barabarta në arsim për të gjithë pavarësisht aftësive të secilit. Nxënësit lexojnë situatën dhe u japin përgjigje pyetjeve si: -A mendoni se parimi i barazisë në arsim aplikohet në institucionet shkollore në vendin tonë? -Cilat janë disa probleme në të cilat ndeshen këto institucione gjatë zbatimit të këtij parimi?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Përshkruan ndryshimet e shkollës ndër vite. -Përshkruan mundësitë që ofron arsimi në vendin tonë. -Dallon rolin e shkollës dhe të mësuesve.		**Fjalët kyçe:** *Institucione shkollore,e drejtë e të gjithëve për arsim, mundësi të barabarta.*	
Burimet: Teksti mësimor,njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në njohuritë mbi te drejtën për arsimim si një e drejtë themelore e brezit të dytë, e cila kërkon ndërhyrjen e shtetit. Në këtë rast mësuesja shpjegon se institucionet shkollore janë institucione me natyrë shoqërore,sepse janë institucione të organizuara dhe i shërbejnë shoqërisë.			

Mësuesja thekson dhe rolin e mësuesit i cili respekton çdo nxënës, të drejtat e tyre, por nga ana tjetër synon të ndërgjegjësojë nxënësit,prindërit,komunitetin për respektimin e të drejtave të çdo individi, pavarësisht nga kultura, raca, etnia

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto

Mësuesja shpjegon historiku e arsimimit që nga Greqia e lashtë. Ajo citon periudhat më të rëndësishme të historisë duke theksuar pikat kyçe të saj, si shpikja e shtypshkronjës nga Gutenberg dhe kushtetutën e Vajmarit duke vijuar me traktatet pas Luftës së Parë Botërore deri në deklaratën e Gjenevës 1924 duke paraprirë njohjes ndërkombëtare të së drejtës për arsim

Më pas vijon në rrafsh krahasimor me historikun e arsimit shqiptar. Shkolla e parë shqipe,Mësonjëtorja e Korcës u hap me 7 Mars 1887. Duhet theksuar që kjo shkollë ishte me natyrë kombëtare demokratike sepse përfshinte fëmijë të shtresave të ndryshme.

Si u përmend në mësimet e mëparshme, dokumentet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar sanksionojnë të drejtën e çdokujt për arsim.

Garantimi i mundësive të barabarta në arsim garantohet me ligj / Ligji për arsimin parauniversitar nr 69/2012.

Mësuesja thekson se për të realizuar funksionet e saj shkolla duhet të bashkëpunojë vazhdimisht me familjen dhe komunitetin.

Hapi i tretë:Diskutim .Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën e mendimit kritik. Cilat janë pengesat në zbatimin e procesit të gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin aktual arsimor shqiptar.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare,interneti DDNJ ,Konventa të ndryshme në lidhje me të drejtat e njeriut dhe për të drejtën për arsim, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e rolit të shkollës dhe të mësuesit, ndryshimeve në legjislacionin shqiptar për arsimin parauniversitar, mbrojtjes me ligj të barazisë dhe shanseve të barabarta në arsimim.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi arsimin, rëndësinë e barazisë dhe shanseve të barabarta, rëndësinë e rolit të mësuesit dhe të shkollës.

Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:

1-vlerësim formues

2-vetëvlerësim

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Detyrë: Nxënësit do të analizojnë çështjen në rubrikën e zgjerimit të njohurive dhe do të diskutojnë mbi informacionin e mbledhur në klasë.

Dt.___/____/__

Fusha: Arsimimi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Problemet e shkollës sot		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi informacionin e dhënë në libër mbi fenomenin e analfabetizmit. Ajo shtron për diskutim pyetjet: -Cilët mendoni se janë faktorët që ndikojnë në nivelin e lartë të analfabetizmit në botë? -A mendoni se analfabetizmi është problem shqetësues në vendin tonë?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Tregon disa nga problemet me të cilat përballet arsimi sot. -Përdor njohuritë dhe mjetet e tjera që ofron shkolla për të bërë zgjedhje për vazhdimësinë e arsimit. -Mbledh fakte e të dhëna për problemet e shkollës për të bërë interpretimin e tyre.		**Fjalët kyçe:** *Analfabetizëm , analfabetizëm funksional, standarde të shkollës, arsim cilësor.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë ,koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në njohuritë mbi te drejtën për arsimim si një e drejtë themelore e brezit të dytë, e cila kërkon ndërhyrjen e shtetit. Mësuesja shtron pyetjet:			

A i shërben shkolla interesave të nxënësve?
Çfarë duhet të bëjë shkolla për të përmbushur këto interesa?

Hapi i dytë: Vëzhgo-analizo-diskuto
Mësuesja shpjegon se shoqëria është në ndryshime të përhershme dhe këtyre ndryshimeve nuk i shmanget dot arsimi. Kjo dukuri nuk paraqitet vetëm në vendet e varfra dhe në zhvillim ,por edhe në vendet e zhvilluara. Problemet më të rënda janë:
1-Analfabetizmi-paaftësia për të shkruar dhe lexuar e personave mbi 6 vjeç
2-Analfabetizmi funksional
3-Sigurimi i standardeve të shkollës dhe arsimi cilësor
4-Gjithëpërfshirja dhe mundësitë e barabarta
5-Përshtatja e programeve mësimore në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
6-Administrimi i sjelljeve devijuese dhe i konflikteve në shkollë
Mësuesja shpjegon secilën nga problemet dhe njëkohësisht thekson dhe fjalët kyçe.
Më pas nxënësit ndahen në tre grupe dhe pasqyrojnë problemet në shoqërinë dhe arsimin shqiptar me shembuj konkretë.
Secilit grup i takojnë dy probleme për të analizuar

Hapi i tretë:Diskutim .Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën e mendimit kritik. Sipas raportit të Bankës Botërore 56% e 15-vjecarëve shqiptarë rezultojnë analfabetë funksionalë. Cilat janë shkaqet e këtij vlerësimi?
Si mendoni se mund të zgjidhet ky problem?
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ ,Konventa të ndryshme në lidhje me të drejtat e njeriut dhe për të drejtën për arsim, raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi problemet e arsimit në botë dhe në Shqipëri. Ata mund të prezantojnë zgjidhjet që ata i mendojnë si të mundshme për problemet e arsimit sot. Rëndësinë e rolit të shkollës dhe të mësuesit, ndryshimeve në legjislacionin shqiptar për arsimin parauniversitar, mbrojtjes me ligj të barazisë dhe shanseve të barabarta në arsimim.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi arsimin dhe problemeve që ai ka, rëndësinë e barazisë dhe shanseve të barabarta, rëndësinë e rolit të mësuesit dhe të shkollës.
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues

2-vetëvlerësim
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë:Nxënësit do të analizojnë çështjen 2-në rubrikën e mendimit kritik. Diskutim:A mendoni që do të vazhdoni arsimin e lartë?Nëse po, cilën degë do të zgjidhni?

Dt.___/____/__

Fusha: Arsimimi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Reforma arsimore dhe shkolla si qendër komunitare		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi informacionin e dhënë në libër mbi reformën arsimore dhe shkolla si qendër komunitare. Ajo shtron për diskutim pyetjet: -A keni dëgjuar ndonjëherë nismën "shkolla si qendër komunitare "Flisni rreth saj. -A ka nevojë për reforma arsimore në Shqipëri, për të përforcuar bashkëpunimin mes shkollës, familjes dhe komunitetit?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Përshkruan reformat arsimore dhe zbatimin e tyre. -Parashikon pasoja të ndryshme të qëndrimeve ,politikave apo ligjeve të ndryshme. -analizon ndikimin e reformave arsimore në institucionin e shkollës.		**Fjalët kyçe:** *Reforma arsimore,pjesëmarrje e të rinjve ,multikulturalizëm.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia sociologjia, Konventa e të drejtave të fëmijëve, ligji 69, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Konventa e të	

	drejtave të fëmijëve, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutimi i ideve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë dhe duke u mbështetur në njohuritë mbi problemet e arsimit, reformën në arsim dhe synimet e kësaj reforme. Arsimi është një nga fushat më të prekshme nga ndryshimet shoqërore dhe si i tillë është e nevojshme të arrihet përshtatja e shkollës me ndryshimet shoqërore.

Mësuesja thekson se: "Reforma në arsim përfshin legjislacionin kurrikulat, infrastrukturën, burimet njerëzore personelin që përfshihen në arsim

Hapi i dytë: Përvijimi i mendimit

Reformat ndërmerren për ta përshtatur arsimin me ndryshimet shoqërore.Mësuesja shpjegon se reformimi i sistemit arsimor mund të hasë vështirësi :

1-Reformat nëse nuk arrijnë tragetin e tyre rrezikojnë të jenë jorealiste

2-Reformimi i arsimit duhet shoqëruar me ligje të përshtatshme ose ajo rrezikon të mos zbatohet

3-Mësuesit duhet të jetë i trajnuar dhe i informuar paraprakisht në lidhje me reformat.

4-Reforma duhet të marrë në konsideratë opinionet e grupeve të interesit.

Mësuesja thekson se pjesëmarrja e të rinjve është e rëndësishme në reformë:

a-identifikojnë çështjet që duhet të jenë në qendër të vëmendjes

b-duke marrë pjesë në reforma,të rinjtë aftësohen të marrin pjesë dhe në çështje të tjera që kërkojnë të reformohen

c-pjesëmarrja e të rinjve në projektimin e reformave arsimore nxit gjithëpërfshirjen dhe vlerat e një shoqërie demokratike duke forcuar besimin në angazhimin qytetar.

Më tej mësuesja shpjegon rëndësinë e shkollës si një shoqëri multietnike dhe multikulturore. Gjithashtu po theksohet rëndësia e hapjes dhe e lidhje së shkollës me komunitetin.

Hapi i tretë: Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën e mendimit kritik. Ata listojnë në tabelë parimet që udhëheqin shkollën si qendër komunitare. Sipas mendimit të nxënësve, pse parimi i diversitetit është shumë i rëndësishëm për shkollën si qëndër komunitare?

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ ,Konventa të ndryshme në lidhje me të drejtat e njeriut dhe për të drejtën për arsim ,ligji 69,raportet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi reformat dhe domosdoshmërinë për tu adaptuar me ndryshimet shoqërore. Gjithashtu nxënësit duhet të diskutojnë mbi shkollën si qendër komunitare problemet e arsimit në botë dhe në Shqipëri.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi arsimin dhe reformave mbi të. Gjithashtu përgjigje konkrete duhet që shkolla të konsiderohet si qendër multikulturore, multietnike dhe për më tepër për shkollë duhet të luajë rolin e qendrës komunitare problemeve që arsimi ka,rëndësinë e barazisë dhe shanseve të barabarta,rëndësinë e rolit të mësuesit dhe të shkollës si qendër komunitare Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë: Nxënësit do të analizojnë çështjen 2-në rubrikën e mendimit kritik. Zgjerim njohurish: Kërkoni në internet raporte dhe manuale të institucioneve të ndryshme në lidhje me shkollën si shoqëri multietnike dhe multikulturore. Paraqitni veçoritë e kësaj shkolle.

Dt.___/____/__

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Përsëritje Kapitulli IV		**Situata e të nxënit:** Mësuesja nxit nxënësit të punojnë ushtrimet e përsëritjes dhe gjithashtu nxit diskutimin dhe bashkëbisedimin mbi rëndësinë e arsimit si e drejtë themelore	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - identifikon konceptet kryesore të kapitullit. - vlerëson rëndësinë e arsimit, kurrikulës reformës arsimore, arsimin si e drejtë themelore,legjislacionin shqiptar për arsimin, risitë në arsim, shkolla si qendër multikulturore dhe si qenër komunitare. - argumenton me shembuj nga jeta e përditshme mbi domosdoshmërinë e arsimimit të duhur dhe reformave të përshtatshme për të.		**Fjalët kyçe:**	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve,		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat**	

interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia filozofia, Kushtetuta Shqiptare, KEDF.	**ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e bashkepunimit, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Sociologjia, Filozofia, KEDF, legjislacioni shqiptar për arsim

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:diskutimi mbi konceptet kryesore të kapitullit

Mësuesja nxit nxënësit të diskutojnë mbi konceptet kryesore

Hapi i dytë: Vëzhgo-Analizo-Diskuto

Pas diskutimeve të nxënësve, punohen ushtrimet e librit.

Hapi i tretë: Punë në grup. Praktikë e pavarur

Nxënësit ndahen në dy grupe: pro dhe kundër reformës arsimore në edukim në Shqipëri. Diskutimi zhvillohet në formën e një debati.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: përsëritjes dhe lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, legjislacioni shqiptar mbi arsimin, reformat në edukim dhe ndërtimin e njohurive të reja, prezantimi i argumenteve dhe demonstrimi konkret i tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e arsimit dhe përshtatjes së tij më sfidat e kohës.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e arsimit, zbatimit të reformave në mënyrën e duhur, rëndësinë e kulturës, traditave legjislacionit mbi arsimin etj. Të ketë koncepte të sakta mbi shkollën, mbi shkollën si qendër multikulturore dhe multietnike, mbi shkollën si qendër komunitare, mbi legjislacionin për arsim,mbi historikun e arsimit në botë dhe në vendin tonë,mbi reformat në arsim, në rolin e mësuesit etj.

Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi
c- vlerësim me anë të portofolit

Detyra:

Test për Tematikën 4: Arsimimi

1) Listoni funksionet e shkollës:
a-
b-
c-
d-

2) Shkolla siguron:
a-integrim social
b-vazhdimësi kulturore
c-zhvillim social
d-të gjitha më sipër

3) Themeli mbi të cilin ndërtohet i gjithë procesi i edukimit është:
a-shkolla
b-zhvillimi dhe integrimi social
c-kurrikula shkollore
d-formimi i shprehive

4) Me anë të ligjit të arsimimit nxitet:
a-demokracia dhe aftësitë individuale
b-ushtrimi i të drejtave të tjera
c-toleranca, mirëkuptimi, përparimi social
d-të gjitha më sipër

5) Institucionet arsimore kanë natyrë:
a-shoqërore
b-ekonomike
c-etnike
d-politike

6) Shkolla ndërvepron vazhdimisht:
a-me familjen
b-me komunitetin
c-me individë të fushës akademike
d-të gjitha më sipër

Dt.___/____/__

Fusha: Shëndeti	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: 1-Shëndeti si një e drejtë themelore **2-Legjislacioni për shëndetin**		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi informacionet apo mënyrën e ndryshme të të menduarit për shëndetin. Sipas mendimit tuaj: - Çfarë do të thotë të jesh i shëndetshëm?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Jep përkufizimin për shëndetin - Vlerëson shëndetin si një e drejtë njerëzore. - Analizon rëndësinë e kujdesit shëndetësor për njeriun. -Argumenton domosdoshmërinë e mbrojtjes me ligj të shëndetit -Tregon si legjislacioni shqiptar është në mbrojtje të shëndetit.		**Fjalët kyçe:** *Shëndet ,e drejtë për shëndet,e drejtë për kujdes shëndetësor.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia, filozofia, Kushtetuta e Organizatës Botërore të shëndetit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë ,koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia,Filozofia, Sociologjia, Kushtetutën e OBSH-së, DDNJ dhe Kushtetutën e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Diskutimi i njohurive paraprake Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë. Ata ftohen te japin mendime se çfarë përfaqëson shëndeti sipas tyre. Nxënësit nxiten të japin mendime në lidhje me temën e re. **Hapi i dytë**: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Pas përgjigjeve të nxënësve për të përkufizuar konceptin e shëndetit mësuesja thekson: “Shëndeti është një aspekt themelor i jetës së njeriut. Sipas konceptimit filozofik shëndeti quhet qëllim më vete i ekzistencës.”			

Sipas OBSH-së "Shëndeti përcaktohet si mirëqenie e plotë fizike,mendore dhe sociale. Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut e përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetit në 1946.
Mësuesja shpjegon se e drejta për shëndet përfshin disa aspekte si:
-E drejta për shëndet është e drejtë përfshirëse
- Bazohet në liri
-Nënkupton disa të drejta të tjera
-Shërbimet shëndetësore të siguruara pa asnjë diskriminim
Diskutojmë me nxënësit pikat e mësipërme
Rikujtojmë që çdo e drejtë bazohet në legjislacion dhe e drejta për shëndet është e njohur në legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.
Nxënësit listojnë disa traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që e njohin të drejtën për shëndet:
1-Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial
2-Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
3-Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit të Grave
4-Konventa mbi të drejtat e Fëmijëve etj
Mësuesja citon se Shqipëria ka ratifikuar të gjitha konventat që kanë të bëjnë me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor. Në Kushtetutë theksohet se: "Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdesin shëndetësor nga shteti"
Nxënësit diskutojnë mbi tabelën ku janë renditur ligjet shqiptare për mbrojtjen e shëndetit dhe përpiqen të sjellin shembuj konkretë.
Në fund të shpjegimit ritheksohet që: Dhe pse shëndeti konceptohet si mirëqenie fizike, psikologjike individuale, mbrojtja e shëndetit të popullatës mbetet prioritet

Hapi i tretë: Punë në grupe. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën e mendimit kritik.
Diskutojnë të ndarë në dy grupe mbi: Si gjejnë zbatim ligjet e shtetit shqiptar në jetën e përditshme. Ata listojnë argumentet pro dhe kundër dhe diskutimi organizohet në formën e një debati.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me shëndetin e njeriut, OBSH-në, të drejtat e njeriut dhe për të, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi shëndetin si e drejtë themelore domosdoshmërinë për ta mbrojtur atë, diskutojnë mbi traktatet ndërkombëtare dhe mbi legjislacionin shqiptar në mbrojtje të shëndetit dhe shërbimit shëndetësor.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi

shëndetin si e drejtë themelore dhe kujdesin mbi të. Gjithashtu përgjigje konkrete duhen mbi legjislacionin shqiptar dhe traktatet ndërkombëtare mbi shëndetin. Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë: Nxënësit do të analizojnë çështjet në rubrikën e mendimit kritik. Zgjerim njohurish:Evidentoni në legjislacionin shqiptar çështje që kanë të bëjnë me të drejtën për shëndet të grupeve të veçanta të popullatës si gratë, fëmijët, persona me aftësi të kufizuar. Si zbatohet e drejta për shëndet në rastin e tyre?

Dt.___/____/__

Fusha: Shëndeti	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: 1-Parandalimi dhe informacioni		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë:Të gjithë janë të ndërgjegjshëm që është më mirë të parandalosh sesa të kurohesh. Megjithatë ekzistojnë shumë pengesa që pengojnë parandalimin efektiv të sëmundjeve. Ato kanë të bëjnë me faktorë që lidhen me arsimin,kulturën shëndetësore etj.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - Argumenton rëndësinë e mbrojtjes paraprake të shëndetit. - Argumenton rëndësinë e parandalimit të veprimit të faktorëve që ndikojnë në të. - Analizon rëndësinë e informimit publik për çështjet e shëndetit.		**Fjalët kyçe:** *Parandalim,informacion për shëndetin,programe depistuese, edukim shëndetësor.*	
Burimet: Teksti mësimor,njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia, filozofia, Kushtetuta e Organizatës Botërore të shëndetit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së	

	tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Kushtetutën e OBSH-së, DDNJ dhe Kushtetutën e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutimi i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë. Ata ftohen te japin mendime se çfarë përfaqëson shëndeti sipas tyre si ndikojnë faktorët e mëposhtëm në parandalimin e sëmundjeve

a-niveli i ulët i informacionit mbi rreziqet që kërcënojnë shëndetin

b-pamundësia për të bërë zgjedhje të shëndetshme

c-presioni kulturor

Konkretizoni me shembuj konkretë faktorët e mësipërm

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas përgjigjeve të nxënësve për të përkufizuar parandalimin mësuesja thekson se në kuptimin e ngushtë parandalim do të thotë të shmangësh zhvillimin e një sëmundjeje ndërsa në plan më të gjerë do të thotë të marrësh një sërë masash që kufizojnë përparimin e sëmundjes. Parandalimi klasifikohet në tre nivele:

1-Parandalim parësor

2-Parandalim sekondar

3-parandalim terciar.

Mësuesja i diskuton këto nivele me nxënësit duke sjellë shembuj konkretë.

Për sa i përket informacionit shëndetësor ne mund të gjejmë një mori informacionesh nga interneti. Por sa të besuara janë këto informacione?

Mjediset kryesore për të përhapur informacionin shëndetësor janë shkollat,vendet e punës,komuniteti ,institucionet shëndetësore, qendrat tregtare etj

Falë tyre ata zgjerojnë audiencën e tyre. Shpërndarja e informacionit sigurohet dhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv.

Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën e mendimit kritik.

Diskutoni në klasë pse shkollat,institucionet shëndetësore përbëjnë një mjedis kyç për përhapjen e informacionit shëndetësor?

Cila është audienca në këto mjedise?

Si ndryshon ky informacion nga ata që merren nga interneti?

Metodologjia Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me shëndetin e njeriut, OBSH-në,të drejtat e njeriut dhe për të, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi shëndetin dhe parandalimin e sëmundjeve dhe faktorët e tij. Gjithashtu nxënësit prezantojnë llojet e informacionit dhe format e shpërndarjes së tij.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi shëndetin dhe parandalimin e sëmundjeve duke studiuar tre nivelet e tij. Gjithashtu nxënësi duhet ti përgjigjet pyetjeve konkrete dhe mbi shpërndarjen e informacionit shëndetësor. Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Detyrë: Nxënësit do të analizojnë çështjet në rubrikën e mendimit kritik. Informacioni shëndetësor është mjet shumë i mirë për të ndihmuar popullatën për përmirësimin e shëndetit,por ai nuk është i mjaftueshëm për të ndryshuar sjelljet shëndetësore. Çfarë mjetesh dhe mekanizmash do të mund të ndikonin në sjelljen shëndetësore me qëllim ndryshimin e saj.

Dt.___/____/__

Fusha: Shëndeti	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Disa nga armiqtë kryesorë të shëndetit		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi informacionin e dhënë: Në shëndetin e individëve dhe komuniteteve ndikojnë shumë faktorë të marrë së bashku. Përveç mënyrës së jetesës faktorët janë: vendi ku jetojmë, kushtet mjedisore, faktorë gjenetikë, niveli i të ardhurave, niveli i arsimimit si dhe marrëdhëniet shoqërore familjare.	

Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** -Identifikon dhe përshkruan disa nga problemet që lidhen me shëndetin . - Diskuton për shkaqet kryesore të disa prej problemeve. - Dallon disa nga shtresat më të pafavorizuara të shoqërisë dhe problemet që lidhen me shëndetin.	**Fjalët kyçe:** *Mënyrë jetese droga të paligjshme.*
Burimet: Teksti mësimor,njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë,historia, sociologjia, filozofia, Kushtetuta e Organizatës Botërore të shëndetit, DDNJ.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Kushtetuta e OBSH-së, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutimi i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë. Ata ftohen të japin shembuj konkretë se si ndikojnë në shëndet faktorë të ndryshëm individual dhe social.

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas përgjigjeve të nxënësve për të dhënë shembuj konkretë mësuesja shpjegon rreziqet e shëndetit dhe mjedisi si:

-ndotja e ajrit
-ndotja e ujit
-rreziqet në shkolla
-rreziqet në shtëpi
-rreziqet në rrugë
-rreziqet në vendet e punës

Nxënësit sjellin shembuj të ndryshëm nga rreziqet e listuara më lart

Nxënësit pyeten së cilat janë disa nga rrëziqet për shëndetin.

Ata listojnë:

-Duhani

-Alkoli
-Droga dhe substanca të tjera të ndaluara
-Sëmundjet seksualisht të transmetueshme
-Mbipesha/obeziteti
Diskutojmë mbi sëmundjet që mund të sjellin fenomenet e mësipërme
Mësuesja shtron pyetjen:Cilat janë grupet më të pafavorizuara të shoqërisë?
Nxënësit përgjigjen: pakicat rome dhe egjiptiane, të sëmurët me sida, të pastrehët, popullsia me nivel më të ulët të edukimit.

Hapi i tretë: Diskutim. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën veprimtari në grup. Sipas në raporti studimi të 42 vendeve europiane rezulton që edhe pse në rënie, djemtë konsumojnë duhanin më shume se vajzat.
Diskutoni në klasë:
- Sa e rëndësishme është të informohesh para se të marrësh një vendim
-Pse djemtë janë më të prirur se vajzat për të konsumuar duhan dhe alkool? Sa të rrezikshme janë këto substanca për shëndetin tonë?
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare,interneti DDNJ ,Konventa të ndryshme në lidhje me shëndetin e njeriut, OBSH-në, të drejtat e njeriut dhe për të, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi shëndetin dhe rreziqet e tij. Ata diskutojnë mbi faktorët që rrezikojnë shëndetin dhe grupet e pavaforizuara të popullsisë. Gjithashtu nxënësit diskutojnë pse është i rëndësishëm marrja e informacionit.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi shëndetin dhe rreziqet që e kanosin atë,faktorët që rrezikojnë shëndetin dhe grupet e pafavorizuara të popullsisë, parandalimin e sëmundjeve duke studiuar tre nivelet e tij. Gjithashtu nxënësi duhet ti përgjigjet pyetjeve konkrete dhe pse është e rëndësishme marrja e informacionit në lidhje me shëndetin.
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues
2-vetëvlerësim
3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Detyrë:Nxënësit do të analizojnë çështjet në rubrikën e mendimit kritik.
-Diskutoni në klasë shembuj mbi vendimet e marra nën efektin e alkoolit dhe drogës
-Analizoni raportin shëndetësor të popullatës shqiptare.

Dt.___/____/__

Fusha: Shëndeti	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Disa fëmijë janë të ndryshëm për shkak të pamjes,brishtësisë, intelektit, prejardhjes familjare,raciale apo krahinore. -A ndjehen këta fëmijë të kërcënuar për shkak të karakteristikave të mësipërme? -Cilat janë mjediset ku këta ndjehen të kërcënuar?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** -Tregon si ligji shqiptar mbron shëndetin e të gjithë shtresave të shoqërisë. - Rendit disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin. - Shpreh qëndrimin e tij mbi çështjet e shëndetit.		**Fjalët kyçe:** *Nëpërkëmbje, doping në sport, dhunë.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia, filozofia, Kushtetuta e Organizatës Botërore të shëndetit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Kushtetuta e OBSH-së, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Rrjeti i diskutimit Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë. Ata ftohen të japin shembuj konkretë se si ndikojnë këto cilësi të këtyre fëmijëve në cilësinë e jetës së tyre. **Hapi i dytë**: Vëzhgo-analizo-diskuto Pas përgjigjeve të nxënësve për të dhënë shembuj konkretë mësuesja shpjegon disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin si:			

-dhuna -nëpërkëmbja -dopingu në sport Legjislacioni shqiptar ka në përbërjen e tij ligje mbi kërcënuesit e shëndetit si: -ligji për mbrojtjen e shëndetit nga duhani -ligji për mbrojtjen e të miturve nga alkooli -ligji për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS -ligji për përdorimin e substancave narkotike -legjislacioni për luftën kundër dhunës. **Hapi i tretë**: Diskutim. Praktikë e pavarur Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik në grup .në të gjithë botën njihet veprimi i ligjit antialkool dhe antiduhan. Si zbatohet ky ligj në Shqipëri? Cilët janë faktorët që pengojnë zbatimin e ligjeve në Shqipëri? Diskutoni në klasë: -Çfarë mendoni për doping si fenomen? -Çfarë mendoni ju se do të ndodhte nëse ai legalizohej? **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me shëndetin e njeriut, OBSH-në, të drejtat e njeriut dhe për të, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi shëndetin dhe rreziqet e tij. Ata diskutojnë mbi faktorët që rrezikojnë shëndetin dhe grupet e pavaforizuara të popullsisë. Gjithashtu nxënësit diskutojnë pse është i rëndësishëm marrja e informacionit.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi shëndetin dhe disa nga çështjet bashkëkohore të tij si dhuna, dopingu, lëndët narkotike, alkooli etj. Gjithashtu nxënësi duhet ti përgjigjet pyetjeve konkrete dhe mbi legjislacionin përkatës ndaj këtyre çështjeve të shëndetit. Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Dt.___/____/__

Fusha: Shëndeti	Lënda: Qytetari	Shkalla: V	Klasa: X
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr 4		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtaritë si vijojnë në libër	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe**	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve,interneti, enciklopeditë, historia,filozofia, sociologjia, libri i Kushtetutës, Deklarata e të Drejtave të Njeriut, OBSH dhe konventa të miratuara prej saj		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia Sociologjia, libri i Kushtetutës, Konventa e të drejtave të fëmijëve.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

1-Diskutim mbi situatat e dhëna në libër

Hapi i dytë: Organizimi i takimeve

1-Organizoni një tryezë të rrumbullakët ku të përfshihen aktorë që janë përgjegjës për ligjin antiduhan.

Hapi i tretë: Punë në grup.

Dhënia e konkluzioneve pas diskutimeve

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia,interneti, deklarata e të drejtave të njeriut; raporte të OBSH-së për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së ligjeve të cilat mbrojnë shëndetin ,respektimit dhe zbatimit të tyre për shoqëri sa më të shëndetshme.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi kupton rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit si e drejtë themelore e individit. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi

Test për tematikën 5: Shëndeti

1) Shëndeti:
a-është gjithëpërfshirës dhe shmang diskriminimin
b-bazohet në liri
c-lidhet me të drejtat e tjera
d-të gjitha më sipër

2) Parandalimi i sëmundjeve klasifikohet në?

3) Parandalimi parësor i referohet:
a-gjithëpërfshirjes
b-veprimeve që shmangin zhvillimin e sëmundjeve
c-informacionet shëndetësore
d-marrjen e masave për kurimin e sëmundjeve

4) Rreziqet shëndetësore
a-ndotja e ajrit dhe e ujit
b-rreziqet në shkollë dhe në shtëpi
c-rreziqet në rrugë dhe punë
d-të gjitha më sipër

5) Përshkruani armiqtë e shëndetit
a-
b-
c-
d-

Dt.___/____/__

Fusha: Mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Ekologjia.		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Në shekuj me radhë njerëzit kanë besuar se mjedisi u shërbente atyre pa kufi. Ndryshimet e bëra në mjedis mund të shkaktojnë probleme për botën mbarë. A mund të përmendni disa pasoja që sjell ndërhyrja e pakontrolluar në mjedis?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** -Shpjegon lidhjen ndërmjet ruajtjes së mjedisit me ruajtjen e vetë njeriut. - Vlerëson mjedisin e shëndetshëm si e drejtë e vetë njeriut.		**Fjalët kyçe:** *Ekologji, mjedis, e drejtë për një mjedis të shëndetshëm.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, , sociologjia, biologjia gjeografia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të mjedisit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Gjeografia, Biologjia, Sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**:Diskutim mbi njohuritë paraprake Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi mjedisin dhe rolin që njeriu luan. Mësuesja shpjegon se çfarë është Ekologjia. Ajo vjen nga fjala greke Eco dhe logo (logjikë). Si themeluesi i ekologjisë moderne është Charles Darwin. **Hapi i dytë**: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Pas diskutimit të nxënësve mësuesja shpjegon se çfarë është mjedisi. Mjedisi është bashkësia e pjesëve përbërëse të natyrës: ajri, uji, toka, klima flora dhe fauna, si dhe trashëgimia kulturore si			

pjesë e mjedisit e krijuar nga njeriu.
Mësuesja thekson se mjedisi ndikon drejtpërdrejtë në jetën e njeriut dhe përbën një element thelbësor për zhvillimin mendor, fizik, intelektual dhe psikologjik.
Njeriut i është dashur të përshtatet me mjedisin ku jeton dhe zhvillimet teknologjike kanë sjellë përfitime të ndryshme, por ndërhyrjet brutale në mjedis janë shoqëruar me dëmtime serioze të tij. Çdo veprimtari e dëmshme në mjedis sjell pasoja të dëmshme për njeriun.
E drejta për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm hyn tek të drejtat e njeriut. Mësuesja thekson se më 1972 Deklarata e Stokholmit e miratuar nga OKB, hodhi dritë mbi të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit. Ajo gjithashtu përmend dhe konventa të tjera të miratuara për mbrojtjen e mjedisit
Mësuesja shpjegon konceptet e Biodiversitetit dhe Erozionit dhe diskuton me nxënësit duke sjellë shembuj konkret.
Hapi i tretë: Diskutim. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik në grup .A mendoni se jetoni në një mjedis të shëndetshëm?Evidentoni disa probleme mjedisore që rrezikojnë shëndetin në zonën tuaj.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, ekologjia, gjeografia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me mjedisin, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi mjedisin dhe lidhjen e ti të ngushtë me njeriun. Ata diskutojnë se si zhvillimi teknologjik ka efekt pozitiv dhe negativ në jetën e individëve

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi mjedisin dhe rolin e tij ne rritje mbi individin dhe shoqërinë. Gjithashtu nxënësi duhet t'i përgjigjet pyetjeve konkrete dhe mbi legjislacionin dhe Konventat ne mbrojtje te mjedisit,
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues
2-vetëvlerësim
3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Zgjerim Njohurish: hulumtoni në internet për të evidentuar rastet e dëmtimit të mjedisit nga njeriu

Dt.___/____/__

Fusha: Mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Rreziqet për planetin. Roli i shkencës dhe teknologjisë në ruajtjen e planetit		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë:Flora shqiptare përmban 32% të florës europiane, pra konsiderohet një florë relativisht e pasur. Nxënësit lexojnë situatën dhe përpiqen tu përgjigjen pyetjeve si: -A keni dëgjuar së fundmi të flitet për shkatërrimin e florës në Shqipëri? -Tregoni disa prej problemeve të shfaqura në këtë drejtim.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** -Dallon rreziqet me të cilat sot përballet planeti ynë. - Identifikon disa nga format e ndotjes së mjedisit në Shqipëri. -Rendit disa nga llojet kryesore të ndotjes në bashkësinë ku jeton.		**Fjalët kyçe:** *rreziqe mjedisore rol i dyanshëm, veprim i shteteve, veprim i individëve.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, biologjia gjeografia, ekologjia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të mjedisit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Gjeografia, Biologjia, Sociologjia, Ekologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Situata e të vepruarit
Hapi i parë:Di-dua të di-mësova
Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi mjedisin dhe rreziqet që i kanosen atij nga zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë. Situata është klasifikuar katastrofë planetare dhe ne jemi dëshmitarë të ndryshimeve klimatike që po ndodhin
Nxënësit nxiten të konkretizojnë situatën me shembuj.

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
Pas diskutimit të nxënësve mësuesja shpjegon se çfarë kuptohet me "nëntë kufijtë".Ajo thekson se dy profesorët nga universiteti i Stokholmit kanë listuar rreziqet që i kanosen planetit.
-Ndryshimet Klimatike
-Zhdukja e konsiderueshme e specieve
-Shtimi i fosforit , nitrogjenit dhe elementëve të tjera
-Shpyllëzimi
-Emetimi i gazeve serrë në atmosferë
-Dëmtimi i ozonit
-Acidifikimi i oqeaneve
-Shpërdorimi i ujërave të ëmbla
-Depozitimi i mbetjeve organike dhe materiale radioaktive në mjedis.
Mësuesja shpjegon rolin e shkencës dhe teknologjisë në mbrojtjen e mjedisit edhe pse zhvillimi i saj ka ndikuar në ndotjen e tij.
Për sa i përket përpjekjeve të njeriut shtetet po ndërmarrin nismat e nevojshme për ta shpëtuar mjedisin. Ato përpilojnë akte ligjore me qëllim parandalimin e katastrofave.
Duke u bazuar në tekstin mësimor nxënësit lexojnë dhe komentojnë masat e ndërmarra nga Ministria e Mjedisit.
Një faktor i rëndësishëm është dhe njeriu. Mësuesja shpjegon domethënien e shprehjes: Mendo globalisht , vepro lokalisht. Sensibilizimi i individëve është shumë hap i rëndësishëm në mbrojtje të mjedisit.
Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik në grup .Identifikoni format më të përhapura të ndotjes së mjedisit në Shqipëri dhe veçanërisht në komunitetin ku jetoni.
-Çfarë mund të bënit ju për të pakësuar nivelin e ndotjeve. A veproni kështu?
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, ekologjia, gjeografia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me mjedisin, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rreziqet që i kanosen mjedisit dhe pse është e rëndësishme që të gjithë ne të mobilizohemi për ruajtjen dhe mbrojtjen e tij.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi mjedisin dhe rreziqet që i kanosen atij. Gjithashtu nxënësi duhet ti përgjigjet pyetjeve konkrete dhe mbi legjislacionin dhe Konventat ne mbrojtje te mjedisit si dhe masat e ndërmarra në plan global dhe individual Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Zgjerim njohurish: Domethënia e ditës së Tokës. Hulumtoni në internet për të evidentuar domethënien e ditëve të tjera që shoqëritë organizojnë në mbrojtje të mjedisit.

Dt.___/____/__

Fusha: Mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Zhvillim I qëndrueshëm		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë:Pajisjet elektroshtëpiake dhe konsumi i energjisë. Pajisjet që kanë A dhe AA+ janë pajisje që nuk konsumojnë shumë energji elektrike. Si lidhet konsumi i energjisë me konsumin e burimeve të natyrës?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** **-**Përkufizon termin Zhvillim i qëndrueshëm		**Fjalët kyçe:** *Zhvillim i qëndrueshëm, energji, politikë europiane.*	

-analizon politikat europiane në mbrojtje te mjedisit	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, biologjia gjeografia, ekologjia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të mjedisit, DDNJ.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Gjeografia, Biologjia, Sociologjia, Ekologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Diskutimi i ideve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi mjedisin dhe rreziqet që i kanosen atij nga zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë dhe nga kriza botërore që kryesisht mbështetet në pamjaftueshmërinë e të mirave dhe shërbimeve dhe në burimet e shterueshëm.

Nxënësit nxiten të sjellin shembuj të burimeve të shterueshme.

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja thekson se sidomos në gjysmën e dyte të shekullit të XX ne vitin 1987 Komisioni Botëror për mjedisin paraqiti një raport i cili u quajt raporti Brundtland-në të cilin u hodh ideja e zhvillimit të qëndrueshëm. Zhvillim i qëndrueshëm është një model i ri zhvillimi që përcaktohet nga interesa publikë duke marrë parasysh aspektet e përgjithshme mjedisore në një botë të globalizuar.

Mësuesja qartëson më tej idenë e zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i tij është që të krijojë modele të qëndrueshme në aspektin:

-social

-ekonomik

-ekologjik

-trashëgimia kulturore. Ky aspekt është shtuar kohët e fundit.

Energjia dhe mjedisi janë faktorë kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm. Burimet e energjisë klasifikohen në të shtershme dhe të pashtershme.

Nxënësit sjellin shembuj të këtyre burimeve specifike të energjisë.

Mësuesja i rikthehet shpjegimit mbi politikat europiane për mbrojtjen e mjedisit. Objektivat e tyre janë:

-ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit

-shfrytëzimin racional të burimeve

-shpalljen e masave mjedisore për një problem në një zonë të caktuar
-lufta kundër ndryshimeve klimatike
Këto objektiva janë prioritetet e Be-së
Vlerësimi pesëvjecar i Agjensisë Europiane për mjedisin ka treguar se politikat për mjedisin dhe klimën kanë dhënë rezultate të konsiderueshme.
Hapi i tretë: Diskutim. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik në grup .Sipas jush pse është e rëndësishme që legjislacioni shqiptar për mjedisin të pasqyrojë direktivat e BE-së?
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, ekologjia, gjeografia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ , Konventa të ndryshme në lidhje me mjedisin , të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rreziqet që i kanosen mjedisit dhe mënyrat se si Europa, organizata të ndryshme mjedisore kanë ndërmarre hapa konkretë për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe burimeve. pse është e rëndësishme që të gjithë ne të mobilizohemi për ruajtjen dhe mbrojtjen e tij.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi mjedisin dhe rreziqet që i kanosen atij dhe të gjithë njerëzimit. Gjithashtu nxënësi duhet ti përgjigjet pyetjeve konkrete dhe mbi legjislacionin dhe Konventat ne mbrojtje te mjedisit si dhe masat e ndërmarra në plan global europian dhe individual në mbrojtje të mjedisit.
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues
2-vetëvlerësim
3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Zgjerim Njohurish:Identifikimi i projekteve.
Hulumtoni në internet për të evidentuar projekte me natyrë ekonomike, private ose publike për zhvillimin e qëndrueshëm. Përgatisni një përmbledhje të tyre duke treguar:
Kush e ka ndërmarrë projektin
Cili është qëllimi i tij
Çfarë aktivitetesh janë kryer
Çfarë rezultatesh janë arritur.

Dt.___/____/__

Fusha: Mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Legjislacioni shqiptar për ruajtjen e mjedisit		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë:Juristët janë në të njëjtën mendje se asnjë fushë tjetër nuk ka njohur në një çerek shekulli një rritje të tillë sa fusha e mjedisit. Në planin ndërkombëtar ekzistojnë shumë instrumente juridike si ligje, deklarata vullnetare etj. Pse mendoni se është i rëndësishëm legjislacioni kombëtar për mjedisin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** **-**Bën kërkime të pavarura ose në grup për mënyrën se si trajtohet mjedisi ne aspekt qendror dhe lokal -Tregon se si legjislacioni shqiptar mbron mjedisin.		**Fjalët kyçe:** *Mbrojtje e mjedisit, Kushtetutë e Shqipërisë, ligje të veçanta, ligje për mbrojtjen e mjedisit.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, biologjia gjeografia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të mjedisit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Gjeografia, Biologjia, Sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**: Diskutimi i njohurive paraprake Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi mjedisin dhe rreziqet që i kanosen atij dhe domosdoshmërisë së mbrojtjes së tij. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me mbrojtjen e mjedisit-"Veprimtaria që synon parandalimin dhe kufizimin e ndotjes, të degradimit të mjedisit, përtëritjen , ruajtjen dhe përmirësimin e tij" **Hapi i dytë**: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Pas diskutimit të nxënësve mësuesja thekson se legjislacioni shqiptar për mjedisin është duke kaluar në një fazë intensive integrimi me ligjet e BE-së. Ligjet shqiptare që përmenden: -Ligji për mbrojtjen e tij -Ligji për mbrojtjen e diversitetit			

-Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis
-Ligji për zonat e mbrojtura
-Ligji për mbrojtjen e faunës së egër
-Ligji për gjuetinë dhe ndalimin e gjuetisë
Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ka objektivat e veta:
Parandalimi, kontrolli dhe pakësimi i ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe biodiversitetin;
Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
Mbrojta dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.
Pasi diskutohet rëndësia e arritjes së këtyre objektivave arrihet në konkluzionin se ruajtja dhe zhvillimi i mjedisit nuk është vetëm përgjegjësi e qeverisë por e të gjithë qytetarëve
Hapi i tretë: Diskutim. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë nëse:Mbrojtja e mjedisit është një çështje e rëndësishme që duhet trajtuar jo vetëm në nivel qendror por edhe lokal.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, ekologjia, gjeografia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me mjedisin, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.
Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi legjislacionin për mjedisin në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu nxënësit duhet të japin përgjigje të sakta mbi koherencën që legjislacioni shqiptar ka me ligjet ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi mjedisin dhe legjislacionin ndërkombëtar, rajonal, lokal në mbrojtje të tij. Gjithashtu nxënësi duhet ti përgjigjet pyetjeve konkrete dhe mbi Konventat në mbrojtje të mjedisit si dhe masat e ndërmarra në plan global europian dhe individual në mbrojtje të mjedisit.
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues
2-vetëvlerësim
3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Zgjerim Njohurish: Nxënësit ndahen në grupe.
Hulumtoni në internet dhe zgjidhni një nga ligjet e përmendura në këtë mësim. Përshkruani qëllimin objektin dhe fushën e zbatimit të ligjit.Ligjin që keni zgjedhur shqyrtojeni sipas tabelës së mëposhtme.

Dt.___/____/__

Fusha: Mjedisi	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr 5		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtaritë si vijojnë në libër	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe**	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia ekologjia, libri i Kushtetutës, Deklarata e të Drejtave të Njeriut, OBSH dhe konventa të miratuara prej saj		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Ekologjia, Sociologjia, libri i Kushtetutës, Konventa e të drejtave të fëmijëve.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

1-Diskutim mbi situatat e dhëna në libër

Hapi i dytë: Organizimi i takimeve

1—Organizimi i një ekspozite kulturore.

Hapi i tretë: Punë në grup.

Organizimi i një vizite tek fëmijët parashkollorë dhe shpërndarja e këtij informacioni duke ia përshtatur kësaj moshe

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, interneti, deklarata e të drejtave të njeriut;konventa dhe deklarata vullnetare për mbrojtjen e mjedisit, për ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së ligjeve të cilat mbrojnë mjedisin , respektimit dhe mbrojtjes së burimeve të ricikluesshme dhe të paricikluesshme.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi kupton rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit si ambienti i domosdoshëm për të drejtat themelore të individit. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi

Test për tematikën 5: Mjedisi

1) Ekologjia studion
a-marrëdhëniet e qenieve të gjalla me mjedisin ku jetojnë
b-sjelljen e kafshëve në një mjedis të caktuar
c-sjelljet e njeriut në një mjedis të caktuar
d-ndryshimet klimatike dhe pasojat mjedisore

2) Mjedisi është……

3) Përmendni disa prej rreziqeve mjedisore

4) Parandalimi i katastrofave mjedisore
a-reduktimin e ndotjes në zona të ndryshme
b-administrimin e mbetjeve urbane dhe rritja e ndërgjegjes sociale
c-mbrojtja e biodiversitetit dhe burimeve të ndryshme ujore
d-të gjitha alternativat më sipër

5) Ruajtja e mjedisit është përgjegjësi:
a-vetëm e shëndetit
b-e të gjithëve
c-vetëm e shoqërisë
d-e organizatave të ndryshme jo qeveritare

Dt.___/____/__

Fusha: Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Konsumatori – të drejtat dhe detyrimet		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Që prej vitit 1983, data 15 mars njihet si Dita Ndërkombëtare e Konsumatorit, e cila ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve. A i njihni të drejtat tuaja si konsumatorë? Po detyrimet?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** • përshkruan tiparet kryesore të ligjit mbi konsumatorin; • përcakton përmbajtjen e konceptit konsumator; • përshkruan të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit		**Fjalët kyçe:** *Mbrojtje e konsumatorit, konsumator, të drejtat e konsumatorit, detyrimet e konsumatorit.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, biologjia gjeografia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të konsumatorit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Gjeografia, Biologjia, Sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**:Diskutimi i njohurive paraprake Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi konsumatorin. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me termin konsumator- "Çdo person i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit." **Hapi i dytë**: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Pas diskutimit të nxënësve mësuesja thekson se mbrojtja e konsumatorit paraqet një nga prioritetet kryesore që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut. Përgjegjësitë dhe detyrimet e konsumatorit; Të drejtat e konsumatorit sipas legjislacionit shqiptar; Nxënësit lexojnë ligjin në libër ndërsa mësuesja citon qëllimin e ligjit "Për mbrojtjen e			

konsumatorit”.
Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur
Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë: përse është i rëndësishëm marrja e kuponit tatimor për konsumatorin.
Metodologjia
Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, sociologjia, Kushtetuta shqiptare, interneti, DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me konsumatorin, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .
Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi legjislacionin për konsumatorin, çfarë interesash mbron ai, të drejtat e konsumatorit dhe detyrat e tij.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t’i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi konsumatorin dhe legjislacionin në mbrojtje të tij.
Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:
1-vlerësim formues
2-vetëvlerësim
3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër
Zgjerim Njohurish: Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup duhet të zgjedhë një nga çështjet e mëposhtme:
Sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, duke u mbështetur në burime të ndryshme, të shpjegojnë pse organizatat jofitimprurëse konsiderohen si konsumatorë.
Të përshkruajnë masat që marrin agjencitë për mbrojtjen e konsumatorit dhe shtetet nga duhani dhe produkte të tjera që dëmtojnë shëndetin.

Dt.___/____/__

Fusha: Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Në shtëpinë tuaj nevojitet një aparat televizori. Të gjithë jeni në një mendje për blerjen e kësaj pajisjeje, por po diskutoni për zgjedhjen e markës, madhësisë, ngjyrës etj. Cilët janë faktorët që ndikojnë në blerjen e këtij produkti në	

	familjen tuaj?
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** • përshkruan disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit; • demonstron aftësi të shmangë dhe të zgjidhë probleme të thjeshta si konsumator.	**Fjalët kyçe:** *sjellje konsumatore, marrje e vendimit të blerjes, faktorë.*
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, biologjia gjeografia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të konsumatorit, DDNJ.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Gjeografia, Biologjia, Sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutimi i deve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi sjelljen e konsumatorit. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me sjelljen konsumatore dhe procesin e marrjes së vendimit të blerjes- "studimi i natyrës blerëse është po aq i rëndësishëm sa ç'është diagnostikimi i kujdesshëm i pacientit për mjekun, përpara se t'i rekomandojë kurën e nevojshme."

Hapi i dytë: Përvijimi i mendimit.

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja paraqet faktorët që ndikojnë zgjedhjen e konsumatorit.

Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë për faktorët që ndikojnë në blerje.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, sociologjia, interneti, DDNJ, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi marrjen e vendimit të blerjes, faktorët që ndikojnë në të dhe procesin e blerjes.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi marrjen e vendimit të blerjes dhe faktorët që ndikojnë në të.

Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Zgjerim Njohurish: Nxënësit plotësojnë tabelën e paraqitur në libër ku tregohen nevojat njerëzore sipas psikologut Maslou.

Dt.___/____/__

Fusha: Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Kontrata e shitblerjes dhe elementet e saj		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Kontrata e shitjes negociohet nga blerësi dhe shitësi. Kontrata do të quhen që nga marrëveshjet e thjeshta gojore e deri te dokumentet e ndërlikuara ligjore, në varësi të natyrës së marrëdhënies që përbën objektin e saj. Çfarë dini ju për kontratat? A kanë vlerë ligjore kontratat e pashkruara?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** Analizon dhe përshkruan elementet kryesorë të kontratës së shitblerjes;		**Fjalët kyçe:** *kontratë, kontratë shitblerjeje, lloje kontratash, kushte të lidhjes së kontratës, zgjidhje e kontratës.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, biologjia gjeografia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të konsumatorit, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Sociologjia, DDNJ dhe Kodi Civil i vitit 2012.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit			

Hapi i parë:Diskutimi i njohurive paraprake Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi kontratën. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me kontratë: "marrëveshje dhe veprim juridik nëpërmjet të cilit një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë apo shkëpusin një marrëdhënie juridike." **Hapi i dytë**: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Pas diskutimit të nxënësve mësuesja paraqet llojet e kontratave. Kushtet e përgjithshme të lidhjes së kontratës, efektet e kontratës, zgjidhjen e kontratës dhe pasojat e saj. **Hapi i tretë**:Diskutim. Praktikë e pavarur Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe ndërtojnë një tabelë (e dhënë në kërkesën "Veprimtari në grup") të cilën do ta plotësojnë me informacione nga Kodi Civil për llojet e kontratave të veçanta. **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si biologjia, sociologjia, interneti, DDNJ, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara . **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi kontratat, llojet e tyre dhe pasojat e zgjidhjeve të tyre.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi kontratat, llojet, kushtet. Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Dt.___/____/__

Fusha: Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Garancia		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Disa njerëz parapëlqejnë të blejnë nëpërmjet internetit, ndërsa disa të tjerë jo. Veçanërisht në rast blerjeje të pajisjeve me përdorim afatgjatë, siç janë pajisjet	

	elektronike, mjaft konsumatorë kërkojnë të pajisen me fletëgarancinë e produktit. Ata nuk janë të sigurt se shitësi në distancë do t'iu përgjigjet nëse malli i sapoblerë nuk do të funksionojë siç duhet. Po ju keni pasur ndonjëherë probleme me ndonjë produkt të ri? Në rast se po, a i jeni drejtuar shitësit, duke shfrytëzuar fletëgarancinë e produktit? Nëse po, është zgjidhur problemi?
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** Shpjegon elementet dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit;	**Fjalët kyçe:** *garanci, lexim i garancisë, rëndësi e garancisë.*
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të konsumatorit, DDNJ.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutimi i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi fletëgarancinë. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me garanci: "siguria që prodhuesi i jep konsumatorit për cilësinë e një malli ose për shërbimin që ky i fundit blen."

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja paraqet procedurat e mbrojtjes pas blerjes, për përmbajtjen e garancisë dhe leximin e saj, për rëndësinë e garancisë dhe respektimin e të drejtave të konsumatorit.

Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit ndahen në grupe dhe ndërtojnë një tabelë (tabela në Veprimtari në grup) në bazë të fletëgarancive të ndryshme që arrijnë të marrin.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së

temës me disiplina të tjera si sociologjia, interneti, DDNJ, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara . **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi konceptin e garancisë dhe rëndësinë e saj.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi garancinë. Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Zgjerim Njohurish: Nxënësit hulumtojnë në faqe interneti që tregtojnë produkte të ndryshme, duke u përqendruar tek mënyra se si sigurohet garancia e mallrave për konsumatorin që blen nëpërmjet internetit dhe të paraqitin një raport për punën e tyre.

Dt.___/____/__

Fusha: Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Reklama dhe konsumatori		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Kujtoni disa reklama që ju kanë mbetur në mendje dhe përshkruajini ato. Çfarë mendoni se është e rëndësishme në këto reklama: produkti që reklamohet, personazhet, ideja etj. Sa jeni të ndikuar nga një reklamë e caktuar për të blerë produktin e reklamuar në të?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** përshkruan funksionet e reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj si shkelje e të interesave dhe të drejtave të		**Fjalët kyçe:** *reklamë, funksione të reklamës, organizata në mbrojtje të konsumatorit, keqpërdorim i reklamës.*	

konsumatorit; identifikon organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kushtetuta e Organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbrojtje të konsumatorit, DDNJ.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Sociologjia, DDNJ

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutimi i ideve

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi reklamat. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me reklama:" një formë e pguar e promocionit."

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja paraqet modelet e reklamave, funksionin e reklamave.

Keqpërdorimi i reklamës;

Organizata në mbrojtje të konsumatorit;

Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata hulumtojnë në internet për kërkimin e shoqatave të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si sociologjia, interneti, DDNJ, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi reklamat, funksionet e tyre dhe organizatat në mbrojtje të konsumatorit.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi reklamat dhe funksionet e tyre, organizatave mbrojtëse të konsumatorit dhe keqpërdorimin e reklamave.

Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:

1-vlerësim formues

2-vetëvlerësim

3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër.

Dt.___/____/__

Fusha:Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Veprimtari praktike nr 6		**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim dhe punë në grupe. Mësuesja fton nxënësit të zhvillojnë veprimtaritë si vijojnë në libër	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:**		**Fjalët kyçe:**.	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, filozofia, sociologjia, ekonomia, libri i Kushtetutës, Deklarata e të Drejtave të Njeriut, Shoqata në mbrojtje të konsumatorit.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e debatit konstruktiv, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia, Filozofia, Sociologjia, Ekonomia, libri i Kushtetutës, Konventa e të drejtave të njeriut, Shoqata në mbrojtje të konsumatorit	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë: Rrjeti i diskutimit

1-Diskutim mbi reklamat

Hapi i dytë: Identifikimi i problemeve të konsumatorit

1-Organizimi i një pune studimore.

Hapi i tretë: Punë në grup.

Realizimi i punës studimore

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia, filozofia, interneti, deklarata e të drejtave të njeriut;ligje për mbrojtjen e konsumatorit, marketingun, me qëllim ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e njohjes së ligjeve të cilat mbrojnë konsumatorin , funksionet e reklamës, respektimit dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit sepse ne të gjithë jemi konsumatorë.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi kupton rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit si një e drejtë themelore e individit. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja:

a- vlerësim formues
b- vetëvlerësimi

Dt.___/____/__

Fusha: Konsumatori	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Përsëritje 3 Kapitulli VII		**Situata e të nxënit:** Mësuesja nxit nxënësit të punojnë ushtrimet e përsëritjes dhe gjithashtu nxit diskutimin dhe bashkëbisedimin mbi rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit, tipeve të reklamave, njohjes së kushteve të kontratës etj.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** - identifikon konceptet kryesore të kapitullit. - vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit, kushteve të kontratës, legjislacionin shqiptar në mbrojtje të konsumatorit, tipet dhe funksionet e reklamës. - argumenton me shembuj nga jeta e përditshme mbi domosdoshmërinë e mbrojtjes së konsumatorit nga organet shtetërore dhe organizata jo qeveritare.		**Fjalët kyçe:**	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, historia, sociologjia filozofia, Kushtetuta Shqiptare, KED, Shoqata në mbrojtje të konsumatorit		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon frymën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe pasuron fjalorin nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si Historia , Sociologjia, Filozofia, KEDF, legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e konsumatorit	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**:diskutimi mbi konceptet kryesore të kapitullit Mësuesja nxit nxënësit të diskutojnë mbi konceptet kryesore **Hapi i dytë**: Vëzhgo-Analizo-Diskuto Pas diskutimeve të nxënësve, punohen ushtrimet e librit. **Hapi i tretë**: Punë në grup. Praktikë e pavarur Nxënësit ndahen në dy grupe :pro dhe kundër industrisë së reklamave. Diskutimi zhvillohet në formën e një debati. **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij sipas: përsëritjes, dhe lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera, si historia , filozofia, sociologjia, legjislacioni			

shqiptar mbi mbrojtjen e konsumatorit, realizimin e kushteve të një kontrate, format dhe funksionet e reklamës dhe ndërtimin e njohurive të reja, prezantimi i argumenteve dhe demonstrimi konkret i tyre mbështetur në shembuj nga realiteti në bazë të njohurive të përftuara . **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit sepse ne të gjithë jemi konsumatorë.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit, zbatimit të ligjeve në mbrojtje të konsumatorit, rëndësinë e njohjes së kushteve të një kontrate, kushteve dhe funksioneve të reklamës kulturës, etj.Të ketë koncepte të sakta mbi konsumatorin si person fizik, mbi realizimin e një kontrate sipas ligjit dhe mbrojtjen ee konsumatorit nga reklamat mashtruese etj. Vlerësimi që mund të përdoret nga mësuesja: c- vlerësim formues d- vetëvlerësimi e- vlerësim me anë të portofolit
Detyra:

Test për tematikën 7: Konsumatori

1) Konsumatori është……..

2) Përgjegjësitë dhe detyrimet e konsumatorit përfshijnë
a-vlerësimin e cilësisë
b-përgjegjësi sociale dhe ekologjike
c-solidaritet
d-të gjitha më sipër

3) Piramida e Maslow-t përfshin 5 lloje nevojash. Listojini ato

4) Faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorit janë…….

5) Shpjegoni: Garancia është pjesë e kontratës

6) Përshkruani llojet dhe funksionet e reklamës

Dt.___/____/__

Fusha: Puna dhe e drejta e punës	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Puna dhe legjislacioni i punës (pjesa 1)		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Fjala punë ka disa kuptime. Puna, në kuptimin ekonomik, është çdo veprimtari e paguar që mundëson prodhimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve. Në kuptimin filozofik, puna është ajo veprimtari që dallon njeriun nga qeniet e tjera. Mirëpo, fjala punë njihet dhe në botën e shkencës së fizikës ku ky term përkufizohet si energjia që ushtron një forcë për zhvendosjen e një objekti. Puna studiohet nga degë të ndryshme: aspektet ekonomike i studion ekonomia e punës, ajo sociologjike, sociologjia e punës dhe në kuadrin juridik, e drejta e punës. Si e kuptoni ju punën? Sipas jush, a mund të konsiderohet punë çdo aktivitet njerëzor?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** jep një përcaktim të termave punë dhe punoj; rendit lloje të ndryshme punësh; dallon faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues; tregon përgjegjësinë e shtetit për punën; rendit të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën; diskuton për rëndësinë e legjislacionit të punës për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të punonjësve;		**Fjalët kyçe:** *punë, aktivitet i njeriut, profesione dhe zanate, shërbim dhe prodhim, punëtor, i vetëpunësuar.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kodi i Punës, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së	

	tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutimi i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi punën. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me termin punë: "çdo proces që, nëpërmjet veprimtarisë së ushtruar nga njeriu, e lidh këtë të fundit me mjedisin përreth, duke sjellë për pasojë ndryshimin e tij."

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja përforcon termin e punës.

Puna si mjet për sigurimin e të ardhurave;

Llojet e ndryshme të punës: termi punëtor dhe i vetëpunësuar;

E drejta për punë;

Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë: a duhet të ekzistojë e drejta e punës për të gjithë njerëzit? Si përcaktohet hapja e një vendi pune? A mundet shteti të marrë përsipër punësimin e plotë të njerëzve?

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij: lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera si sociologjia, historia, Kushtetuta shqiptare, interneti, DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me legjislacionin e punës, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi konceptin e punës, llojet e saj dhe të drejtën për punë.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi konceptin e punës, llojet e saj dhe të drejtën për punë.

Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:

1-vlerësim formues

2-vetëvlerësim

3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Veprimtari në grup: nxënësit të ndahen me grupe. Secili grup duhet të zgjedhë një nga çështjet e mëposhtme:

Nëpërmjet burimeve që mund të shfrytëzojnë, të kërkojnë llojet e punëve nga antikiteti deri më

sot. Të përpiqen të kuptojnë ndikimin e teknologjisë në punë. Duke hulumtuar në internet, të gjejnë shembuj të mënyrave sesi është trajtuar në kinematografi tema e skllavërisë dhe e punës së detyruar. Të kërkojnë në internet për origjinën e varianteve të termit "punë" në gjuhët europiane.

Dt.___/____/__

Fusha: Puna dhe e drejta e punës	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Puna dhe legjislacioni i punës (pjesa 2)		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Marrëdhënia e punës përfshin bashkëpunimin e dy ose më shumë personave. Duke përjashtuar rastin e vetëpunësimit, marrëdhënia e punës përfshin një punonjës dhe një punëdhënës. Punonjësi është ai që kryen punën dhe punëdhënësi është ai që ofron punën. Midis tyre krijohet një marrëdhënie vartësie. Duke qënë se një punëdhënës ka më shumë fuqi së një punonjës, marrëdhënia e tyre duhet rregulluar në mënyrë që të respektohen të drejtat dhe detyrimet e secilit. Cilat mund të jenë pasojat e mosmbrojtjes të së drejtave të punonjësve? Çdo të thotë palë e fortë dhe palë e dobët në marrëdhënie pune?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** rendit disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë jep përkufizimin e kontratës sipas legjislacionit dhe të përshkruajë elementët e saj; rendit disa nga hapat e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij në punë.		**Fjalët kyçe:** *e drejta për punë, Kodi i Punës, interesa të punonjësve, mënyra të mbrojtjes së tyre.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve,		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat**	

interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kodi i Punës, DDNJ.	**ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutimi i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi të drejtën për punë. Mësuesja thekson se cfarë kuptojmë me termin e drejta për punë: ”objektiv social që kushtetuta ia ngarkon për detyrë shtetit.”

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja paraqet Kodin e Punës dhe parimet themelore;

Të drejtat e punonjësve dhe mbrojtja e tyre;

Faktorët që mundësojnë një proces prodhimi;

Hapi i tretë:Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë rastet kur diskriminimi në Kodin e punës është i pranueshëm.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera si sociologjia, historia, Kushtetuta shqiptare, interneti, DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me legjislacionin e punës, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara .

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi Kodin e punës, të drejtën për punë, të drejtat e punonjësve dhe procesin e prodhimit.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t’i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi Kodin e punës, të drejtën për punë, të drejtat e punonjësve dhe procesin e prodhimit.

Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:

1-vlerësim formues

2-vetëvlerësim

3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Veprimtari në grup: nxënësit të ndahen me grupe dhe të diskutojnë rreth filmit “Filadelfia” për problematikat e tij.

Zgjerim njohurish: Të diskutojnë të mirat dhe të këqijat e diskriminimit pozitiv.

Dt.___/____/__

Fusha: Puna dhe e drejta e punës	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Kontrata e punës dhe elementet e saj		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Marrëdhëniet individuale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve mes palëve. Një ndër format e marrëveshjes është dhe kontrata. Meqenëse marrëdhëniet e punës përfshijnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta të palëve, ato do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Rëndësia e kontratës së punës është e padiskutueshme: palët do të jenë të detyruara ta respektojnë, sikur të ishte ligj. A duhet shkruar kontrata e punës apo thjesht një marrëveshje e pashkruar mes palëve do të ishte e pranueshme?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** mbledh fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e të bëjë interpretimin e tyre; parashikon pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri; përshkruan disa nga të drejtat e tij në punë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre;		**Fjalët kyçe:** *kontratë pune, kontrata kolektive, shkak, objekt, formë kontrate, CV, rekrutim*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kodi i Punës, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e Shqipërisë.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Situata e të vepruarit **Hapi i parë**:Diskutimi i njohurive paraprake Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi kontratën e punës. Mësuesja thekson se çfarë kuptojmë me termin kontratë pune: "nje marrëveshje me anë të së cilës punonjësi merr përsipër të punojë për llogari dhe nën drejtimin e një punëdhënësi kundrejt një shpërblimi" **Hapi i dytë**: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Pas diskutimit të nxënësve mësuesja paraqet formën e një kontrate pune dhe thekson se ajo duhet të jetë gjithmon e shkruar; Lidhjen e kontratës së punës; Zgjidhjen e kontratës së punës; **Hapi i tretë**:Diskutim. Praktikë e pavarur Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë hapat e domosdoshëm për gjetjen e një vendi pune. **Metodologjia** Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera si sociologjia, historia, Kushtetuta shqiptare, interneti, Kodi i Punës, DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me legjislacionin e punës, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara. **Përforcimi i të nxënit**: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi kontratat, llojet e tyre, lidhja dhe zgjidhja e tyre.
Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi kontratat, llojet e tyre, lidhja dhe zgjidhja e tyre. Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet: 1-vlerësim formues 2-vetëvlerësim 3-Vlerësim me anë të portofolit
Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër Zgjerim njohurish: Sipas modelit Europass (i cili gjendet në internet) të hartojnë CV-në e tyre. Duke përdorur burime të ndryshme të gjejnë shembuj kontratash pune.

Dt.___/____/__

Fusha: Puna dhe e drejta e punës	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Kushtet e punës		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: kushtet e punës përfshijnë të gjithë ato elemente që lidhen me zbatimin e kontratës së punës nga punëdhënësi për punonjësin. Këtu do të përfshihen: detyrime që lidhen me mjedisin e vendit të punës, zbatimin e sigurisë në punë dhe zbatimin e detyrimeve financiare ndaj punonjësit. Ku parashikohen kushtet e punës? A mendoni se kushtet e punës respektohen në Shqipëri? A mund të jepni ndonjë shembull konkret nga jeta juaj e përditshme?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** Përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri; përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të; diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë;		**Fjalët kyçe:** *kushte pune, ambient pune, siguri në punë.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kodi i Punës, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e formulimit të mendimit dhe të shprehjes së tij, ndërvepron dhe pasuron fjalorin me fjalë, koncepte nga njohuritë e marra deri tani duke përfshirë dhe lëndë si sociologjia, DDNJ dhe Kushtetuta e	

	Shqipërisë.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Situata e të vepruarit

Hapi i parë:Diskutimi i njohurive paraprake

Diskutohet situata e dhënë në libër. Nxënësit i japin përgjigje situatës duke u mbështetur mbi njohuritë që kanë mbi sigurinë në punë.

Hapi i dytë: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pas diskutimit të nxënësve mësuesja diskuton për respektimin e mjedisit, orarin e punës, dinjitetin në punë, mbrojtjen e të miturve;

Jep shembuj nga Europa;

Emigracioni shqiptar;

Hapi i tretë: Diskutim. Praktikë e pavarur

Nxënësit diskutojnë mbi çështjen e dhënë në rubrikën mendimi kritik. Ata ndahen në grupe dhe diskutojnë të drejtat e punës, hapjen e një vendi pune dhe punësimin e plotë të njerëzve nga shteti.

Metodologjia

Gjatë orës së mësimit bëhet organizimi i tij : lidhjes së temës me njohuritë e nxënësve, lidhjes së temës me disiplina të tjera si sociologjia, historia, Kushtetuta shqiptare, interneti, Kodi i Punës, DDNJ, Konventa të ndryshme në lidhje me legjislacionin e punës, të drejtat e njeriut, ndërtimin e njohurive të reja, prezantimin e argumenteve dhe demonstrimin konkret të tyre në bazë të njohurive të përftuara.

Përforcimi i të nxënit: Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre. Ata diskutojnë mbi etikën e punës, çështjes së emigracionit shqiptar dhe shembujve të Europës.

Vlerësimi: Mësimi quhet i arrirë kur nxënësi mund t'i përgjigjet pyetjeve konkrete mbi respektimin e mjedisit, orarin e punës, dinjitetin në punë, mbrojtjen e të miturve, emigracionin shqiptar.

Vlerësimi nga ana e mësuesit bëhet:

1-vlerësim formues

2-vetëvlerësim

3-Vlerësim me anë të portofolit

Detyra: Në fund të orës nxënësit do të punojnë ushtrimet në libër

Veprimtari në grup: nxënësit të ndahen me grupe dhe të zgjedhin njërën nga cështjet e mëposhtme:

Argumentojnë një hierarki të kushteve në punë.

Ndalimin për punën e fëmijëve.

Zgjerim njohurish:

Duke u bazuar në internet, të gjejnë raste të angazhimit të fëmijëve ne punë të rënda.

Duke u bazuar në shembullin e Shqipërisë, të përmbledhin shkaqet e emigrimit të shqiptarëve.

Dt.___/____/__

Fusha: Puna dhe e drejta e punës	**Lënda:** Qytetari	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Tema mësimore: Sigurimet shoqërore		**Situata e të nxënit:** Mësuesja fton nxënësit të japin mendimin e tyre mbi situatën e dhënë: Koncepti i sigurimit shoqëror lindi në fund të shekullit XIX. Më parë, në rast aksidenti, punonjësit viheshin në situata të vështira, e cila i shtohej varfërisë ekstreme. Dyndja e popullsisë nga qendrat rurale në qendra industriale, bëri që punonjësit të mbeteshin pa mbështetje. Pasojë e këtij dëshpërimi ishin revoltat e shumta që shpërthyen në vendet e industrializuara si Franca dhe Anglia. Sigurimet shoqërore u krijuan për nevojën për "paqe sociale" pra, bashkëjetesa paqësore e të gjithë shtresave shoqërore. Çfarë ngjashmërish shihni mes lëvizjeve demografike të fundit të shekullit XIX në Europë dhe lëvizjeve të zhvilluara në Shqipëri pas fundit të regjimit komunist?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave qytetare sipas temës mësimore: **Nxënësi/ja në fund të orës së mësimit:** Përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri; përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të; diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë;		**Fjalët kyçe:** *sigurim shoqëror, sigurim shëndetësor, paqe sociale, aksidente në punë, pension, pension social.*	
Burimet: Teksti mësimor, njohuritë e nxënësve, interneti, enciklopeditë, sociologjia, Kodi i Punës, DDNJ.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon njohuritë e tij, mënyrën e	

